- nuk resorbohet vetëm në diabetikët (0.00)

- resorbohet vetëm në diabetikët (0.00)

- nuk resorbohet vetëm gjatë sëmundjeve kardiovaskulare (0.00)

34. Torus mandibulae paraqet ekzostozë të lokalizuar:

- vestibularisht (0.00)

- në regjionin e trigonum mandibulae (0.00)

- në regjionin e incizivëve të poshtëm (0.00)

- në regjionin e paramolarëve të poshtëm (0.50)

- në regjionin e molarëve të poshtëm (0.00)

35. Torus mandibulae paraqet ekzostozë të lokalizuar në anën:

- vestibulare (0.00)

- orale në regjionin e paramolarëve të poshtëm (0.50)

- në regjionin e molarëve të poshtëm (0.00)

- në regjionin e mentumit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

36. V. retromandibularis ndodhet ndërmjet:

- v.v. dorsales linquae (0.00)

- v. thyroidea superior (0.00)

- v. supraorbitalis (0.00)

- v.v. supratrochlearis (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

37. Hidroxilapatiti përdoret në formën e:

- granulave dhe blloqeve (formë solide) (0.50)

- blloqeve (0.00)

- granulave dhe membranave (0.00)

- blloqeve dhe membranave (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

38. Alveolitis sicca dolorosa paraqet:

- inflamacion të alveolës (0.00)

- çrregullim mes fazës së I-rë dhe të II-të të procesit të shërimit normal të plagës ekstrakcionale (0.50)

- dhimbje si dukuri normale pas ekstrakcionit të dhëmbit (0.00)

- ekstrakcion të dhëmbit (0.00)

- çrregullim mes fazës së II-të dhe të III-të të procesit të shërimit normal të plagës ekstracionale (0.00)

39. Grafti kockor autogjen më së shpeshti përdoret nga:

- crista zigomatikomaksillaris (0.00)

- trigonum retromolare (0.50)

- tibia (0.00)

- femuri (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

40. Autotransplantimi i kaninëve të impaktuar kryhet në moshën :

- tetë vjeçe (0.00)

- nëntë vjeçe (0.00)

- dhjetë vjeçe (0.00)

- 11-12 vjeçe (0.50)

- mbi 14 vjeçe (0.00)

41. Kocka alveolare është pjesë strukturore e:

- periostit (0.00)

- gingivës (0.00)

- cementit (0.00)

- periodonciumit (0,50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

42. Alveoliti si komplikim post ekstrakcional ndodh:

- menjëherë pas ekstrakcionit (0.00)

- dhjetë ditë pas ekstrakcionit (0.00)

- pesëmbëdhjetë ditë pas ekstrakcionit (0.00)

- nuk ndodh kurrë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

43. Alveoliti si një komplikim post ekstrakcional ndodh:

- menjëherë pas ekstrakcionit (0.00)

- tre ditë pas ekstrakcionit (0.50)

- dhjetë ditë pas ekstrakcionit (0.00)

- pesëmbëdhjetë ditë pas ekstrakcionit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

44. Algipore (hidroksiapatiti) ka një strukturë kimike kristalore dhe mikroporozitet që është analoge me strukturën e:

- indit kërcor (0.00)

- palcës kockore (0.00)

- indit lidhor (0.00)

- periostit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

45. Materialet aloplastike kanë vetinë e:

- graft materialit osteoneutral (0.00)

- graft materialit osteoinduktiv (0.00)

- graft materialit osteokonduktiv (0.50)

- graft materialit të ekspanduar sintetik (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

46. Anastomoza e n. zygomaticus e cila sjell fije parasimpatike nga

ganglioni pterygopalatine për inervimin e gjëndrës lacrimale ndodh me nervin e mëposhtëm:

- n nasociliaris (0.00)

- n massetericus (0.00)

- n pterygoideus medialis (0.00)

- n lacrimalis (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

47. Anastomoza mes arteries karotide të jashtme dhe të brendshme ndërtohet nga:

- a palatina ascedens (0.00)

- a labialis superior (0.00)

- a labialis inferior (0.00)

- a profunda linquae (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

48. Anestetikët me lidhje estere zbërthehen në plazmë nën ndikimin e enzimës:

- kolinesterokinone (0.00)

- pseudokolinesterazë (0.50)

- pepsinë plazmatike (0.00)

- pseudoestero - fosfatazë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

49. Substanca anestetike e dhënë në zonën inflamatore nuk ndikon për shkak të:

- mjedisit bazik në zonës inflamatore (0.00)

- mjedisit acidik në zonën inflamatore (0.50)

- për shkak të trismusit (0.00)

- resorbimit të zvogëluar të anestetikut (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

50. Substanca anestetike e dhënë në zonën inflamatore nuk ndikon për shkak të:

- mjedisit bazik në zonës inflamatore (0.00)

- mjedisit acidik në zonën inflamatore (0.50)

- për shkak të trismusit (0.00)

- gjakderdhjes së dobët në zonën inflamatore (0.00)

- resorbimit të zvogëluar të anestetikut (0.00)

51. Aplikimi i hidroksiapatitit konsiston në:

- përzierjen e granulave me tretësirë peniciline, pastaj aplikimi (0.00)

- përzierjen e granulave me tretje fiziologjike, pastaj aplikimi (0.50)

- përzierjen e granulave me tretësirë jodi, pastaj aplikimi (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

52. Materialet apoplastike përdoren me qëllim të:

- rritjes së imunitetit lokal (0.00)

- rritjes së imunitetit humoral (0.00)

- stabilizimit të koagulumit (0.50)

- fuqizimit të funksionit të osteoklasteve (0.00)

- rritjes së numrit të trupave të Russell-it (0.00)

53. Augumentimi i kreshtës ka për qëllim:

- rritjen e lartësisë dhe gjerësisë së kreshtës (0.50)

- nivelimin e kreshtës (0.00)

- zvogëlimin e lartësisë dhe gjerësisë së kreshtës (0.00)

- zvogëlimin në lartësi, rritjen në gjerësi (0.00)

- rritjen në lartësi, zvogëlim në gjerësi (0.00)

54. Bllokada nervore kryhet:

- në fund të degëve përfundimtare (0.00)

- në vendin e nervit fqinjë (0.00)

- në afërsi të arteries (0.00)

- në afërsi të muskulit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

55. Kokrrëzat Bohon janë të lokalizuara:

- në vijën mediale të palatumit (0.00)

- në kreshtën alveolare (0.50)

- në buzë (0.00)

- në skajin faringeal (0.00)

- në faqe (0.00)

56. Llojet e shërrimit pas reimplantimit dhe transplantimit janë:

- cementogjene (0.00)

- shërimi i plotë nuk është i mundur (0.00)

- osteoide (0.50)

- përkohshëm (0.00)

- gingivo-dentar (0.00)

57. Vitamina K ndikon në sintezën e funksioneve të mëposhtme:

- faktorit II, VII, IX dhe X (0.50)

- faktorit II, IX, VIII dhe X (0.00)

- faktorit II, VII, VIII dhe X (0.00)

- faktorit II, VII, X dhe XIII (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

58. Vitamina K ndikon në sintezën e funksioneve të mëposhtme:

- faktorit II, VII, IX dhe X (0.50)

- faktorit II, IX, VIII dhe X (0.00)

- faktorit II, VII, VIII dhe X (0.00)

- faktorit II, VII, X dhe XIII (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

59. Sterilizimi i lagësht në 100 ° C kryhet me:

- tindalizim dhe pasterizim (0.00)

- autoklav (0.00)

- zierje dhe avull që rrymojnë (0.50)

- fuçinë patrizane dhe pasterizimin (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

60. Muskuli i mëposhtëm merr pjesë në ndërtimin e trigonum submandibulare:

- m digastricus (0.50)

- m omohyoideus (0.00)

- m geniohyoideus (0.00)

- m mylohyoideus (0.00)

- m stilohyoideus (0.00)

61. Kockat e mëposhtme marrin pjesë në ndërtimin e canalis palatinus major:

- kocka zigomatike (0.00)

- nofulla e sipërme (0.50)

- kocka e lotit (0.00)

- guaska e poshtme e hundës (0.00)

- vomeri (0.00)

62. Në grupin e degëve anësore të a. maxillaris nuk bën pjesë arteria e mëposhtme:

- a alveolaris inferior (0.00)

- a buccalis (0.00)

- a alveolaris superior posterior (0.00)

- a sphenopalatina (0.50)

- a palatina descedens (0.00)

63. Mvarësisht nga pozita e kaninëve të impaktuar, ato sipas Archer klasifikohen në:

- katër klasa (0.00)

- pesë klasa (0.50)

- gjashtë klasa (0.00)

- tetë klasa (0.00)
- nëntë klasa (0.00)

64. Teknikat e dhënie së anestezionit mandibular intraoral janë:

- dy (0.00)
- tre (0.00)
- pesë (0.00)
- dy direkte dhe një indirekte (0.00)
- dy direkte dhe dy indirekte (0.50)

65. Në sinusin kavernoz, a. carotis interna nuk është në raport me nervin e mëposhtëm:

- n trochlearis (0.00)
- n oculomotorius (0.00)
- n abduscens (0.50)
- n ophtalmicus (0.00)
- n maxillaris (0.00)

66. Te anestezioni i përgjithshëm intervenimi kirurgjik kryhet në fazën:

- e parë (0.00)
- e dytë (0.00)
- e tretë (0.50)
- e katërt (0.00)
- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

67. Në kundërindikacionet për vendosjen imediate të implanteve nuk bëjnë pjesë:

- ekstrakcionet e shumta me defekte të mëdha kockore (0.00)

- terapia e pasuksesshme endodontike (0.00)

- molarë me pozitë të çregullt (0.50)

- të gjitha të lartëpërmendurat (0.00)

- asnjëra nga këto më sipër (0.00)

68. Në literaturë parodontiti progresiv mund të gjendet edhe si:

- parodontitis periapicalis chr granulomatosa (0.00)

- parodontitis periapicalis chr. circumscripta (0.00)

- parodontitis periapicalis chr. exacerbata (0.00)

- parodontitis periapicalis chr. difussa (0.50)

- periodontitis acuta (0.00)

69. Në mandibulë kalojnë kanalet e mëposhtme nervore:

- canalis mandibulae, kanali i Serres-it, canalis mentalis, canalis incisivum (0.50)

- canalis mandibulae, canalis mentalis (0.00)

- canalis mandibulae, canalis incisivum dhe kanali Serres-it (0.00)

- vetëm një dhe nganjëherë dy canalis mandibulae (0.00)

- të gjitha të lartëpërmendurat (0.00)

70. Në bazë të cilësisë së indit kockor, ndikim në vendimin për vendosjen e implantit ka:

- materiali i zgjedhur për tu implantuar dhe nofulla (e sipërme ose e poshtme) në të cilën do të vendoset (0.00)

- trashësia dhe gjerësia e indit kockor (0.00)

- forma dhe madhësia, rradhitja e spongiozës dhe kompaktes dhe shkalla e atrofisë (0.50)

- nën a dhe b (0.00)

- të gjitha të lartëpërmendurat (0.00)

71. Në zhvillimin e lezionit cistik, krijimi i mikrokavitetit është:

- faza e parë (0.00)

- faza e dytë (0.50)

- faza e tretë (0.00)

- faza e katërt (0.00)

- faza e pestë (0.00)

72. Në rastet kur koha ekstraalveolare është shumë e gjatë gjatë transplantimit ekziston rreziku i:

- nekrozës së odontoblasteve dhe cementoblasteve (0.00)

- hedhja e transplantit (0.00)

- nevoja për trajtim endodontik (0.00)

- nuk ka asnjë korrelacion mes kohës ekstraalveolare (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

73. Në rast të ekzacerbimit, parodontiti kronik manifestohet si:

- paradontitis periapicalis chr.granulomatosa (0.00)

- paradontitis periapicalis chr.circumscripta (0.00)

- paradontitis acuta (0.50)

- paradontitis periapicalis chr.fibrosa (0.00)

- gangrena complicata (0.00)

74. Në hapësirën submentale vendosen:

- gjëndrat limfatike submentale (0.00)

- gjëndrat limfatike submentale dhe venter anterior m. d (0,50)

- gjëndrat submandibulare të pështymës (0.00)

- ind lidhor dhe gjëndrat limfatike submentale (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

75. Gjatë reimplantimit terapeutik ekstrakcioni i dhëmbit që do të reimplantohet duhet të jetë:

- traumatik (0.00)

- i shpejtë dhe efikas (0.00)

- shkalla e dëmtimit të ligamentit dentoalveolar (0.00)

- atraumatik (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

76. Gjatë reimplantimit dhëmbi duhet të ruhet në:

- antiseptik të fortë (0.00)

- ujë të sterilizuar (0.00)

- tretje antibiotike (tretje fiziologjike dhe penicilinë) (0.50)

- tretësirë qumështi (0.00)

- tretësirë detergjenti (0.00)

77. Gjatë intervenimit kirurgjik – largimin e frenulumit lingual, mund të dëmtohet:

- n. alveolaris inferior (0.00)

- ductus parotidei Stenoni (0.00)

- ductus sublingualis (0.50)

- plexus dentalis inferior (0.00)

- ansa cervicalis (0.00)

78. Në metodat kirurgjikale të trajtimit të sinusitit akut dentogjen përfshihen:

- trepanimi i dhëmbit (0.00)

- resekcioni i rrënjës së dhëmbit (0.00)

- kiretazha periapikale (0.00)

- osteotomia transmaksilare (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

79. Kohëzgjatja e veprimit të anestezionit sipërfaqësor (në lëkurë dhe mukozë) është:

- pesë minuta (0.00)

- tridhjetë sekonda (0.00)

- dy deri në tre minuta (0.50)

- dhjetë minuta (0.00)

- tridhjetë minuta (0.00)

80. Cista globulomaksilare lokalizohet në mes të:

- apeksit të incizivit të sipërm lateral dhe kaninit (0.50)

- incizivit lateral mandibular dhe kaninit (0.00)

- paramolarit të parë dhe të dytë mandibular (0.00)

- paramolarit të parë dhe të dytë maksilar (0.00)

- retromolar (0.00)

81. Nofulla e sipërme - maksila merr pjesë në ndërtimin e:

- orbitës, cavum nasi, cavum oris (0.50)

- cavum nasi, cavum oris (0.00)

- orbitës, cavum oris, fossa pterygopalatine (0.00)

- orbitës dhe meatus acusticus externus (0.00)

- të gjitha të lartëpërmendurat (0.00)

82. Humbja e zonës së kondensimit periferik në cistat radikulare është për shkak të:

- trepanimit të kockave (0.00)

- terapisë antibiotike prej 15 ditësh (0.00)

- inflamacionit (0.50)

- osteotomisë transmaksilare (0.00)

- trepanimit të dhëmbit shkaktar (0.00)

83. A mund të shkaktojë reaksion alergjik një vazokonstriktor që gjendet si shtesë në substancën anestetike?

- asnjëherë (0.00)

- gjithmonë (0.00)

- rrallë, por ekziston mundësia (0.50)

- çdo kolaps është reaksion alergjik (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

84. Implantet dyfazore moderne janë kombinim i dy komponenteve të implantit, edhe atë:

- pjesa intraosseale dhe sulcus former nga i njëjti metal (0.00)

- pjesa intraosseale dhe suprastruktura nga metali i ndryshëm (0.00)

- pjesa intraosseale dhe suprastruktura nga i njëjti metal (0.50)

- pjesa intraosseale dhe sulcus formeri nga metali i ndryshëm (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

85. Sot reimplantimi konsiderohet i suksesshëm nëse resorbimi i

dhëmbit të reimplantuar nuk ndodh gjatë:

- 6 muajve (0.00)

- 1 muaji (0.00)

- 2 viteve (0.50)

- 12 muajve (0.00)

- 20 viteve (0.00)

86. Trendet e sotme në implantologjinë moderne kryesisht favorizojnë implantet në formën e:

- vidhës cilindrikokonike (0.50)

- konike me bazë të gjërë apikale (0.00)

- trekëndore me bazë të zvogëluar apikale (0.00)

- drejtkëndëshe (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

87. Fenomeni i Dipitren-it është shenjë e sigurtë diagnostike për:

- cistë (0.50)

- tumor (0.00)

- osteomielit (0.00)

- granulomë periapikale (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

88. Fenomeni i Dipitren-it është shenjë e sigurtë diagnostike për:

- cistë (0.50)

- tumor (0.00)

- osteomielit (0.00)

- granulomë periapikale (0.00)

- granulomë eozinofile (0.00)

89. Fenomeni i Dipitrenit paraqet:

- fenomen të krepitacionit (0.50)

- fenomen të fluktuimit (0.00)

- fenomen të topit të ping-pongut (0.00)

- fenomen të luksimit (0.00)

- fermitus pozitiv (0.00)

90. Diagnoza diferenciale midis cistës radikulare dhe granulomës periapikale vendoset me:

- rtg inçizim (0.00)

- punkcion (0.00)

- analizë histopatologjike (0.50)

- tomografi të kompjuterizuar (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

91. Diagnoza diferenciale midis cistës radikulare dhe granulomës periapikale vendoset me:

- rtg inçizim (0.00)

- punkcion (0.00)

- analizë histopatologjike (0.50)

- tomografi të kompjuterizuar (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

92. Diagnoza diferenciale e inflamacionit akut të sinusit maksilar duhet dalluar nga:

- dhimbja postekstrakcionale (0.50)

- tumoreve beninje (0.00)

- parezës së n. facialis (0.00)

- oftalmoplegjisë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

93. Tamponada e thellë është një metodë lokale e hemostazës, edhe atë:

- metodë kimike e hemostazës lokale (0.00)

- metodë fizike e hemostazës (0.00)

- metodë mekanike e hemostazës (0.50)

- metodë kimike mekanike e hemostazës (0.00)

- metoda kimike fizike e hemostazës (0.00)

94. Apeks elevatori i poshtëm quhet edhe:

- Baini i poshtëm (0.00)

- sindezmotomi i poshtëm (0.50)

- niveluesi i poshtëm (0.00)

- inokulatori i poshtëm(0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

95. Fijet muskulare të m. masseter ngjiten poshtë në:

- processus condilaris ramus mandibulae (0.00)

- processus pyramidalis (0.00)

- processus coronoideus ramus mandibulae (0.00)

- processus temporalis ossis zygomatici (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

96. Një material për implantim duhet të ketë:

- modul të përafërt të elasticitetit me kockën (0.50)

- të jetë vetëm i plazmuar (0.00)

- nuk është e nevojshme të ketë modul të elasticitetit (0.00)

- të gjitha të lartëpërmendurat (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

97. Njëri nga muskujt e mëposhtëm bën pjesë në grupin e muskujve mbihyoid:

- m sternothyroideus (0.00)

- m pterygoideus medialis (0.00)

- m mylohyoideus (0.50)

- m scallenius (0.00)

- m sternokleidomastoideus (0.00)

98. Një nga qasjet ekstraorale të bllok anestezionit për n. infraorbitalis është përmes:

- meatus nasi superior (0.00)

- orbitës (0.50)

- meatus nasi inferior (0.00)

- canalis incisivus (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

99. Njëri nga muskujt e mëposhtëm nuk bën pjesë në këtë grup:

- m sternohyoideus (0.00)

- m omohyoideus (0.00)

- m sternothyroideus (0.00)

- m thyrohyoideus (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

100. Një nga indikacionet për autotransplantim mund të jetë:

- nuk ka indikacione (0.00)

- parandalimi i ndryshimeve osteoporotike të nofullave (0.00)

- kirurgjikale orale (0.00)

- protetike – krijimi i urës shtyllë (0.50)

- parodontologjike (0.00)

101. Një nga arteriet e mëposhtme nuk është degë fundore e a. carotis externa:

- a. chorioidea anterior (0.00)

- a. cerebri anterior (0.00)

- a. cerebri media (0.00)

- a. comunicans posterior (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

102. Një anestetik ideal duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të mos jetë i qëndrueshëm (0.00)

- të prodhohet në një mënyrë komplekse dhe të shtrenjtë (0.00)

- të ketë erë të pakëndshme (0.00)

- të jetë shpërthyes (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

103. Ekstrakcioni i dhëmbëve të qumështit kryhet me:

- Pasqyrë dentare dhe pincetë stomatologjike (0.00)

- elevator (0.00)

- darëra dhe elevator (0.50)

- darëra (0.00)

- instrument plastik (0.00)

104. Matriksi ekstracelular përbëhet nga:

- përbërësi organik (0.00)

- kolagjeni dhe kripra të fosfatit të kalciumit (0.50)

- osteoblastet (0.00)

- osteoklastet dhe osteocitet (0.00)

- asnjëra nga këto më sipër (0.00)

105. Trajtimi endodontik i sistemit kanalikular gjatë reimplantimit mund të jetë:

- preoperativ (0.00)

- nuk rekomandohet gjatë reimplantimit (0.00)

- preoperativ dhe intraoperativ (0.50)

- trajtim endodontik intraoperativ i kanalit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

106. Trajtimi endodontik i sistemit kanalikular gjatë reimplantimit nuk është i nevojshëm nëse:

- reimplantimi është i menjëhershëm (0.00)

- te të rinjtë (0.00)

- reimplantimi është imediat edhe nëse apekset janë të gjera (0.50)

- endodoncia është një procedurë e detyrueshme (0.00)

- pulpa është vitale (0.00)

107. Perlat Epstein lokalizohen në:

- linjën mediale të palatumit (0.50)

- kreshtën alveolare (0.00)

- buzë (0.00)

- skajin faringeal (0.00)

- faqe (0.00)

108. Oksid i etilenit përdoret për:

- anestezim me ngrirje (0.00)

- sterilizim (0.50)

- për anestezi Rausch (0.00)

- për rrezatimin jonizues (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

109. Për të marrë rezultate maksimale estetike dhe funksionale, është e nevojshme të bëhen:

- studio modeli, rtg shablloni dhe bor shablloni (0.50)

- rtg shablloni (0.00)

- studio modeli dhe dubler modeli (0.00)

- të gjitha të lartëpërmendurat (0.00)

- asnjë nga këto më sipër (0.00)

110. Për përpunimin e implanteve dentare më së shpeshti përdoren:

- titani, tantali, nikeli dhe platina (0.00)

- kromi-kobalti dhe molibdeni, platina dhe çeliku (0.00)

- krom-kobalti dhe molibdeni, tantali dhe titani (0.50)

- të gjitha të lartëpërmendurat (0.00)

- asnjëra nga këto më sipër (0.00)

111. Një dhëmb i diagnostifikuar me parodontit kronik është:

- vital (0.00)

- avital (0.50)

- i ndjeshëm ndaj të ftohtit (0.00)

- i ndjeshëm ndaj nxehtësisë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

112. Zona me stres-shpërndarje më të madhe të forcave në implant është në zonën e:

- apeksit (0.00)

- incizale / okluzale (0.00)

- qafës së implantit (0.50)

- të gjitha të lartëpërmendurat (0.00)

- asnjëra nga këto më sipër (0.00)

113. Imobilizimi pas autotransplantimit zgjat:

- 1-2 javë (0.00)

- 3 muaj (0.00)

- 5-7 javë (0.50)

- disa ditë (0.00)

- 6 muaj (0.00)

114. Dhëmbët e impaktuar me cistë duhet të largohen:

- të mos hiqen (0.00)

- të pritet nga mosha 11-13 vjeç (0.00)

- menjëherë (0.50)

- të pritet mbarimi i pubertetit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

115. Impakcioni i kaninëve të sipërm është më i shpeshtë tek:

- meshkujt (0.00)

- femrat (0.50)

- te fëmijët e gjinisë mashkullore para pubertetit (0.00)

- te fëmijët e gjinisë femërore para pubertetit (0.00)

- i barabartë (0.00)

116. Indikacionet për kiretazhë periapikale janë:

- dhëmbi i mbushur si duhet në mënyrë endodontike, por periapikal jo (0.50)

- thyerja e rrënjës (0.00)

- granuloma interne (0.00)

- cystis radicularis inflamata (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

117. Indikacione për implante subperiosteale janë gjendjet e:

- atrofisë së theksuar të kreshtës alveolare (0.00)

- sinus proccidens (0.00)

- ngjitje e lartë / e ulët e muskujve në nofullën e poshtme / të sipërme (0.00)

- kur foramen mentale është në majë të processus alveolaris (0.00)

- të gjitha të lartëpërmendurat (0.50)

118. Indikacione për implantet transdentare janë gjendjet e:

- atrofisë së theksuar të kreshtës alveolare (0.00)

- sinus proccidens (0.00)

- ngjitje e lartë / e ulët e muskujve në nofullën e poshtme / të sipërme (0.00)

- kur foramen mentale është në majë të processus alveolaris (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

119. Indikacionet për osteotomi transmaksilare janë:

- pulpoparodontiti (0.00)

- periodontitis periapicalis acuta purulenta (0.50)

- cystis inflamata (0.00)

- gangrena complicata (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

120. Indikacionet për osteotomi transmaksilare janë:

- pulpoparadontiti (0.00)

- cystis inflamata (0.00)

- periodontitis periapicalis acuta purulenta (0.50)

- abscessus dentoalveolaris chronica (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

121. Indikacionet për transplantim mund të jenë:

- faktorë të përgjithshëm (0.00)

- faktorë lokalë (0.00)

- parodontopati e gjeneralizuar (0.00)

- gingivostomatiti (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

122. Indikacionet për përdorimin e materialeve aloplastike janë:

- parafunksionet (0.00)

- infeksionet recidiviuese të indeve të buta (0.00)

- veset e këqia të higjienës (0.00)

- dehiscencat e indeve të buta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

123. Indikacionet për përdorimin e elevatorit Schlemmer:

- ndarja e insercionit epitelial të dhëmbëve në nofullën e sipërme (0.00)

- ekstrakcioni i molarëve të tretë të poshtëm (0.00)

- ekstrakcioni i molarëve të tretë të sipërm (0.00)

- ekstrakcioni i paramolarëve në nofullën e poshtme (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

124. Indikacionet për përdorimin e elevatorit Schlemmer:

- ndarja e insercionit epitelial të molarëve të poshtëm (0.50)

- ndarja e insercionit epitelial të dhëmbëve në nofullën e sipërme (0.00)

- ndarja e insercionit epitelial të dhëmbëve në nofullën e poshtme (0.00)

- ekstrakcioni i paramolarëve në nofullën e poshtme (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

125. Inervimi i muskujve mastikatorë fillon nga:

- n. facialis (0.00)

- n hypoglossus (0.00)

- n mandibularis (0.50)

- n maxillaris (0.00)

- n glossopharingeus (0.00)

126. Inervimi i muskujve mastikatorë fillon nga?

- n. facialis (0.00)

- n. hypoglossus (0.00)

- n. mandibularis (0.50)

- n. glossopharingeus (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

127. Infeksionet nga e treta e mesme e fytyrës në endokranium përhapen përmes:

- v.angularis (0.50)

- vv.temporales (0.00)

- plexus pterigoideus (0.00)

- v. facialis (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

128. Infeksionet nga regjioni retromaksilar në endokranium përhapen përmes:

- plexus pterigoideus dhe v.ophtalmica inferior (0.50)

- v. angularis (0.00)

- v. lingualis (0.00)

- plexus pterigoideus (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

129. Infeksioni në hapësirën sublinguale vjen nga:

- incizivët e poshtëm (0.00)

- paramolarët e poshtëm (0.00)

- incizivët e poshtëm, kaninët dhe paramolarët (0.00)

- incizivët e poshtëm, kaninët, paramolarët dhe molarët e parë (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

130. Incizioni për torusin palatinal sipas Midës ka formën e shkronjës:

- L (0.00)

- X (0.00)

- Y (0.50)

- S (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

131. Incizioni për abscesin palatinal kryhet me:

- incizion horizontal (0.00)

- incizion vertikal (0.50)

- incizion horizontal dhe vertikal (0.00)

- incizion të pjerrët (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

132. Incizioni për torusin palatinal sipas Dorans ka formën e mëposhtme:

- lineare, gjatësore (0.00)

- lineare, tërthore (0.00)

- gjysmërrethore (0.00)

- shkronjës së dyfishtë Y (0.50)

- shkronjës së dyfishtë V (0.00)

133. Jodoform dreni zëvendësohet çdo:

- 48 orë (0.00)

- 72 orë (0.00)

- 24 deri në 48 orë (0.50)

- 12 deri në 24 orë (0.00)

- 6 deri në 12 orë (0.00)

134. Jodoform dreni zëvendësohet çdo:

- 48 orë (0.00)

- 72 orë (0.00)

- 24 deri në 48 orë (0.50)

- 6 deri në 12 orë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

135. Në cistën globulomaksilare, dhëmbët fqinjë janë:

- avital (0.00)

- vital (0.50)

- rrënjë e resorbuar e incizivit lateral (0.00)

- rrënjë e resorbuar e kaninit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

136. Formimi i rrënjëve pas transplantimit tek dhëmbët me rritje të papërfunduar të rrënjëve shënohet si:

- ontogjenezë (0.50)

- rizalizë (0.00)

- ankilozë (0.00)

- dentogjenezë (0.00)

- një proces i tillë nuk është i mundur (0.00)

137. Tek reimplantimi imediat koha ekstraalveolare është më e madhe se:

- 20 min (0.00)
- 5 orë (0.00)
- 24 orë (0.00)
- 10 min (0.00)
- 2 orë (0.50)

138. Tek osteomieliti i nofullës së poshtme, relativisht shpejt mund të shfaqet ndjesi shpimi gjilpërE në buzën e poshtme e quajtur:

- shenja Vincent (0.50)
- shenja Wiliams (0.00)
- shenja Miller (0.00)
- shenja Suler (0.00)
- shenja Godon (0.00)

139. Tek pacientët me alergji ndaj penicilinës nuk duhet dhënë:

- anestetik lokal (0.00)
- scandonest (0.00)
- procain (0.50)
- lidocain (0.00)
- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

140. Tek pacientët me bruksizëm, vendosja e implanteve është e mundur:

- në të gjitha klasat e padhëmbësisë parciale të indikuar (0.00)
- nëse kanë të paktën tre dhëmbë të përhershëm (0.00)
- në rastet kur kemi dhëmbë fqinjë me vendin e implantit (0.00)
- paraqet një nga kundërindikacionet për implant (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

141. Tek pacientët me alergji ndaj penicilinës nuk duhet dhënë:

- anestetik lokal (0.00)

- skandonest (0.00)

- lidocain (0.00)

- solutio Chlumski (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

142. Tek Torus anestezioni (VAJSBREM-metoda apodaktale) vendi i shpimit është:

- 1 cm mbi sipërfaqen okluzale të molarëve të poshtëm (0.00)

- fundi distal i sulkusit-0,5 cm. nën sipërfaqen okluzale të molarëve të sipërm (0.50)

- fundi medial i sulkusit-2cm mbi sipërfaqen okluzale të molarëve të poshtëm (0.00)

- 1 cm nën sipërfaqen okluzale të molarëve të sipërm (0.00)

- mbi incizivët e sipërm (0.00)

143. Te molarët e tretë mandibularë me rritje të përfunduar të rrënjës dhe apekse të mbyllura gjatë transplantimit bëhet:

- kiretazhë e alveolës së recipientit (0.00)

- vendosje e infra-okluzionit (0.00)

- trepanim i transplantit (0.00)

- largimi i fijeve periodontale (0.00)

- trajtim endodontik intraoperativ i kanaleve (0.50)

144. Në proceset kronike periapikale të molarëve një nga metodat e mundshme terapeutike është:

- implantimi (0.00)

- reimplantimi (0.50)

- transplantimi (0.00)

- dhëmbët nuk ekstraktohen derisa janë të qetë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

145. Si abscessus dentoalveolaris chronica përkufizohet:

- parodontitis periapicalis chr. fibrosa (0.00)

- parodontitis periapicalis chr. granulomatosa (0.00)

- parodontitis periapicalis chr. difussa (0.50)

- cystis radicularis inflamata (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

146. Si abscessus dentoalveolaris chronica përcaktohet:

- parodontitis periapicalis chr.fibrosa (0.00)

- parodontitis periapicalis chr.circumscripta (0.00)

- parodontitis periapicalis chr.granulomatosa (0.00)

- parodontitis periapicalis chr.difussa (0.50)

- periodontitis acuta (0.00)

147. Si komplikime nga sinusiti akut mund të lajmërohen:

- fraktura e maksilës (0.00)

- neuralgjia e n. facialis (0.00)

- komplikime intrakraniale (0.50)

- mediastiniti (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

148. Gjetja karakteristike e parodontitin progresiv në Rtg është:

- ndriçimi i kufizuar periapikal (0.00)

- ndriçimi i pakufizuar periapikal (0.50)

- hija periapikale (0.00)

- hija e pakufizuar periapikale (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

149. Tek leukemia acute, manifestimet orale karakteristike janë:

- gingiviti hipoplastik (0.00)

- gingiviti hiperplastik (0.50)

- ulçeracione të mukozës orale (0.00)

- ndryshime aftoze të mukozës bukale (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

150. Klasifikimi i lezioneve periapikale sipas Spatafore në 1990 përfshin diapazon të gjerë të lezioneve, edhe atë:

- granulomë periapikale, cistë radikulare, shenjë periapikale, parodontit progresiv dhe lezione të tjera (0.00)

- shenjë periapikale, granulomë periapikale, cistë radikulare dhe lezione të tjera (0.50)

- shenjë periapikale, granulomë periapikale, cistë radikulare, cistë folikulare dhe lezione të tjera (0.00)

- shenjë periapikale, granulomë periapikale dhe lezione të tjera (0.00)

- parodontit progresiv dhe lezione të tjera (0.00)

151. Darërat për ekstrakcionin e dhëmbëve punojnë në parimin e:

- makarës (çikrikut) (0.00)

- makarës dhe llozit (0.00)

- llozit (0.50)

- pykës (0.00)

- pykës dhe makarës (0.00)

152. Lëvizshmëria klinike e implantit gjatë osteointegrimit të shëndoshë është në:

- drejtim vestibulo-oral (0.00)

- drejtim mezio-distal (0.00)

- drejtim vestibulo-oral dhe mezio-distal (0.00)

- nuk ekziston lëvizshmëri klinike e implantit (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

153. Klinikisht dhe patoanatomikisht dallojnë mes veti këto lloje themelore të infeksionit:

- abscesi, emfizema dhe flegmona (0.00)

- edema dhe emfizema (0.00)

- abscesi, edema dhe flegmona (0.00)

- abscesi dhe flegmona (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

154. Klinikisht me fazë latente dhe të egzacerbimit manifestohet:

- parodontitis periapicalis chr. Granulomatosa (0.00)

- parodontitis periapicalis chr. Fibrosa (0.00)

- parodontitis periapicalis chr.difussa (0.50)

- parodontitis periapicalis chr.circumscripta (0.00)

- periodontitis acuta (0.00)

155. Cila është koha më e favorshme për nxjerrjen e dhëmbit të poshtëm të mençurisë?

- periudha pas formimit të kurorës së dhëmbit (0.00)

- periudha pas formimit të një të tretës së rrënjës (0.50)

- kur është e formuar rrënja (0.00)

- pas eruptimit (0.00)

- gjithmonë (0.00)

156. Cila nga mjetet e mëposhtme nuk përdoret për anestezion të përgjithshëm:

- kloroformi (0.00)

- eteri (0.00)

- azot - oksiduli (0.00)

- azot - formaldehidi (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

157. Cilat gjëndra janë të inervuara nga chorda tympani e n. facialis?

- gl. sublingualis (0,50)

- gl. parotis (0.00)

- gl. lacrimalis (0.00)

- gl. nasale (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

158. Cilat shkaqe mekanike çojnë deri në impakcion të kaninit permanent:

- incizivi qendror (0.00)

- incizivi lateral (0.00)

- molari i parë (0.00)

- incizivi lateral dhe paramolari i parë (0.50)

- paramolari (0.00)

159. Cilët muskuj mbihyoid inervohen nga n. mandibularis?

- m. digastricus (0.00)

- m. mylohyoideus (0.50)

- m. geniohyoideus (0.00)

- m. stylohyoideus (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

160. Cili nga muskujt e mëposhtëm nuk bën pjesë në grupin e muskujve nënlëkurorë të buzëve:

- m. depressor anguli oris (0.00)

- m. levator labii superioris (0.00)

- m. orbicularis oris (0.00)

- m. transversus menti (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

161. Cili nerv nuk bën pjesë në grupin e degëve anësore të n. maxillaris:

- n. palatinus major et n.n. palatini minores (0.00)

- n. auriculotemporalis (0.50)

- n. zygomaticus (0.00)

- r.r. alveolares superiores posteriores (0.00)

- n. infraorbitalis (0.00)

162. Cili nga anestetikët e mëposhtëm bën pjesë në grupin amid të anestetikëve:

- cocaina (0.00)

- tetracaina (0.00)

- procaina (0.00)

- pancaina (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

163. Cili nga faktorët e mëposhtëm ndikon pozitivisht në implant:

- higjiena orale (0.50)

- terapia imunosupresive (0.00)

- terapia me antibiotikë (0.00)

- terapia kortikosteroide (0.00)

- përdorimi i analgjezikëve (0.00)

164. Cili nga anestetikët e mëposhtëm bën pjesë në grupin amid të anestetikëve?

- cocaina (0.00)

- lidocaina (0.50)

- procaina (0.00)

- nescaina (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

165. Cili nga muskujt nënlëkuror është i mbuluar me fascie:

- m. orbicularis oculi (0.00)

- m. auricularis anterior (0.00)

- m. buccinator (0.50)

- m. epicranus (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

166. Cili nga muskujt e mëposhtëm nuk bën pjesë në grupin e muskujve mastikatorë:

- m. temporalis (0.00)

- m. pterygoideus medialis (0.00)

- m. masseter (0.00)

- m. pterygoideus lateralis (0.00)

- m. digastricus (0.50)

167. Cili nga muskujt e mëposhtëm merr pjesë në shtrëngimin e fascies së mesme të qafës, duke lehtësuar kështu qarkullimin venoz: .

- m digastricus (0.00)

- m thyrohyoideus (0.00)

- m sternocleidomastoideus (0.00)

- m omohyoideus (0.50)

- m mylohyoideus (0.00)

168. Cila nga klasat e mëposhtme nuk indikohet në kushtet adekuate pët implantim:

- padhëmbësia totale (0.00)

- harku i reduktuar i dhëmbëve (0.00)

- mungesa e incizivit qendror (0.00)

- mungesa e molarit të tretë (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

169. Cila nga arteriet e mëposhtme nuk është degë anësore e a. carotis externa:

- a. occipitalis (0.00)

- a. auricularis posterior (0.00)

- a. facialis (0.00)

- a. maxillaris (0,50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

170. Cila anomali ortodontike shkaktohet më shpesh nga meziodensi i eruptuar:

- diastema mediana (0.50)

- dendësia primare (0.00)

- rrallësia e harkut të dhëmbëve (0.00)

- protruzioni (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

171. Sa zona (regjione) të anestezionit ka në nofullën e sipërme?

- pesë (0.50)

- dy (0.00)

- katër (0.00)

- shtatë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

172. Sa anestezione gjithësej ekzistojnë për n.nasopalatinus scarpae?

- tre (0.00)

- katër (0.50)

- një (0.00)

- gjashtë (0.00)

- dhjetë (0.00)

173. Sa është i larguar foramen infraorbitale nga skaji i sipërm i sipërfaqes së përparme (facies anterior) të maksilës?

- 3-5 mm (0.00)

- 4-6 mm (0.00)

- 5-12 mm (0,50)

- 10-12 mm (0.00)

- të gjitha janë të pasakta (0.00)

174. Sa zona të inervimit ka në nofullën e poshtme?

- një (0.00)

- dy (0.00)

- tre (0.50)

- katër (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

175. Sa zona të inervimit ka në nofullën e poshtme?

- një (0.00)

- dy (0.00)

- katër (0.00)

- shtatë (0.00)

- tre (0.50)

176. Kujdesi konservativ i sinus aperta kryhet me:

- shkumë fibrine (0.00)

- gelastin (0.00)

- jodoform dren (0.50)

- adrenalin (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

177. Ekzaminimet kontrolluese të një dhëmbi të reimplantuar, përveç ekzaminimeve klinike, përfshijnë edhe:

- ekzaminime RTG-ni (0.50)

- test të sedimentacionit (0.00)

- pasqyrë diferenciale të gjakut (0.00)

- teste mikrobiologjike (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

178. Gjakderdhja nga kocka spongioze ndalet me ndihmën e:

- dyllit special kockor (0.50)

- bllokut kockor (0.00)

- gazës sterile (0.00)

- ndalet në mënyrë spontane (0.00)

- implanteve (0.00)

179. Kristal penicilina (Penicilin G) ordinohet në mënyrë i. m. në:

- 12 orë (0.00)

- 24 orë (0.00)

- 6 orë (0.00)

- 48 orë (0.00)

- 3 orë (0.50)

180. Materialet kseno-transplantuese janë graft materie që aplikohen:

- nga një organizëm në tjetrin të llojit të njëjtë (species) (0.00)

- nga origjina bimore në organizmin e njeriut (0.00)

- nga origjina shtazore në organizmin e njeriut (0.50)

- vetëm me origjinë sintetike (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

181. Barnat e zgjedhur në terapinë e A. O. I. nëse nuk ekzistojnë kundërindikacione janë:

- antibiotikë me spektër të gjerë (0.00)

- antibiotikë makrolidë (0.00)

- antibiotikë beta laktan (0.50)

- barna antimikotike (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

182. Darërat-Lir shërbejnë për:

- ekstrakcionin e incizivëve qendror (0.00)

- ekstrakcionin e incizivëve lateral (0.00)

- nivelimin e skajeve të mprehta (0.50)

- separimin e dhëmbëve me shumë rrënjë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

183. Darërat-Lir shërbejnë për:

- ekstrakcionin e incizivëve qendror (0.00)

- ekstrakcionin e incizivëve lateral (0.00)

- nivelimin e skajeve të mprehta (0.50)

- separimin e dhëmbëve me shumë rrënjë (0.00)

- ekstrakcionin e dhëmbëve të impaktuar (0.00)

184. Plate implanti shoqërohet me emrin e një autori:

- Formigini (0.00)

- Link (0.50)

- Brenemark (0.00)

- Kirsch (0.00)

- Zimmer (0.00)

185. Anestetiku lokal që në përmbajtjen e tij përmban vazokonstriktor felipresin (oktapresin) kundërindikohet te:

- njerëzit e moshuar (0.00)

- gratë shtatzëna (0.50)

- fëmijët (0.00)

- pacientët me sëmundje kronike (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

186. Anestezioni lokal paraqet humbje reversibile të ndjeshmërisë për:

- dhimbje (0.50)

- presion (0.00)

- ndjenjë të nuhatje (0.00)

- ndjenjë të temperaturës (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

187. Anestezioni lokal paraqet humbje reversibile e ndjeshmërisë për:

- presion (0.00)

- prekje (0.00)

- ndjenjës për nuhatje dhe shije (0.00)

- ndjenjës për temperaturë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

188. M. Glancman paraqet:

- trombasteni (0.50)

- trombocitopeni (0.00)

- trombocitozë (0.00)

- trombofili (0.00)

- trombocitopati (0.00)

189. Paramolari i parë maksilar me Dg-parodontitis chr. paraqet indikacion për:

- ekstrakcion (0.00)

- apikotomi (0.50)

- terapi konservative (0.00)

- osteotomi transmaksilare (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

190. Marsupializimi është metodë kirurgjikale për:

- largimin e trupit të huaj (0.00)

- cistektomi (Partch II) (0.00)

- largimin e plotë të cistës (0.00)

- largimin e pjesshëm të sakusit cistik (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

191. Materiali i përgatitur me metodat antiseptike është:

- i sterilizuar (0.00)

- i dezinfektuar (0.50)

- i sterilizuar dhe dezinfektuar (0.00)

- të tjera (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

192. Materiali i përgatitur me metodat antiseptike është:

- i sterilizuar (0.00)

- i dezinfektuar (0.50)

- i sterilizuar dhe dezinfektuar (0.00)

- të tjera (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

193. Sipërfaqja meziale ose sipërfaqja nazale (facies nasalis) e kockës palatinale merr pjesë në ndërtimin e:

- apertura piriformis (0.00)

- meatus nasi inferior (0.00)

- meatus nasi superior (0.00)

- foramen sphenopalatinum (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

194. Metali nga i cili derdhen më shpesh implantet është:

- titani (0.50)

- çeliku medicinal (0.00)

- aliazhi i arit dhe platina (0.00)

- aliazhi i argjendit dhe platinës (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

195. Metodat e sterilizimit të thatë:

- ndezje, me flakë, djegie (0.50)

- tharrje, me flakë, djegie (0.00)

- vlim, tharje, me flakë (0.00)

- vlim, me flakë, ftohje (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

196. Mekanizmi i veprimit të penicilinës realizohet përmes: +

- frenimit të sintezës së proteinave (0.00)

- frenimit të sintezës së murit qelizor (0.50)

- ndryshimit të përshkueshmërisë së membranës qelizore (0.00)

- frenimit të sintezës së acidit nukleik (0.00)

- të gjitha nga këto më sipër (0.00)

197. Dega e përzier e n. mandibularis është:

- n. buccalis (0.00)

- n. pterygoideus medialis (0.00)

- n. alveolaris inferior (0.50)

- n. linqualis (0.00)

- n. auriculotemporalis (0.00)

198. Muskujt e mimikës inervohen nga:

- n. facialis (0.50)

- n. trigeminus (0.00)

- n. accesorius (0.00)

- n. hypoglossus (0.00)

- n. throchlearis (0.00)

199. Fijet motorike të n. alveolaris inferior marrin pjesë në inervimin e:

- m. geniohyoideus (0.00)

- m. masseter (0.00)

- m. pterygoideus medialis (0.00)

- m. buccinator (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

200. Cistat mukozale retencionale më së shpeshti lokalizohen në:

- buzën e poshtme (0.50)

- palatum (0.00)

- qiellzën e butë (0.00)

- mbi incizivët (0.00)

- mbi molarët (0.00)

201. Lambo mukoperiosteale është:

- incizion i përbërë nga mukoza dhe periosti (0.50)

- incizion i përbërë nga mukoza dhe lëkura (0.00)

- graft kockor (0.00)

- vulnus scissum (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

202. Në lingula mandibulae ngjitet:

- lig. stylomandibulare (0.00)

- lig. collaterale mediale (0.00)

- raphe pterygomandibulare (0.00)

- lig. laterale (0.00)

- lig sphenomandibulare (0.50)

203. Në processus coronoideus ramus mandibulae ngjitet:

- m. pterygoideus medialis (0.00)

- m. temporalis (0.50)

- m. sternocleidomastoideus (0.00)

- m. masseter (0.00)

- m. pterygoideus lateralis (0.00)

204. Në gjembat e sipërme të spinia mentalis ngjitet:

- m. geniohyoideus (0.00)

- m. mylohyoideus (0.00)

- m. omohyoideus (0.00)

- m. genioglossus (0.50)

- m. thyrohyoideus (0.00)

205. Në cilën pjesë laterale të nofullës (facies maxillaris) të kockës palatinale shtrihet mjekra palatinale (sulcus palatinus major), e cila merr pjesë në ndërtimin e kanalit të madh palatinal (canalis palatinus majus):

- pterygoide (0.00)

- sinusoidale (0.00)

- maksilare (0.50)

- pterygopalatine (0.00)

- fossa pterygopalatine (0.00)

206. Sa mm poshtë rrënjës së molarit të tretë të poshtëm dhe molarit të dytë të poshtëm kalon canalis mandibularis: .

- 2 - 3 mm (0.00)

- 4 mm (0.00)
- 8 mm (0.00)
- 6 - 7 mm (0.50)
- 5 mm (0.00)

207. Sa centimetra lateralisht nga linja mediale e mandibulës gjendet foramen mentale:

- 2 cm (0.00)
- 4 cm (0.00)
- 3.5 cm (0.00)
- 3 cm (0.50)
- 5 cm (0.00)

208. Në kocken palatinale dallohen këto pjesë kryesore:

- processus frontalis (0.00)
- pars basilaris (0.00)
- lamina lateralis processus pterygoidei (0.00)
- lamina cribrosa (0.00)
- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

209. Cista nasopalatine është:

- cistë inflamatore (0.00)
- cistë odontogjene (0.00)
- cistë traumatike (0.00)
- cistë joodontogjene zhvillimore (0.50)
- cistë reziduale (0.00)

210. Shkallë më të lartë të recidivit kanë:

- cistat folikulare (0.00)

- cistat radikulare (0.00)

- keratocistat odontogjene (0.50)

- cistat nazoglobulare (0.00)

- cistat parodontale laterale (0.00)

211. Rezultate më të mira jep:

- izotransplantimi (0.00)

- alotransplantimi (0.00)

- heterotransplantim (0.00)

- ksenotransplantimi (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

212. Forma më e rëndë e infeksionit odontogjen është: flegmona e dyshemesë së zgavrës së gojës, e njohur si_Angina Ludovici. Ky infeksion përfshin gjithësej:

- dy hapësira (0.00)

- tre hapësira (0.00)

- pesë hapësira (0.50)

- një hapësirë (0.00)

- katër hapësira (0.00)

213. Komplikimi më i rëndë gjatë largimit të torusit palatinal është:

- hapja e fundusit të syrit (0.00)

- hapja e dyshemesë së zgavrës së gojës (0.00)

- hapja e dyshemesë së hundës (0.50)

- hapja e sinusit maksillar (0.00)

- dëmtimi i plexus dentalis superior (0.00)

214. Indikacioni më i zakonshëm për reimplantimin e dhëmbëve është:

- terapeutik (0.00)

- post-traumatik (expulsio dentis) (0.50)

- parodontopatia (0.00)

- parodontiti kronik (0.00)

- malpozicioni i dhëmbit (0.00)

215. Komplikimet më të zakonshme postoperative te dhëmbët e impaktuar janë:

- gjakderdhja sekondare (0.00)

- infeksionet (0.00)

- plasaritja e perit (0.00)

- rritja e temperaturës trupore (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

216. Nocioni më i zakonshëm për lidhjen e fortë mes implantit dhe kockës është:

- fibroza (0.00)

- ankiloza (0.50)

- anastomoza (0.00)

- implantoza (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

217. Nekroza si komplikacion gjatë administrimit të anestezionit lokal, ndodh si rezultat i:

- dhënies së anestezionit në sinus maxilaris (0.00)

- dhënies së anestezionit në muskul (0.00)

- dhënies së anestezionit në artikulacion (0.00)

- administrimi i shpejtë subperiostal i anestetikut (0.50)

- dhënies epiperiostale të anestezionit(0.00)

218. Elevatori tek, që përdoret në nofullën e poshtme është:

- Seldin (0.00)

- Krieri (0.00)

- këmba e dhisë (0,50)

- Baini (0.00)

- apeks elevatori (0.00)

219. Menjëherë pas ekstrakcionit të dhëmbit, që të zvogëlohet resorbimi i kreshtës alveolare dhe të fitohet një kreshtë alveolare e formuar mire, në alveolë mund të implantohet:

- material plastik (0.00)

- të gjithë implantet veprojnë patologjikisht në ind (0.00)

- nuk është e dëshirueshme të ndërhyhet në plagën ekstrakcionale (0.00)

- nuk është e mundur të ndikohet në procesin e resorbimit (0.00)

- implant hidroksiapatiti dhe suturimi primar i plagës (0.50)

220. Përmes cilës hapje kalon n. facialis:

- foramen lacerum (0.00)

- foramen ovale (0.00)

- foramen infraorbitale (0.00)

- foramen rotundum (0.00)

- foramen stylomastoideum (0.50)

221. Numri normal i trombociteve në gjak është:

- 60- 80 x10 në 9 / l në 1 mm3 (0.00)
- 150-300x10 në 9 / l në 1 mm3 (0.50)
- 80- 130 x10 në 9 / l në 1 mm3 (0.00)
- 120 - 500 x10 në 9 / l në 1 mm3 (0.00)
- 15 - 3- x10 në 9 / l në 1 mm3 (0.00)

222. Vlerat normale të kohës së protrombinës me tromboplastin lepuri janë:

- 11 - 13 sekonda (0.50)
- 6 - 8 sekonda (0.00)
- 17 - 20 sekonda (0.00)
- 21 - 25 sekonda (0.00)
- 26 - 30 sekonda (0.00)

223. Vlerat normale të kohës së protrombinës me tromblastin lepuri janë:

- 11 - 13 sek. (0.50)
- 6 - 8 sek. (0.00)
- 17 - 20 sek. (0.00)
- 26 - 30 sek. (0.00)
- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

224. Lehtësimi i dhimbjes në fushën operative të apikotomisë kryhet me:

- anestezion pleksus (0.00)
- anestezion terminal (0.00)
- bllok anestezion (0.50)

- anestezion sipërfaqësor (0.00)

- aanestezion dolorosa (0.00)

225. Lehtësimi i dhimbjes për apikotomi të planifikuar të kaninit maksilar arrihet me:

- tuber anestezion (0.00)

- torus anestezion (0.00)

- anestezion infraorbital (0.50)

- anestezion sipas Brown-it (0.00)

- metoda apodaktile sipas Kantoroviç ((0.00)

226. Nga cili nerv kranial vijnë fijet parasimpatike që inervojnë gjëndrën parotide të pështymës?

- n trigeminus (0.00)

- n facialis (0.00)

- n glossopharyngeus (0.50)

- n hypoglossus (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

227. Protezat joadekuate, të vjetra mund të shkaktojnë hiperplazion të mukozës që quhet:

- epulis fissuratum (0.50)

- epulis pyogenicum (0.00)

- epulis inflamata (0.00)

- cistë (0.00)

- cheilitis (0.00)

228. Cista odontogjene pa folikul në lumenin e saj quhet:

- cista folikulare (0.00)

- cista primordiale (0.50)

- cista eruptive (0.00)

- cista traumatike (0.00)

- cista fisurale (0.00)

229. Cista odontogjene me një pjesë të dhëmbit në lumenin e saj quhet:

- cista primordiale (0.00)

- keratocista odontogjene (0.00)

- cista folikulare (0.50)

- granuloma eozinofile (0.00)

- cista nazopalatinale (0.00)

230. Numri optimal i rrotullimeve për vendosjen e implantit është:

- nga 500 deri në 1700 rrotullime në minutë (0.00)

- nga 700 deri në 1000 rrotullime në minutë (0.50)

- nga 900 deri në 1400 rrotullime në minutë (0.00)

- të gjitha të lartëpërmendurat (0.00)

- asnjëra nga këto më sipër (0.00)

231. Kundërindikacionet e përgjithshme për implantim janë:

- humbje vertikale të kockës (0.50)

- kratere interdentale (0.00)

- bulbuse kockore (0.00)

- fenestrime (0.00)

156. Xhepa infrakockor me dy mure kockore mund të gjenden

- si xhepa cirkumferente (0.00)

- si xhepa serpenginoze (0.00)

- në hapësirën interdentale (0.50)

- xhepa infrakockor (0.00)

- xhepa suprakockor (0.00)

157. Ënjtjet elastike të ngurta ireverzibile dhe pa dhimbje janë të pranishme në:

- Sindromën e Mischer-it (0.50)

- Sindromën e Melkerson-Rosenthal-Shuermann-it (0.00)

- sindromën e Acher-it (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

158. Mucocelet vërehen më shpesh në:

- buzën e poshtme (0.00)

- buzën e sipërme (0.50)

- gjuhë (0.00)

- qiellzën e butë (0.00)

- faqe (0.00)

159. Ku haset shenja karakteristike e glossitis Moler Hunter-it?

- te anemia ferrodeficitare (0.00)

- te anemia megaloblastike (0.50)

- te anemia aplastike (0.00)

- te talasemia (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

160. Ndonjëherë mund të ndodhin komplikime të lingua plicata:

- nëse brazdat thellohen dhe infektohen (0.50)

- nëse brazdat janë të shumta edhe pse janë të cekëta (0.00)

- nëse shfaqen brazda në anën ventrale të gjuhës (0.00)

- nëse brazdat shtrihen deri në skajet e gjuhës (0.00)

- nuk ka përgjigje të saktë (0.00)

161. Në fijet kolagjene mund të shfaqet degjenerimi nëse mungon:

- vitamina B (0.00)

- vitamina C (0.50)

- vitamina A (0.00)

- vitamina E (0.00)

- vitamina B2 (0.00)

162. Ndonjëherë mund të ndodhin komplikime të lingua plicata:

- nëse brazdat thellohen dhe infektohen (0.50)

- nëse brazdat janë të shumta edhe pse janë të cekëta (0.00)

- nëse shfaqen brazda në anën ventrale të gjuhës (0.00)

- nëse brazdat zgjerohen edhe në buzë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

163. Sëmundja e Addison-it karakterizohet nga:

- makulat e pigmentuara (0.50)

- makulat hemorragjike (0.00)

- makulat vaskulare (0.00)

- edema (0.00)

- vezikulat dhe bullat (0.00)

164. Cili tip i makulave të mëposhtme shfaqen tek sëmundja e Adison-it?

- hemorragjike (0.00)

- vaskulare (0.00)

- pigmentuara (0.50)

- intraepiteliale (0.00)

- subepiteliale (0.00)

165. Tek sialoadeniti bakterial terapia është:

- antibiotike (0.50)

- antihistaminike (0.00)

- citostatike (0.00)

- kortikosteroide (0.00)

- hormonale (0.00)

166. Në cilën sëmundje është e nevojshme të bëhet drenazha?

- parodontopatinë kronike (0.00)

- parodontopatinë e lokalizuar agresive (0.00)

- parodontopatinë e gjeneralizuar agresive (0.00)

- parodontopatinë ulçeronekrotike (0.00)

- abscesin periodontal (0.50)

167. Në cilën nga sëmundjet e mëposhtme vezikulat nuk spërkasin kurrë?

- stomatitis herpetica (0.50)

- herpes zoster(0.00)

- varicella (0.00)

- mononukleoza infektive (0.00)

- herpangina (0.00)

168. Në cilën nga sëmundjet e mëposhtme nuk ndryshon ngjyra në lëkurën mbi gjëndër?

- parotiti epidemik virusal (0.50)

- parotiti infekcioz supurativ (0.00)

- sialoadeniti submaksillar dhe sublingual (0.00)

- në të gjitha sëmundjet e gjëndrave të pështymës shfaqet ndryshim në ngjyrën mbi vetë gjëndrat (0.00)

- në asnjë nga sëmundjet e gjëndrave të pështymës nuk ka ndryshim të ngjyrës mbi vetë gjëndrat (0.00)

169. Në cilin lloj të defekteve kockore hapja kirurgjikale është mënyra e vetme dhe e sigurt për të përcaktuar praninë dhe konfiguracionin e?

- defekteve horizontale kockore (0.00)

- defekteve vertikale kockore (0.00)

- defekteve horizontale dhe vertikale kockore (0.00)

- kratereve interdentale (0.50)

- bulbuseve kockore (0.00)

170. Tek leukoedema epiteli është:

- në gjendje normale (0.00)

- në dukje në gjendje normale (0.00)

- i alteruar me depozite që mund të largohen (0.00)

- i alteruar me depozite që nuk mund të largohen (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

171. Në pasqyrën klinike të parodontopatisë me progresion të ngadaltë kemi:

- inflamacion kronik të gingivës (0.50)

- humbje të shpejtë të kockës (0.00)

- xhepa jashtëzakonisht të thellë periodontal (0.00)

- prani të parëndësishme të pllakut dentar (0.00)

- mungesë të inflamacionit të dukshëm klinikisht (0.00)

172. Tek pacientët që marrin radioterapi, për shkak të shfaqjes së syndromës rrezatuese nuk duhet të ndërmerren ndërhyrjet e mëposhtme:

- ekstrakcioni i dhëmbëve dhe përpunimi i xhepave periodontal (0.50)

- pastrimi i dhëmbëve dhe heqja e depozitave të buta (0.00)

- të aplikohen pika Nystatin (0.00)

- larja e gojës me mjete dezinfektuese të buta (0.00)

- të merren vitamina (0.00)

173. Tek pacientët me anemi hipokromike, inflamacioni gingival është i llojit:

- gingivitis ulceronecroticans (0.00)

- gingivitis desquamativa chr.(0.00)

- gingivitis catharalis ose gingivitis hyperplastica (0.50)

- gingivitis atrophicans (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

174. Në fazën primare të sifilizit reagimi i nyjeve limfatike regjionale është i njohur si:

- fenomeni i urave fibroze (0.00)

- kompleksi sekondar (0.00)

- bulbo indolens (0.50)

- condylomata lata (0.00)

- gumma sifilitike (0.00)

175. Në aneminë e ferrodeficiencës ndryshimet e gjuhës manifestohen si:

- lingua areata migrans (0.00)

- lingua villosa (0.00)

- lingua glabra (0.50)

- ankiloglosia (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

176. Çfarë premedikimi aplikohet gjatë heqjes së vatrave dentogjene:

- antibiotikë, antihistaminikë, vitamine C (0.50)

- antibiotikë, kortikosteroide (0.00)

- antibiotikë, virostatikë, vitaminë C (0.00)

- antibiotikë, qetësues, vitaminë B compleks (0.00)

- antihistaminikë, kortikosteroide dhe vitaminë C (0.00)

177. Si klasifikohet parodontopatia me ecuri rapide:

- e lokalizuar (0.00)

- ulceronekrotike (0.00)

- juvenile (0.50)

- refraktare (0.00)

- kronike (0.00)

178. Si kryhet pjesa e zhvendosur në drejtim apikal me gjysmë trashësi?

- me diseksion të mprehtë me skalpel (0.50)

- me diseksion të hapur me një aparat respirator (0.00)

- në një kënd prej 25-45 gradë me një scalpel (0.00)

- në kënde të drejta të raspatoriumit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

179. Si quhen defektet e kockës alveolare në formën e prerjes (në formën e shkronjës V)?

- dehiscenca (0.50)
- fenestrime (0.00)
- aderimine (0.00)
- aderime (0.00)
- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

180. Si quhen defektet e kockës alveolare në formë të dritares?

- dehiscenca (0.00)
- fenestrime (0.50)
- adhezione (0.00)
- aderime (0.00)
- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

181. Si quhen defektet e kockës alveolare në formë të dritares?

- dehiscenca (0.00)
- fenestrime (0.50)
- adherime (0.00)
- koherenca (0.00)
- adaptime (0.00)

182. Si hiqen pigmentet gingivare gjatë gingivitit mercurialis:

- me elektroforezë të vitaminës C (0.00)
- me largimin e gurit të dhëmbëve (0.00)

- me galvanizim katodë (0.50)

- me heqjen e depoziteve të buta (0.00)

- me llambo(flap) - intervenim(0.00)

183. Shtresa kambiale e epitelit të mukozës orale përbëhet nga:

- membrana bazale dhe stratum bazale (0.00)

- stratum bazale dhe stratum spinosum (0.00)

- stratum bazale, stratum spinosum dhe membrana bazale; (0.00)

- stratum bazale (0.50)

- stratum spinosum (0.00)

184. Simptomet karakteristike ekstraorale të mononukleozës infektive janë:

- hepatosplenomegalia, limfadenopatia e gjeneralizuar (0.50)

- sifilizi papular (0.00)

- infeksioni, kollitja, teshtima (0.00)

- polimorfizmi i ndryshimeve të llojit të eritemës, makula (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

185. Gjetja karakteristike radiologjike për abscesin periodontal përfshin:

- hollimin (rrallimin) dhe humbjen e mprehtësisë së lamina dura të kockës alveolare(0.00)

- humbjen horizontale dhe vertikale të kockës alveolare (0.00)

- zonën e kufizuar radioluscente përgjatë mureve të rrënjës së dhëmbit (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

- nuk ka përgjigje të saktë (0.00)

186. Qelizat që bien nga sipërfaqja e epitelit rigjenerohen:

- nuk rigjenerohen (0.00)

- rigjenerohen në vartësi të nevojave të organizmit (0.00)

- rigjenerohen herë pas here (0.00)

- rigjenerohen vazhdimisht (0.50)

- rigjenerohen në mënyrë ritmiket (0.00)

187. Paraqitja klinike e cheilitis alergica përfshin:

- të tretën e dytë dhe të tretë të vermilionit (0.00)

- zonën e Klein-it (0.00)

- ekskluzivisht vetëm pjesën e kuqe të buzëve (0.00)

- pjesën e kuqe të buzëve në tërësi dhe pjesën e lëkurës (0.50)

- vetëm pjesën e kuqe të buzëve (0.00)

188. Pasqyra klinike e Enanthema fixum karakterizohet nga:

- hiperemia difuze e mukozës orale (0.00)

- enantema e kufizuar qartë nga mjedisi (0.50)

- bula nën shtypje me majë të trashë që vështirë spërkasin (0.00)

- papula (0.00)

- ulçeracione të qiellzës me buzë të dhëmbëzuara, të dëmtuara (0.00)

189. Pamja klinike e manifestimit oral dhe kutan te Erythema exudativum multiforme është si më poshtë:

- me stadium prodromal, polimorfizëm të ndryshimeve në zgavrën e gojës ndërsa te ijet dhe në krahëror me bula të tensionuara me përmbajtje hemorragjike dhe seroze (0.00)

- me stadium prodromal me vezikula në qiellzën e fortë që kanë rradhitje në formë të rrushit, gingivit reaktiv ndërsa në lëkurën e pjesëve të poshtme të ekstremiteteve me bula dhe … (0.00)

- me stadium prodromal, polimorfizëm të ndryshimeve në gojë dhe në lëkurën e pjesëve të poshtme të gjymtyrëve (0.50)

-me stadium prodromal me vezikula që kanë shpërndarje të çrregullt në qiellzën e fortë, gingivit reaktiv ndërsa në lëkurën e pjesëve të poshtme të gjymtyrëve me bula dhe… (0.00)

- me stadium prodromal, me vezikulla në qiellzën e butë që kanë një rradhitje të ngjajshme si rrushi, gingivit reaktiv ndërsa në lëkurën e pjesëve të poshtme të gjymtyrëve me bula dhe… (0.00)

190. Humbja klinike e ataçmentit mund të jetë:

- më e madhe deri në thellësinë e xhepit periodontal (0.00)

- më pak se thellësia e xhepit periodontal (0.00)

- e barabartë me thellësinë e xhepit periodontal (0.00)

- e saktë është nën a dhe b (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.50)

191. Gjetjet klinike dhe laboratorike tek sindroma Feltie përfshijnë:

- splenomegali, hepatomegali, nyje të vogla dhe eritemë të mukozës orale, anemi,

trombocitopeni (0.00)

- shpretkë, mëlçi dhe nyje limfatike të rritura, hiperpigmentim të mukozës orale, anemi, trombocitopeni dhe granulocitopeni (0.50)

- adinami, humbje të oreksit dhe të peshës trupore, erozione dhe ulçeracione të mukozës orale që përfundojnë me cikatriks(shenjë), anemi, granulocitopeni (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

192. Ekzaminimi klinik i parodontit përbëhet nga:

- radiografia dhe inspektimi (0.00)

- inspektimi, palpimi, sondimi dhe perkusioni (0.50)

- ekzaminimi i vitalitetit dhe inspektimi (0.00)

- ekzaminimi i vitalitetit, inspektimi dhe radiografia (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

193. Kur nuk rekomandohet koronoplastika:

- kur ajo do të çojë në normalizimin e traumës e cila e shkaktoi atë (0.00)

- kur ajo do të rezultojë me stabilizim okluzal të përshtatshëm për procedurat e ardhshme restaurative dhe protetikore 0.00)

- në mënyrë që të parandalohet çdo traumë e ardhshme që do të prishte ekuilibrin e vendosur në mes të okluzionit dhe indit periodontal (0.50)

- përgjigjet nën a dhe b janë të sakta (0.00)

- përgjigjet nën b dhe c janë të sakta (0.00)

194. Kur kryhet gingivoplastika:

- te fibromatoza e trashëguar (0.00)

- te hiperplazia e kushtëzuar medikamentoze (0.00)

- kur është e nevojshme të rivendosen konturet fiziologjike të indeve (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

- nuk ka përgjigje të saktë (0.00)

195. Cila nga sëmundjet e mëposhtme karakterizohet nga prania e temefakcionit:

- parodontopatia kronike (0.00)

- parodontopatia agresive e lokalizuar (0.00)

- parodontopatia agresive e gjeneralizuar (0.00)

- parodontopatia ulçeronekrotike(0.00)

- abscesi parodontal (0.50)

196. Cila nga konstatimet e mëposhtme është e vërtetë:

- faza e parë e terapisë ndiqet nga faza kirurgjikale e terapisë (0.00)

- faza e parë e terapisë ndiqet nga faza korrigjuese e terapisë (0.00)

- faza e parë e terapisë ndiqet nga faza e ruajtjes së rezultateve (0.50)

- faza e parë e terapisë ndiqet nga largimi i faktorëve jatrogjen (0.00)

- nuk ka përgjigje të saktë (0.00)

197. Cili nga indet parodontale nuk ka vaskularizimin e vet?

- gingiva (0.00)

- cementi (0.50)

- periodonciumi (0.00)

- kocka alveolare (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

198. Cili nga indet parodontale nuk ka vaskularizimin e vet?

- gingiva (0.00)

- cementi (0.50)

- periodonciumi (0.00)

- kocka alveolare (0.00)

- cementi dhe kocka alveolare (0.00)

199. Cila nga sëmundjet e mëposhtme shfaqet më shpesh tek personat më të rinj

- parodontopatia kronike (0.00)

- parodontopatia agresive e lokalizuar (0.50)

- parodontopatia agresive e gjeneralizuar (0.00)

- parodontopatia ulçeronekritike (0.00)

- abscesi parodontal (0.00)

200. Cila nga pohimet e mëposhtme nuk është e vërtetë? Procedurat kirurgjikale në parodontologji synojnë:

- të përmirësojnë qasjen deri në sipërfaqet e rrënjës, gjë që mundëson largimin e devijimeve morfologjike të rrënjëve (0.50)

- të ndryshojë formën e indit gingival dhe kockor në mënyrë që të fitohet një topografi harmonike. (0.00)

- nuk ka përgjigje të saktë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

201. Cilat qeliza e përbëjnë substancën bazë dhe fijet gingivale?

- fibroblastet dhe fibrocitet (0.50)

- fibroblastet dhe histocitet (0.00)

- odontoblastet dhe fibroblastet (0.00)

- fibrocitet dhe odontoblastet (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

202. Cili nga antibiotikët e mëposhtëm vepron në florën anaerobe

- amoksicilina (0.00)

- tetraciklina (0.00)

- klindamicina (0.00)

- metronidazoli (0.00)

- cefalosporina (0.50)

203. Cila nga efloreshencat e mëposhtme ka përmbajtje të fortë:

- vezikula dhe bulla (0.00)

- papula dhe pustula (0.00)

- papula dhe tuberi (0.50)

- makula dhe edema (0.00)

- tuberi dhe pustula (0.00)

204. Cila nga papilat e mëposhtme nuk ka funksion gustator?

- papillae filiformes (0.50)

- papillae vallatae (0.00)

- papillae foliate (0.00)

- papillae circumvallatae (0.00)

- papillae fungiformes (0.00)

205. Cila nga gjendjet e mëposhtme karakterizohet nme inflamacion të zvogëluar gingival:

- tumoret gravidare (0.00)

- pacientët imunokompromitues (0.00)

- mungesa e vitaminës C (0.50)

- të sëmurët nga AIDS-i (0.00)

- pacientët me leukemi (0.00)

206. Cilat janë mikroorganizmat më të imët:

- kërpudhat (0.00)

- viruset (0.50)

- bakteret (0.00)

- protozoat (0.00)

- helmintet (0.00)

207. Cila vitaminë merr pjesë në hidroksilimin e prolinës dhe sintezën e kolagjenit:

- vitamina C (0.50)

- vitamina A (0.00)

- vitamina B6 (0.00)

- vitamina D (0.00)

- acid nikotinik (0.00)

208. Kush i krijon fijet e Sharpey-ut:

- cementoblastet (0.00)

- fibroblastet (0.50)

- osteoblastet (0.00)

- kondroblastet (0.00)

- qelizat mezenkimale të padiferencuara (0.00)

209. Cila pjesë e membranës bazale i takon epitelit ngjitës:

- str. reticulare (0.00)

- lamina densa (0.50)

- str. basale (0.00)

- epiteli i sulkusit (0.00)

- str. corneum (0.00)

210. Kush e lidh drejtpërdrejtë epitelin me smaltin?

- desmosomet (0.00)

- hemidesmosomet (0.00)

- lamina bazale (0.50)

- fijet gingivale (0.00)

- fijet transeptale (0.00)

211. Cila është pjesa anatomike e gingivës:

- epiteli oral (0.00)

- epiteli interdental (0.50)

- margo gingivae (0.00)

- linja mukogingivale (0.00)

- sulkusi gingival (0.00)

212. Cila është vitamina mbrojtëse e epitelit:

- vitamina C (0.00)

- vitamina E (0.00)

- vitamina B (0.00)

- vitamina A (0.50)

- vitamina K (0.00)

213. Cili është rezultati më i mirë terapeutik në përpunimin e xhepave parodontal?

- xhepi aktiv parodontal (0.00)

- xhepi joaktiv parodontal (0.00)

- sulkusi sekondar gingival (0.50)

- xhepi gingival (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

214. Cili është lloji më i zakonshëm i gingivitit që haset në leukeminë akute:

- gingiviti akut katarral (0.00)

- gingiviti ulçeronekrotik (0.50)

- gingiviti atrofik (0.00)

- gingiviti deskuamativ (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

215. Cila është shenja e parë klinike e sclerodermia cirkumscripta në zgavrën e gojës:

- ulçeracionet dhe atrofia e qiellzës (0.00)

- skleroza e buzëve dhe gjuhës (0.00)

- frenulum linguae i shkurtuar (0.50)

- të gjitha tiparet e përmendura më parë (0.00)

- vetëm skleroza e buzëve (0.00)

216. Kush e formon kufirin dentar të spatium periodontale:

- kufiri zmalt-cement (0.00)

- gingiva (0.00)

- septumi interadikular (0.00)

- periodonciumi (0.00)

- cementi i rrënjës së dhëmbit (0.50)

217. Kush e formon kufirin kockor të spatium periodontale:

- kocka alveolare (0.50)

- gingiva (0.00)

- septumi interadikular (0.00)

- periodonciumi (0.00)

- cementi i rrënjës së dhëmbit (0.00)

218. Cila nga simptomat e mëposhtme klinike nuk është tipike për sialoadenitin?

- ënjtja (0.00)

- dhimbje (0.00)

- shija e ndryshuar në gojë (0.50)

- skuqja (0.00)

- ulja e sekretimit të pështymës (0.00)

219. Cili nga termet e mëposhtëm paraqet simptomë dhe është një faktor etiologjik i paradontopatisë?

- guri i dhëmbit (0.00)

- granulacionet e inflamuara (0.00)

- granulacionet e inflamuara dhe cementi nekrotik (0.00)

- konkrementet subgingivale (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

220. Cila nga mjetet e mëposhtme është më e rëndësishme për mirëmbajtjen e higjienës së hapësirave interdentale?

- furça dhe pasta e dhëmbëve (0.00)

- solucionet dezinfektuese dhe kruerëset e dhëmbëve (0.00)

- furça elektrike (0.00)

- peri dentar, furça interdentale (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

221. Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk shkakton luksimin e dhëmbit?

- konsumimi i ushqimit të ngurtë abraziv (0.50)

- okluzioni traumatik (0.00)

- inflamacioni i indeve periodontale (0.00)

- resorbimi i kockës alveolare (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

222. Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk është i rëndësishëm për mineralizimin e pllakut dentar?

- ndryshimi i vlerës së pH-së së pështymës (0.00)

- proteinat e pllakut dentar dhe proteinat koloidale në pështymë (0.00)

- enzimat në pështymë (0.00)

- sasia e imunoglobulinës salivare A (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

223. Cili nga antibiotikët e mëposhtëm është i përqendruar në vendin e inflamacionit?

- azitromicina (0.00)

- tetraciklina (0.50)

- penicilina (0.00)

- cefaleksina (0.00)

- metronidazoli (0.00)

224. Cili nga grupet e mëposhtme të antibiotikëve mund të përdoret lokalisht në indet periodontale:

- amoksicilina (0.00)

- tetraciklina (0.50)

- klindamicina (0.00)

- cefalosporinet (0.00)

- metronidazoli (0.00)

225. Cila shtresë i takon membranës bazale të epitelit ngjitës:

- lamina lucida (0.50)

- str. reticulare (0.00)

- str. basale (0.00)

- epiteli i sulkusit (0.00)

- str. corneum (0.00)

226. Cili lloj i gingivitit është më i zakonshëm tek leukemia akute:

- gingiviti akut katarral (0.00)

- gingiviti hiperplastik (0.50)

- gingiviti atrofik (0.00)

- gingiviti deskuamues (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

227. Cili lloj i nekrozës është karakteristik për tuberkulozën?

- nekroza kazeoze (0.50)

- nekroza kolikvative (0.00)

- nekroza koagulative (0.00)

- nekroza e kombinuar (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

228. Cila është komplikimi më i zakonshëm i sëmundjes periodontale?

- pulpiti retrograd (0.00)

- abscesi periodontal (0.50)

- perikoroniti (0.00)

- pulpiti akut (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

229. Cila është dëmtimi primar i sifilizit në stadin primar:

- lupoma(0.00)

- gomma Luet (0.00)

- kompleksi primar (0.00)

- ulcus durum (0.50)

- luesi (0.00)

230. Cila është terapia e parotitis epidemica:

- simptomatike (0.50)

- kauzale (0.00)

- antibiotike (0.00)

- kortikosteroide (0.00)

- kirurgjikale (0.00)

231. Cila nga metodat ndihmëse diagnostike të mëposhtme ndihmon për të përcaktuar prognozën, planin e trajtimit dhe monitorimin e rezultateve të terapisë tek sëmundja periodontale?

- analiza citologjike (0.00)

- biopsioni (0.00)

- radiografia (0.50)

- testet imunologjike (0.00)

- nuk ka përgjigje të saktë (0.00)

232. Cila nga metodat ndihmëse diagnostike të mëposhtme ndihmon për të përcaktuar prognozën, planin e trajtimit dhe monitorimin e rezultateve të terapisë tek sëmundja periodontale?

- analiza citologjike (0.00)

- biopsioni (0.00)

- radiografia (0.50)

- analiza biokimike (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

233. Cila nga kiretat e mëposhtme përdoret për të përpunuar sipërfaqet mesiale të molarëve:

- kireta e Grace 1/2 (0.00)

- kireta e Grace 7/8 (0.00)

- kireta e Grace 9/10 (0.00)

- kireta e Grace 11/12 (0.50)

- kireta e Grace 13/14 (0.00)

234. Cila nga ndryshimet e mëposhtme është më karakteristike për leukoplakinë:

- pustula (0.00)

- ulçeracionet (0.00)

- hiperkeratoza ngjitëse (0.50)

- makula (0.00)

- edema (0.00)

235. Cila nga gjendjet e mëposhtme nuk është indikacion për operacion me llambo(flap) të modifikuar të Widman-it?

- xhepat parodontal infrakockor (0.00)

- recesioni i izoluar gingival (0.50)

- abscesi kronik periodontal (0.00)

- xhepat parodontal në regjionin e furkacionit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

236. Çfarë ndryshimi e karakterizon pasqyrën klinike të gingivitit ulçeronekrotik

- ndryshimet gangrenoze të gingivës margjinale (0.50)

- eksudati purulent që shkëputet nga gingiva margjinale (0.00)

- inflamacioni i tipit eksudativ me nekrozë ulcerative (0.00)

- ndryshimet ulçerative erozive me eksudat purulent të gingivës margjinale (0.00)

- inflamacioni me ndryshime erozive të gingivës margjinale (0.00)

237. Cili është faktori etiologjik i parotititis epidemica:

- virusi i mumps nga grupi i paramyxovirusit (0.50)

- streptococcus pyogenes (0.00)

- staphilococcus aureus (0.00)

- treponema pallidum (0.00)

- virusi HIV (0.00)

238. Kolagjenaza dhe proteazat e mikroorganizmave të pllakut dentar çojnë deri tek:

- aktivizimi i përgjigjes imune (0.00)

- dëmtimi i drejtpërdrejtë i indit (0.50)

- inflamacioni (0.00)

- citoliza (0.00)

- dëmtimi i membranës citoplazmike (0.00)

239. Sa incizione bëhen kur kryhet operacioni me llambo(flap) të modifikuar sipas Widman-it

- 2 incizione (primare dhe sekondare) (0.00)

- 4 incizione (primare, sekondare, terciare dhe interne) (0.00)

- 3 incizione (primare, sekondare dhe terciare) (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

240. Sekuestrimi kockor mund të shfaqet tek:

- parodontopatia kronike (0.00)

- parodontopatia agresive (0.00)

- parodontopatia ulçeronekrotike (0.50)

- abscesi periodontal (0.00)

- parodontopatia te sëmundjet sistemike (0.00)

241. Gjakderdhja dhe eksudimi purulent

- janë indikatorë klinik të procesit inflamator. (0.50)

- janë indikatorë për rëndësinë e sëmundjes (0.00)

- nuk mund të tregojnë praninë e ulçeracioneve të epitelit të murit të butë të xhepit parodontal (0.00)

- nuk janë të rëndësishëm në prognozën e sëmundjes periodontale (0.00)

- janë në lidhje me ekzistencën e parodontopatisë ulçeronekrotike (0.00)

242. Kriteri për të pasur një prognozë të pashpresë është:

- kuanti i mbetur i indit kockor është i mjaftueshëm (0.00)

- indikacioni për ekstrakcion (0.50)

- luksacioni i dhëmbëve të caktuar (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

- nuk ka përgjigje të saktë (0.00)

243. Kriteri për të pasur një prognozë mesatare është:

- kuanti i mbetur i indit kockor është i mjaftueshëm (0.50)

- përfshirja e furkacionit të shkallës së dytë (0.00)

- luksacioni i dhëmbëve të caktuar (0.00)

- nuk ka përgjigje të saktë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

244. Abscesi i ftohtë është karakteristikë te njëra prej sëmundjeve të mëposhtme:

- aktinomikoza (0.00)

- tuberkuloza (0.50)

- NOMA (0.00)

- SIDA (0.00)

- sifilizi (0.00)

245. Lezionet nga kafshimet epileptike janë më shpesh:

- ulçera të thella me formë të parregullt dhe madhësi të ndryshme (0.50)

- erozione të rregullta të cekëta (0.00)

- erozione në formë të pikave të rregullta dhe të çregullta (0.00)

- defekte lineare të thella (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

246. Trajtimi i parotitis epidemica-Mumps përfshin:

- drenazhë dhe dhënie të antibiotikëve (0.00)

- lëngje, regjim higjieno-dietetik (0.50)

- terapi simptomatike (0.00)

- vetëm trajtim lokal (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

247. Trajtimi i parotitis infectiosa përfshin:

- drenazhë dhe dhënie të antibiotikëve (0.50)

- lëngje, regjim higjieno-dietetik (0.00)

- terapi simptomatike (0.00)

- vetëm trajtim lokal (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

248. Trajtimi i gingivitit, në mënyrë që të parandalohet shndërrimi i gingivitit në parodontopati dhe trajtimi i formave fillestare të parodontopatisë me qëllim që të parandalohet përparimin i sëmundjes është pjesë e:

- masave primare preventive të parodontopatisë (0.00)

- masave terciare preventive të parodontopatisë (0.00)

- masave sekondare preventive të parodontopatisë (0.50)

- nuk janë masa preventive (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

249. Forma e butë e cheilitis exfolitaiva sicca trajtohet me:

- kremëra kortikosteroide (0.00)

- kremëra antibiotike (0.00)

- kombinim i kremërave kortikosteroide dhe antibiotike (0.00)

- kremëra neutrale (0.50)

- 2% hidrogjen dhe metilen blu (0.00)

250. Leukoplakia shfaqet në:

- dyshemenë e zgavrës së gojës (0.50)

- gingivë (0.00)

- qiellzën e fortë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

251. Leukoplakia shfaqet në:

- dyshemenë e zgavrës së gojës (0.50)

- gingivë (0.00)

- qiellzën e fortë (0.00)

- qiellzën e butë (0.00)

- buzët (0.00)

252. Kontrolli i dobët i glikemisë sjell deri në:

- rritje të ndjeshme të rrezikut të resorbimit të kockës alveolare, por gjithsesi nuk ka përshpejtim të progresionit të sëmundjes parodontale (0.00)

- rritje të ndjeshme të rrezikut të resorbimit të kockës alveolare dhe progresion të sëmundjes parodontale të përshpejtuar (0.50)

-rritje të lehtë të rrezikut të resorbimit të kockës alveolare dhe progresion të ngadaltë të sëmundjes parodontale (0.00)

- rritje të ndjeshme të rrezikut të resorbimit të kockës alveolare dhe progresion të ngadaltë të sëmundjes parodontale (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

253. Macrocheilia është një nga simptomat e sëmundjeve të mëposhtme:

- Sindroma e Mischer-it (0.00)

- Sindroma e Acher-it (0.00)

- Sindroma e Melkerson-Rosental-Schuermann-it (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

254. Macrocheilia është një nga simptomat e sindromave të mëposhtme:

- Behcet (0.00)

- Sjogren (0.00)

- Melkerson - Rosental - Schuermann (0.50)

- Mikulic (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

255. Efekti maksimal terapeutik gjatë trajtimit të formës erozivo-ulçerative të lichen planus është:

- tërheqja e plotë e ndryshimeve në mukozën orale; (0.00)

- shndërrimi i kësaj forme klinike në formë më të butë (retikulare); (0.50)

- tejkalimi vetëm i simptomatologjisë lokale; (0.00)

- migrimi i ndryshimeve të mukozës orale nga një zonë në tjetrën (0.00)

- nuk ka përgjigje të saktë (0.00)

256. Efekti maksimal terapeutik gjatë trajtimit të formës erozivo-ulçerative të lichen planus është:

- tërheqja e plotë e ndryshimeve në mukozën orale (0.00)

- shndërrimi i kësaj forme klinike në formë më të butë (0.50)

- tejkalimi vetëm i simptomatologjisë lokale (0.00)

- migrimi i ndryshimeve të mukozës orale nga një zonë në tjetrën (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

257. Materia alba është:

- pllak dentar i mineralizuar (0.00)

- përqëndrimi i mikroorganizmave, qelizave epiteliale të deskuamuara, leukociteve dhe proteinave salivare dhe lipide me pak ose aspak grimca nga ushqimi që nuk ka strukturë të brendshme të pllakut dentar (0.50)

- faza e parë në krijimin e pllakut të maturuar dentar (0.00)

- lloj i pelikulës dentare (0.00)

- shtresë mbrojtëse e dhëmbit (0.00)

258. Muri i butë i xhepit periodontal trajtohet me:

- daltë dhe (0.00)

- instrument me ultrazë (0.00)

- kiretë në formë lobi, maje dhe luge (0.50)

- instrument me grep (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

259. Metaplasia bën pjesë në grupin e:

- dëmtimeve reverzibile (0.50)

- dëmtimeve ireverzibile (0.00)

- inflamacioneve kronike (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

260. Lëndimet mekanike të shkaktuara nga furça e dhëmbëve zakonisht lokalizohen te:

- gingiva (0.50)

- sipërfaqja dorzale e gjuhës (0.00)

- qiellza e fortë (0.00)

- dyshemeja e zgavrës së gojës (0.00)

- buzët (0.00)

261. Mikroorganizmat që zbulohen menjëherë pas lindjes më së shumti i përkasin llojit të:

- streptococcus (0.50)

- treponema (0.00)

- peptococcus (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

262. Mineralet te konkrementët subgingival rrjedhin nga:

- lëngu gingival (0.50)

- pështyma parotide (0.00)

- pështyma submandibulare (0.00)

- pështyma sublinguale (0.00)

- ushqyerja (0.00)

263. Sindroma e Mischer-it trajtohet në mënyrë kirurgjikale pas:

- remisionit të parë (0.00)

- pas gjashtë muajsh nga fillimi i sëmundjes (0.00)

- pas disa sulmeve të njëpasnjëshme (0.00)

- pas stabilizimit të ënjtjes dhe pa sulme të reja për disa vite (0.50)

- trajtohet vetëm me kërkesë të pacientit (0.00)

264. Krustat me ngjyrë të bardhë të qumështit mbi fisurat dhe ragadat gjatë cheilitit angular asocojnë në:

- infeksion bakterial (0.00)

- infeksion viral (0.00)

- natyrë alergjike të sëmundjes (0.00)

- infeksion mikotik (0.50)

- raport të dëmtuar ndërnofullor (0.00)

265. Krustat me ngjyrë të bardhë të qumështit mbi fisurat dhe ragadat gjatë cheilitit angular asocojnë në:

- infeksion bakterial (0.00)

- infeksion viral (0.00)

- manifestim alergjik (0.00)

- infeksion mikotik (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

266. Komplikimet e mundshme të sialoadenitit bakterial janë:

- paraliza kalimtare e nervit facial (0.50)

- alopecia (0.00)

- goma në gjuhë (0.00)

- gingiviti ulçeronekrotik (0.00)

- gingiviti ulçeroz (0.00)

267. Pamja mongoloide, mukoza e zbehtë e orale, glosodynia, atrofia e papillave të gjuhës, protruzioni i dhëmbëve të sipërm të përparmë, kafshim i hapur dhe malokluzioni janë gjetje karakteristike te:

- leukemia (0.00)

- talasemia (0.50)

- neutropenia ciklike (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

268. Çfarë lloji i mukozës është i pranishëm në gingivë

- mastikatore (0.50)

- mbuluese (0.00)

- e specializuar (0.00)

- e trashur (0.00)

- nuk ka përgjigje të saktë (0.00)

269. Në kufirin smalt-cement gjendet fundi i:

- sulkusit sekondar gingival dhe xhepit parodontal joaktiv(0.00)

- xhepit parodontal aktiv dhe joaktiv (0.00)

- sulkusit gingival dhe xhepit të rrejshëm parodontal (0.50)

- sulkusit sekondar gingival (0.00)

-të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

270. Pasojë e kujt janë ndryshimet orale te anemia aplastike:

- numrit të zvogëluar të eritrociteve, trombociteve dhe leukociteve (0.50)

- mungesës së vitaminës B12 dhe acidit folik (0.00)

- hemolizës së eritrociteve (0.00)

- reaksionit alergjik (0.00)

- transfuzionit të gjakut (0.00)

271. Fijet më të shumta periodontale janë:

- fijet e kolagjenit (0.50)

- fijet elastike (0.00)

- fijet acidorezistente (0.00)

- fijet oksitaline (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

272. Fijet më të shumta periodontale janë:

- fijet elastike (0.00)

- fijet elastike (0.50)

- acidorezistente (0.00)

- oksitaline (0.00)

- retikulare (0.00)

273. Faza më infektive e sifilizit është:

- faza primare (0.00)

- faza sekondare (0.50)

- faza destruktive (0.00)

- sifilizi kongjenital (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

274. Ndryshimet më karakteristike të parodontit tek diabetikët janë:

- ndryshime vaskulare (0.50)

- ndryshimet osteoporotike të kockës alveolare (0.00)

- pigmentimet gri-të errëta të gingivës (0.00)

- recesioni i gingivës (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

275. Shenjat e hershme të sklerodermës sistemike në gojë janë:

- pllaka të kuqe në faqe(0.00)

- cheilitis exfoliativa sicca (0.00)

- pllaka të bardha keratotike dhe frenulum i shkurtuar i gjuhës (0.50)

- mikrostomia dhe ekzoftalmusi (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

276. Metoda më e sigurtë për diagnostikimin e xhepave periodontal është:

- radiografia (0.00)

- sondimi (0.50)

- palpimi (0.00)

- perkusioni (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

277. Metoda më e sigurtë për diagnostifikimin e xhepave periodontal është:

- radiografia (0.00)

- sondimi (0.50)

- palpimi (0.00)

- perkusioni (0.00)

- perfuzioni (0.00)

278. Problemi më i vështirë por edhe më i rëndësishëm që duhet të zgjidhet për të arritur parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes periodontale është:

- motivimi i individit për mirëmbajtjen e higjienës së zgavrës së gojës (0.50)

- të mësohet individi të lajë dhëmbët (0.00)

- të zgjedh furçë të përshtatshme për dhëmbë (0.00)

- të zgjedh teknikë të përshtatshme për larjen e dhëmbëve (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

279. Lloji më i zakonshëm i gingivitit që haset në leukeminë akute është:

- gingiviti akut katarral (0.00)

- gingiviti ulçeronekrotik (0.00)

- gingiviti hiperplastik (0.00)

- e saktë është nën a dhe b (0.00)

- e saktë është nën b dhe c (0.50)

280. Lokalizimi më i zakonshëm i gurit supragingival të dhëmbit është:

- sipërfaqja vestibulare e incizivëve maksilar dhe sipërfaqet linguale të molarit të parë të poshtëm (0.00)

- sipërfaqet palatinale të incizivëve të sipërm dhe sipërfaqet bukale të incizivëve të parë të poshtëm (0.00)

- sipërfaqet bukale të molarëve maksilar dhe sipërfaqet linguale të regjionit frontal mandibular (0.50)

- sipërfaqet bukale të molarëve maksilar dhe sipërfaqet bukale të incizivëve mandibularë (0.00)

- sipërfaqet linguale të molarëve maksilar dhe sipërfaqet linguale të regjionit frontal mandibular (0.00)

281. Manifestimi më i zakonshëm klinik i pemfigoidit beninj mukozal është:

- në lëkurë, dhe pothuajse inekzistent në gojë; (0.00)

- në buzë, dhe domosdoshmërisht në lëkurë; (0.00)

- në gojë-gingivë, mund të jetë edhe në lëkurë por jo patjetër; (0.50)

- në gojë te gingiva, te fytyra rreth hundës dhe në lëkurën e trupit; (0.00)

- nuk ka përgjigje të saktë (0.00)

282. Ndryshimet më të zakonshme orale që hasen në aneminë aplastike janë:

- gingiviti akut ulçeronekrotik me hemorragji të shumta petekiale (0.50)

- hiperemia difuze e të gjithë mukozës orale dhe lëkurës (0.00)

- vetëm ulçera të shumta të qiellzës, tonzilave, harqeve palatinale, gingivës dhe gjuhës (0.00)

- gjakderdhja e bollshme spontane për shkak të numrit të reduktuar të tromboplasteve (0.00)

- hiperemia gingivale difuze me zgjerim gingival (0.00)

283. Ndryshimet më të zakonshme orale që hasen në aneminë aplastike janë:

- gingiviti akut ulçeronekrotik me hemorragji të shumta petekiale 0.50)

- hiperemia difuze e të gjithë mukozës orale dhe lëkurës (0.00)

- vetëm ulçera të shumta të qiellzës, tonzillave, harqeve palatinale, gingivës dhe gjuhës (0.00)

- hipersalivimi, dhimbjet gjatë mastikacionit, vështirësitë në gëlltitje (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

284. Çrregullim në metabolizmin e kolagjenit ndodh gjatë mungesës së:

- vitaminës A (0.00)

- vitaminave të B-kompleksit (0.00)

- vitaminës C (0.50)

- vitaminës D (0.00)

- tri-jod-tironinës (0.00)

285. Nekroza është një proces që ndodh me lëshimin dhe aktivizimin e:

- enzimeve lizosomale (0.50)

- enzimeve proteolitike (0.00)

- enzimeve oksidoreduktues (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

286. Pastrimi jo i duhur i dhëmbëve mund të sjell deri te:

- zmadhimi i gingivës (0.00)

- recesioni gingival me zhveshje të sipërfaqes së rrënjës (0.50)

- humbja e pikave të kontaktit (0.00)

- paraqitja e kariesit (0.00)

- rritja e thellësisë së xhepit periodontal (0.00)

287. Përpunimi jo i duhur i xhepave periodontal mund të sjell deri në paraqitjen e:

- periodontitit kronik (0.00)

- periodontitit agresiv të lokalizuar (0.00)

- periodontitit agresiv të gjeneralizuar (0.00)

- periodontitit ulçeronekrotik (0.00)

- abscesit periodontal (0.50)

288. Nevoja për bashkëjetesë quhet:

- asociacion (0.50)

- simbiozë (0.00)

- interreakcion (0.00)

- sinergji (0.00)

- kompeticion (0.00)

289. Deficiti nutritiv shoqërohet me shfaqjen e:

- periodontitit kronik (0.00)

- periodontitit agresiv (0.00)

- periodontitit ulçero-nekrotik (0.50)

- abscesit periodontal (0.00)

- traumës okluzale (0.00)

290. Faqet përbëhen nga:

- tre shtresa (0.00)

- katër shtresa (0.00)

- pesë shtresa (0.50)

- gjashtë shtresa (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

291. Prej ku e kanë origjinën polisakaridet ekstra- dhe intraqelizore në pllakun dental?

- nga lëngu gingival (0.00)

- nga pështyma (0.00)

- nga ushqyerja (0.00)

- nga smalti i demineralizuar (0.00)

- nga bakteret e pllakut (0.50)

292. Prej ku rrjedh linja e parë e mbrojtjes së nikoqirit nga mikroorganizmat gjatë sëmundjes parodontale?

- pjesës supragingivale (0.00)

- pjesës subgingivale (0.50)

- indit lidhor gingival (0.00)

- regjionit tonzillar (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

293. Prej ku rrjedhin mineralet që marrin pjesë në mineralizimin e konkrementeve subgingivale?

- nga lëngu gingival (0.50)

- nga pështyma parotide (0.00)

- nga pështyma sublinguale (0.00)

- nga pështyma e përzier (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

294. Nga cilat shtresa është i përbërë epiteli oral i gingivës?

- str. basale, str. spinosum, str. granulosum, str. corneum (0.50)

- str. granulosum, str. corneum (0.00)

- str. basale, str. spinosum, str. granulosum (0.00)

- str. basale, str. spinosum, str. superficiale (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

295. Nga çfarë është e përbërë substanca ndërqelizore e epitelit gingival?

- acidi hialuronik, sulfati kondroitin dhe heteropet (0.50)

- acidi hialuronik dhe kolagjeni (0.00)

- kolagjeni dhe elastina (0.00)

- acidi hialuronik dhe kondroitina

-të gjitha përgjigjet janë të pasakta

296. Nga çfarë nuk përbëhet kurrë eksudati purulent:

- bakteret e vdekura (0.00)

- bakteret e gjalla (0.00)

- mbetjet e ushqimit (0.50)

- e vërteta është nën a dhe b (0.00)

- e vërteta është nën b dhe c (0.00)

297. Histamina e lëshuar është përgjegjëse për shfaqjen e:

- makulës hemorragjike (0.00)

- eritemës (0.00)

- urtikaries (0.50)

- vezikulës (0.00)

- pustulës (0.00)

298. Shenja themelore patognomonike, klinike e sëmundjes parodontale është:

- recesioni (0.00)

- inflamacioni (0.00)

- xhepi periodontal (0.50)

- eksudati (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

299. Shenja themelore patognomonike, klinike e sëmundjes parodontale është:

- recesioni (0.00)

- inflamacioni (0.00)

- xhepi periodontal (0.50)

- prania e gurrit të dhëmbit (0.00)

- prania e pllakut dentar (0.00)

300. Efloreshenca themelore e lichen planusit oral është:

- vegjetacioni lichenoid; (0.00)

- papula epidermo-dermale; (0.50)

- pllaka (0.00)

- efloreshencat polimorfike; (0.00)

- dermatoza bulloze (0.00)

301. Njësia themelore fungale është:

- virion (0.00)

- kapsid (0.00)

- hifa (0.50)

- spore (0.00)

- vibrion (0.00)

302. Papulat janë karakteristikë e:

- stadit primar të sifilizit (0.50)

- aktinomikozës (0.00)

- NOMA-s (0.00)

- sifilizit kongjenital (0.00)

- SIDA-s (0.00)

303. Abscesi parodontal është komplikim i:

- nënformës hemorragjike të moderuar të sëmundjes parodontale (0.00)

- nënformës së rëndë hemorragjike të sëmundjes parodontale (0.00)

- nënformës pioroike të sëmundjes parodontale (0.50)

- parodontopatisë ku dominon lloji horizontal (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

304. Parodontopatia me progresion të ngadaltë karakterizohet me:

- inflamacion kronik të gingivës (0.50)

- prani të parëndësishme të pllakut dentar (0.00)

- mungesës së inflamacionit të zbulueshëm klinikisht (0.00)

- xhepave jashtëzakonisht të thellë parodontal (0.00)

- humbjes së shpejtë të kockës (0.00)

305. Gjetja patohistologjike tek pemphigus vulgaris është:

- bullë intraepiteliale (0.50)

- bullë subepiteliale (0.00)

- bullë herë subepiteliale dhe herë intraepiteliale (0.00)

- papulë intraepiteliale (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

306. Peptokoket bëjnë pjesë në grupin e llojeve të mëposhtme të baktereve:

- aerobe (0.00)

- anaerobe (0.50)

- spiroketa (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

307. Pllaku në varësi të raportit të tij me margjinalen është

- pllak i ngjitur dhe jo i ngjitur(0.00)

- pllak supragingival dhe i ngjitur (0.00)

- pllak supragingival dhe subgingival (0.50)

- pllak subgingival dhe ngjitës (0.00)

- pllak ngjitës dhe i lirë (0.00)

308. Hapësira e cekët kapilare që ndodhet në mes të smaltit të dhëmbit dhe pjesës së brendshme të gingivës së lirë quhet:

- xhep gingival (0.00)

- buzë gingivale (0.00)

- sulkus gingival (0.50)

- sulkus periodontal (0.00)

- xhep periodontal (0.00)

309. Hapësira e cekët kapilare që ndodhet në mes smaltit të dhëmbit dhe pjesës së brendshme të gingivës së lirë quhet

- xhep gingival(0.00)

- buzë gingivale (0.00)

- sulkus gingival (0.50)

- brazdë gingivale (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

310. Sindroma e Plummer-Vinson-it ose Sindroma e Petterson-Kells-it (disfagia ferrodeficiente) zakonisht përfshin:

- femrat mes dekadës së dytë dhe të katërt të jetës (0.00)

- femrat mes dekadës së tretë dhe të pestë të jetës (0.00)

- femrat mes dekadës së katërt dhe të gjashtë të jetës (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

311. Sipërfaqja e qelizave që mbajnë një përgjigje imune qelizore (T-Ly) përmban:

- proteina (0.00)

- karbohidrate (0.00)

- yndyrë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

312. Nën cilin kënd bëhet incizioni primar në operacionin me llambo(flap) të modifikuar sipas Widman-it?

- nga 25 - 45 shkallë (0.50)

- nga 10 - 15 shkallë (0.00)

- nga 60 - 90 shkallë (0.00)

- nga 90 shkallë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

313. Termi dysplasia do të thotë:

- ndryshimi i strukturave qelizore (0.50)

- çrregullime në zhvillimin e qelizës së pjekur (0.00)

- rritja e numrit të elementeve qelizorë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

314. Termi metaplazi nënkupton:

- ndryshim të strukturave qelizore nga një lloj në tjetrin (0.50)

- Çrregullim në zhvillimin e qelizës së pjekur (0.00)

- vëllim dhe funksion të shtuar të qelizës dhe të indit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

315. Një fenomen pozitiv i vitropresionit ndodh në:

- makulat e pigmentuara (0.00)

- makulat hemorragjike (0.00)

- makulat vaskulare (0.50)

- edemat (0.00)

- Vezikulat dhe bullat (0.00)

316. Termi "kockë alveolare e vërtetë" i referohet:

- kompaktës vestibulare (0.00)

- kompaktës orale (0.00)

- murit të gotës alveolare (0.50)

- kockës spongioze (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

317. Pas terapisë fillestare të parodontopatisë vijon:

- faza e edukimit të pacientit për mirëmbajtjen e higjienës orale (0.00)

- faza kirurgjikale (0.00)

- faza e ruajtjes së rezultateve (0.50)

- faza korrigjuese (0.00)

- faza protetiko-rekonstruktive (0.00)

318. Procedurat gjatë terapisë jo-kirurgjikale parodontale janë:

- udhëzime për kontrollin e pllakut (0.00)

- heqja e gurëve të dhëmbëve dhe pllakut dentar dhe identifikimi i faktorëve që favorizojnë akumulimin e pllakut (0.00)

- kiretazha gingivale dhe parodontale (0.00)

- evaluimi okluzal (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.50)

319. Ndryshimet pas rrezatimit në zgavrën e gojës mund të jenë:

- të hershme (0.00)

- të vonshme (0.00)

- të hershme dhe të vonshme (0.50)

- nuk ka as të hershme, as të vonshme (0.00)

- pa ndryshime (0.00)

320. Ndryshimet pas rrezatimit në zgavrën e gojës mund të jenë:

- të hershme (0.00)

- të vonshme (0.00)

- të hershme dhe të vonshme (0.50)

- nuk ka as të hershme as të vonshme (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

321. Shenjat e para klinike të transformimit të mundshëm malinj të leukoplakisë janë:

- lëmimi i zonës së leukoplakisë (0.00)

- shkatërimi dhe copëzimi i zonës së leukoplakisë (0.50)

- shfaqja e lezioneve të reja në vende të reja (0.00)

- përmirësimi i herëpashershëm dhe shfaqja e herëpas-herëshme e lezioneve të reja (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

322. Shenjat e para klinike të transformimit të mundshëm malinj të leukoplakisë janë:

- lëmimi i zones së leukoplakisë; (0.00)

- shkatërimi dhe copëtimi (plasaritja) i sipërfaqes së leukoplakisë, me përhapje të

ndryshuar në vëllim; (0.50)

- shfaqja e lezioneve të reja në vende të reja; (0.00)

- përmirësimi i herëpashershëm dhe shfaqja e herëpashershme e lezioneve të reja; (0.00)

- nuk ka përgjigje të saktë (0.00)

323. Ndryshimet e para karakteristike të stomatitis herpetica lokalizohen në:

- buzë (0.00)

- gingivë (0.50)

- faqe (0.00)

- qiellzën e butë dhe të fortë (0.00)

- në gjithë zgavrën e gojës(0.00)

324. Ndryshimet fillestare karakteristike të stomatis gangrenosa-NOMA gjenden në:

- qiellzën e butë (0.00)

- gjuhë (0.00)

- nivelin e regjionit retromolar (0.50)

- nivelin e buzëve (0.00)

- pas këndit të buzëve (0.00)

325. Kontakti i parakohshëm i dhëmbëve anësor i cili ndodh si pasojë e ekstrakcionit të dhëmbëve anësorë dhe rrëshqitja e mandibulës drejt anteriores, çon në

- resorbim të kockës alveolare së dhëmbëve në regjionin anësor të maksilës (0.00)

- resorbim të kockës alveolare së dhëmbëve në regjionin anësor të mandibulës (0.50)

- destrukcion të parodontit të dhëmbëve maksillarë frontal dhe pozicionimit të tyre vestibular (0.00)

- fenestrim të dhëmbëve frontal të nofullës së poshtme (0.00)

- nuk ka përgjigje të saktë (0.00)

326. Zonat predilekcionuese për shfaqjen e afteve të Sutton-it janë:

- mukoza bukale, labiale, sipërfaqet anësore të gjuhës (0.00)

- gjuha, qiellza e butë dhe orofaringu (0.50)

- rrënja e gjuhës, harqet palatinale dhe uvula (0.00)

- nuk ekzistojnë vende predilekcionuese, shfaqen gjithkund (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

327. Lokalizimi predilekcionues i leukoplakisë është te:

- regjioni retromolar i mukozës së faqes (0.00)

- komisura oris e mukozës së faqes (0.50)

- pjesët e përparme të qiellzës së fortë (0.00)

- gingiva margjinale (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

328. Zonat predilekcionuese për shfaqjen e afteve të Sutton-it janë:

- mukoza bukale, labiale, sipërfaqet anësore të gjuhës dhe dyshemeja e zgavrës së gojës (0.50)

- gjuha, qiellza e butë dhe orofaringu (0.00)

- rrënja e gjuhës, harqet palatinale dhe uvula (0.00)

- nuk ekzistojnë vende predilekcionuese, shfaqen gjithkund në kavitetin oral (0.00)

- pjesët e mukozës orale që nuk keratinizojnë (0.00)

329. Zonat predilekcionuese për shfaqjen e afteve majore janë:

- mukoza bukale, labiale, sipërfaqet anësore të gjuhës dhe dyshemeja e zgavrës së gojës qiellza e butë dhe e fortë dhe orofaringu(0.50)

- rrënja e gjuhës, harqet palatinale dhe uvula (0.00)

- nuk ekzistojnë vende predilekcionuese, shfaqen gjithkund ku ka mukozë që nuk keratinizon (0.00)

- kavitetet mesio-okluzale (0.00)

- kavitetet okluzale (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

167. Cilat veti nuk i ka fosfat cementi?

- përgatitja e lehtë (0.00)

- ngjyra dhe porozitetiі mirë (0.50)

- ngjyra e mirë (0.00)

- rezistenca ndaj presionit përtypës (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

168. Cilat veti duhet t'i kenë materialet për obturim?

- qëndrueshmëria, përshtatshmëria, manipulimi i lehtë (0.50)

- ngjyra e përhershme (0.00)

- manipulimi i lehtë (0.00)

- nuk kanë asnjë veti (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

169. Cili material restaurues lëshon jone fluori?

- kompomeri, kompoziti, CGI (0.50)

- amalgami (0.00)

- fosfat cementi (0.00)

- fermiti (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

170. Cilat janë vendet atipike të paraqitjes së kariesit?

- sipërfaqet aproksimale (0.00)

- foramen cekum (0.00)

- fisurat dhe gropëzat (0.00)

- tuberët e dhëmbëve (0.50)

- e treta gingivale e dhëmbëve (0.00)

171. Cilat janë vendet kritike në dhëmbë për paraqitjen e kariesit?

- tuberët e dhëmbëve (0.00)

- skajet incizale (0.00)

- apeksi i dhëmbit (0.00)

- fisurat dhe gropëzat e dhëmbëve (0.50)

- sipërfaqet vestibulare (0.00)

172. Cilat janë metodat për diagnostifikimin e hershëm të kariesit?

- ultrazëri (0.00)

- gjakderdhja (0.00)

- shpërlarja me hidrogjen 3% (0.00)

- rtg-eni (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

174. Cilat janë simptomat e përgjithshme të procesit kariotik?

- dhimbja provokuese (0.00)

- ndryshimi i ngjyrës së dhëmbit (0.50)

- gjakderdhja (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

177. Cilat janë mjetet dhe metodat e sofistikuara për diagnozën e kariesit?

- fluoreshenca me laser duke përdorur KAVO diagnode (0.50)

- sondimi (0.00)

- inspektimi (0.00)

- palpimi (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

178. Cilat preparate për mbushje definitive të kavitetit i njeh?

- mbushjet definitive (0.00)

- preparatet me efekt anestetik (0.00)

- amalgamet, kompozitet, kompomeret (0.50)

- dentinokset (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

179. Cilat preparate për mbushje të përkohshme të kavitetit i njeh?

- kompozitet (0.00)

- amalgamet (0.00)

- cementet e Fletcher-it (0,50)

- kompomeret (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

180. Cilat preparate mund të përdoren në trajtimin e kariesit të thellë?

- hidroksidi i kalciumit (0.50)

- rockles-i (0.00)

- tricresolformalina (0.00)

- hipoklorit natriumi (0.00)

- adhezivi (0.00)

181. Cilat kushte duhet t'i plotësojë preparimi për inlej?

- thellësia më e madhe e kavitetit (0.50)

- estetika (0.00)

- asgjë (0.00)

- qëndrueshmëria (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

182. Cili është simptomi më i shpeshtë për të cilin pacientët vijnë te dentisti:

- fetor(era e keqe nga goja) (0.00)

- fistula (0.00)

- dhimbja (0,50)

- diskolorimi i dhëmbit (0.00)

- nyjet limfatike të zmadhuara (0.00)

183. Cili material siguron një pikë ideale të kontaktit?

- Kompoziti (0.00)

- CGI (0.00)

- kompomeri (0.00)

- amalgami (0.50)

- fermiti (0.00)

184. Cilat materiale përdoren për përpunimin e inlejeve?

- ari, kompoziti (0.00)

- kompoziti, qeramika, ari (0.50)

- kompomeri, ari, kompoziti (0.00)

- qeramika, kompomeri (0.00)

- kompomeri, ari (0.00)

185. Cilat veti i ka cementi i glasionomerëve(CGI)?

- biokompatibilitetin (0.50)

- ngjyrën e mirë (0.00)

- qëndrueshmërinë (0.00)

- manipulimin e lehtë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

186. Si klasifikohet procesi kariotik sipas raportit me pulpën?

- sipërfaqësor, i mesëm, i thellë (0.50)

- karies sicca (0.00)

- sekondar (0.00)

- recidivues (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

187. Cila nga më poshtë nuk është karakteristikë pozitive e cementit të zink fosfatit?

- qëndrueshmëria e vëllimit (0.00)

- rezistenca ndaj veprimeve mekanike (0.00)

- veprimi antikariogjen (0.50)

- izoluesi i mirë i nxehtësisë (0.00)

- adhezioni (0.00)

188. Cila nga fazat e amalgamit të ngurtësuar ndikon negativisht në cilësinë e mbushjes definitive të amalgamit?

- gama 1 (0.00)

- gama (0.00)

- alfa (0.00)

- gama 2 (0.50)

- beta 2 (0.00)

189. Cilën veti nuk e ka oksidi i zinkut&oleum kariofilorum(ZnOOK)?

- biokompatibile (0.50)

- analgjezike (0.00)

- antiseptike (0.00)

- rezistencën ndaj lagështisë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

190. Cili dëmtim nuk paraqet dëmtim traumatik të aparatit mbështetës të dhëmbit?

- conthusio dentis (0.00)

- luxatio dentis (0.00)

- infractio dentis (0.50)

- intrusio dentis (0.00)

- expulsio dentis (0.00)

191. Cili është roli i adhezivit?

- të përmirësojë adhezionin e materialit me substancën e dhëmbit (0.50)

- kondicionimin (0.00)

- i vogël (0.00)

- asnjë rol (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

194. Kombinimi i KF dhe NaF përdoret për analgjezionin gjatë:

- hiposensitivitetit, mbindjeshmërisë (0.00)

- heterosensitivitetit, hiposensitivitetit (0.00)

- hipersensitivitetit, mbindjeshmërisë (0.50)

- hipersensitivitetit, heterosensitivitetit (0.00)

- heterosensitivitetit, mbindjeshmërisë (0.00)

195. Rrëshirat kompozite kimikisht lidhen me:

- cementin e zink fosfatit (0.00)

- cementin e glasionomereve (0.00)

- adhezivin e dentinës (0.50)

- kondicionerin (0.00)

- asnjëra nga preparatet më sipër (0.00)

196. Komunikim me pulpën kemi te:

- fractura dentis klasa I (0.00)

- fractura dentis klasa II (0.00)

- fractura dentis klasa III (0.50)

- fractura dentis klasa IV (0.00)

- infractio dentis (0.00)

197. Kurora me pamje opalescente, qelibare dhe në formë të ziles është karakteristike për:

- amelogenesis imperfecta (0.00)

- dentinogenesis imperfecta (0.50)

- dhëmbët e Hutchinson-it (0.00)

- dhëmbët e Turner-it (0.00)

- displazitë e dentinës (0.00)

198. Koferdami paraqet:

- sistem për arritjen e fushës së thatë të punës (0.00)

- gomë për shtypjen e papilës interdentale (0.00)

- preparat për dezinfektimin e kavitetit (0.00)

- preparat për diagnostifikimin e kariesit (0.00)

- sistem për arritjen e fushës së thatë absolute të punës (0.50)

199. Faza përfundimtare e inflamacioneve ireverzibile të pulpës paraqet?

- hiperemi (0.00)

- pulpitis acuta purulenta (0.00)

- necrosis pulpae (0.50)

- pulpitis chronica aperta proliferativa (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

200. Laminatet në front indikohen gjatë:

- propulzionit (0.00)

- fluorozës (0.50)

- intruzionit (0.00)

- ekspulzionit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

201. Lentula përdoret për:

- irrigim të kanalit (0.00)

- obturim të kanalit (0.50)

- preparim të kanalit (0.00)

- trepanim (0.00)

- asnjëra nga këto më sipër (0.00)

202. Lidokaina si anestetik lokal përdoret në përqëndrim

- 2% (0.50)
- 4% (0.00)
- 3% (0.00)
- 1% (0.00)
- 6% (0.00)

203. Degjenerimi mineral nënkupton depozitimin e:

- kalciumit (0.50)

- hekurit (0.00)

- aluminit (0.00)

- proteinave (0.00)

- magnezit (0.00)

204. Metoda mortale nënkupton:

- Nekrozë (0.00)

- Biopulpektomi (0.00)

- Gangrenë (0.00)

- Nekropulpektomi (0.50)

- Asnjëra nga këto më sipër (0.00)

205. Cilave parime duhet t'u kushtojmë vëmendje gjatë preparimit të dhëmbit?

- përshtatshmërisë teknike (0.00)

- formës së dhëmbit (0.00)

- parimeve biologjike (0.50)

- dëshirës së pacientit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

206. Në sa mënyra merret masa për inlej?

- tre (0.50)

- një (0.00)

- pesë (0.00)

- dy (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

207. Dhëmbi është i ndjeshëm në perkusion tek?

- pulpitis chronica ulcerosa (0.00)

- necrosis pulpae (0.00)

- pulpitis chronica aperta proliferativa (0.00)

- hiperemia (0.00)

- pulpitis acuta purulenta (0.50)

208. Sasi më të madhe të materies inorganike në dhëmb ka në:

- dentinë (0.00)

- smalt (0.50)

- cement (0.00)

- pulpë (0.00)

- kufirin smalt-dentinë (0.00)

209. Izolimi ose fushë e thatë e punës arrihet më së miri me përdorimin e?

- vaterolnave (0.00)

- pusterit (0.00)

- tupferit të pambukut (0.00)

- optradamit(koferdamit) (0.50)

- aspiratorit (0.00)

210. Shkaku më i shpeshtë për paraqitjen e abfrakcioneve është:

- refluksi gastrik (0.00)

- bulimia (0.00)

- bruksizmi (0.00)

- okluzioni traumatik (0.50)

- ekspozimi profesional (0.00)

211. Prag të zvogëluar të ngacmimit kemi tek:

- Inflamacioni seroz i pulpës (0.50)

- Pulpiti ulceroz (0.00)

- Polipi i pulpës (0.00)

- Inflamacioni purulent i pulpës (0.00)

- Asnjëra nga këto më sipër (0.00)

212. Ku janë të lokalizuar defektet jo karioze?

- në të tretën gingivale të kurorës (0.50)

- në të tretën e mesme të kurorës (0.00)

- në të tretën e mesme të rrënjës (0.00)

- në të tretën okluzale të kurorës (0.00)

- në të tretën gingivale të rrënjës (0.00)

215. Nga cili material mund të përpunohet inleji?

- amalgami (0.00)

- kompomeri (0.00)

- glasionomeri (0.00)

- porcelani dhe metali (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

218. Nga çfarë duhet të mbrohet pulpa gjatë mbushjes me amalgam?

- nga përçueshmëria termike e amalgamit (0.50)

- nga efekti i dëmshëm i zhivës në pulpën e dhëmbit (0.00)

- të zvogëlohet mikro rrjedhja te mbushja e amalgamit (0.00)

- që të parandalohet shfaqja e kariesit sekondar (0.00)

- nga efekti i dëmshëm i tallashit metalik (0.00)

219. Odontodisplasia është një anomali e shkaktuar nga:

- faktorët lokalë (0.00)

- faktorët e përgjithshëm (0.00)

- intoksikimet (0.00)

- faktorët trashëgues (0.00)

- faktorët idiopatikë (0.50)

220. Komponenta organike e kompoziteve është:

- mikro grimca (0.00)

- kolagjeni (0.00)

- bariumi i silikatit(0.00)

- acidi organik (0.00)

- Bis - GMA (0.50)

221. Repozicionimi ortodontik bëhet te:

- expulsio dentis (0.50)

- infractio dentis (0.00)

- amelogenesis imperfecta (0.00)

- contusio dentis (0.00)

- dentinogenesis imperfecta (0.00)

222. Kontrollën primare e përbëjnë instrumentet e mëposhtme:

- pasqyra dhe sonda dentare (0.00)

- pasqyra dentare, sonda dhe pinceta (0.50)

- pasqyra dentare, sonda, pinceta dhe instrumenti plastik (0.00)

- pasqyra dentare, sonda dhe kompresori (0.00)

- pasqyra dentare, sonda dhe ekskavatori (0.00)

223. Kunjat parapulparë indikohen në:

- smalt (0.00)

- cement (0.00)

- dentinë (0.50)

- pulpë (0.00)

- asnjëra nga këto më sipër (0.00)

224. Pulpiti parenhimatoz është:

- polipi i gingivës (0.00)

- polipi i pulpës (0.50)

- polipi i periodonciumit (0.00)

- polipi i indeve të buta (0.00)

- asnjëra nga këto më sipër (0.00)

225. Ndriçimi periapikal është i pranishëm te:

- granuloma interne (0.00)

- periodontiti kronik apikal (0.50)

- abscesi apikal simptomatik (0.00)

- polipi i pulpës (0.00)

- hiperemia e pulpës (0.00)

226. Dentina peritubulare ndodhet:

- në mes të odontoblasteve (0.00)

- në mes të kanaleve (0.00)

- mbi pulpë (0.00)

- rreth lumenit të kanaleve (0.50)

- mbi dentinë (0.00)

227. Nën restaurimin me kompozite nuk rekomandohet të vendoset:

- CGI (0.00)

- zink oksid eugenoli (0.50)

- zink oksid fosfat cementi (0.00)

- hidroksidi i kalciumit (0.00)

- asnjëra nga këto më sipër (0.00)

228. Vendosjen e shtresës në kavitet e bëjmë me:

- shtypës (0.00)

- instrument plastik (0.00)

- sondë (0,50)

- pincetë (0.00)

- ekskavator (0.00)

230. Pastat polivalente përdoren si:

- mbushje definitive (0.00)

- irrigues (0.00)

- medikamente (0.50)

- lubrifikantë (0.00)

- helate (0.00)

231. Polipi i pulpës paraqet:

- sëmundje ireverzibile (0.50)

- sëmundje reverzibile (0.00)

- inflamacion akut (0.00)

- simptomatike (0.00)

- asnjëra nga këto më sipër (0.00)

232. Për shkak të çregullimit të metabolizmit të proteinave ndodh:

- degjenerimi vakuolar (0.00)

- degjenerimi yndyror (0.00)

- degjenerimi hialin (0.50)

- degjenerimi mineral (0.00)

- degjenerimi i lidhur me moshën (0.00)

233. Dhimbja post-terapeutike nuk paraqitet te:

- indi pulpar i mbetur (0.00)

- kaviteti i tejzgjatur (0.50)

- pulpa e ngjeshur në drejtim apikal (0.00)

- kalimi i debrisit nëpërmjet apeksit (0.00)

- ndalesa apikale e dëmtuar (0.00)

234. Pragu i ngacmueshmërisë elektrike të pulpës është:

-forca e rrymës prej 3 mA që shkakton reaksionin e pulpës (0.00)

- rryma më e dobët që shkakton reaksion të pulpës (0.50)

- reagimi i pulpës në të ftohtë prej $7^{o}C$ (0.00)

- pragu përcaktohet sipas një tabele të dhënë të vitalitetit (0.00)

- rryma më e fortë që shkakton reaksionin e pulpës (0.00)

235. Ekstenzion preventiv i kavitetit të klasës së parë paraqet:

- zgjerimin e kavitetit deri te tuberët (0.00)

- zgjerimin e kavitetit deri te vendet me vetëpastrim fiziologjik (0.50)

- zgjerimin e kavitetit deri te mesi i tuberëve (0.00)

- zgjerimin e 1/3 së distancës mes tuberëve (0.00)

- zgjerimin deri te anët aproksimale (0.00)

236. Vendet predilekcionuese për formimin e dentinës sekondare janë:

- pjesa apikale e rrënjës (0.00)

- pjesa e cervikale e dhëmbit (0.00)

- muret e dhomës pulpare(0.00)

- brirët e pulpës (0.50)

- kufiri smalt-dentinë (0.00)

237. Përparësitë e teknikës self-etching janë:

- depërtimi më i madh i primerit (0.00)

- kondicionimi i mjaftueshëm i smaltit (0.00)

- përdorimi vetëm me kompozite polimerizuese (0.00)

- nuk ka ndjeshmëri post-terapeutike (0.50)

- ekziston periudhë mes brejtjes dhe bondimit (0.00)

238. Përparësitë e punës me koferdam janë:

- lustrimi më i mirë i mbushjeve (0.00)

- nevojitet asistimi nga motra medicinale (0.00)

- preparimi më i lehtë i kavitetit (0.00)

- përzierja më e lehtë shtresave (0.00)

- mbrojtja e pacientit nga inhalimi, gëlltitja e medikamentit dhe instrumentit (0.50)

240.Preparimi për inlay (porcelani, kompozit) duhet të ketë:

- Mure divergjente (0.50)

- skajet e smaltit të pjerrësuara (0.00)

- vende të nënminuara (0.00)

- mure konvergjente (0.00)

- mure paralele (0.00)

241. Në rastin e expulsio dentis, dhëmbin është më mire ta ruajsh në:

- qese plastike (0.00)

- tretje fiziologjike (0.00)

- shami të thatë (0.00)

- qumësht (0.00)

- kulturë të indeve (0.50)

242. Gjatë trajtimit endodontik, problem mund të paraqes:

- degjenerimi vakuolar (0.00)

- degjenerimi yndyror (0.00)

- degjenerimi hialin (0.00)

- degjenerimi mineral (0.50)

- degjenerimi amiloid (0.00)

243. Në kariesin te foramen cekum, kaviteti ka:

- formë ovale (0.00)

- formë drejtkëndëshe (0.00)

- formë trekëndëshi (0.00)

- formë trekëndëshi me bazën drejt buzës incizale (0.00)

- formë trekëndëshi me bazën drejt qafës (0.50)

244.Në cilën gjendje kundërindikohet të përshkruhen antibiotikë:

- te ënjtjet difuze (0.00)

- te profilaksia e sëmundjeve sistemike (0.00)

- te limfadenopatitë (0.00)

- te temperatura (0.00)

- te dhimbjet (0,50)

245. Gjatë vendosjes së kompozitit, trashësia e çdo shtrese nuk duhet të jetë më e madhe se:

- 1 mm (0.00)

- 2 mm (0.50)
- 3 mm (0.00)
- 4 mm (0.00)
- 5 mm (0.00)

246. Gjatë preparimit për onlej, muret janë nën kënd prej?

- 85 º (0.00)
- 95º (0.00)
- 90º (0.00)
- 75 º (0.00)
- 105º (0,50)

247. Gjatë punës me Cariosolv përdorim:

- dalta të dizenjuara posaçërisht (0.50)
- turbinë me freza diamanti (0.00)
- kundërkënd me freza çeliku (0.00)
- turbine me freza smart (0.00)
- kundërkënd me freza tungsten karbidi (0.00)

248. Gjatë terapisë së Caries profunda complicata përdoret?

- Kompoziti (0.00)
- CGI (0.00)
- kompomeri (0.00)
- ZnOOC-i (zink oksid oleum cariofilorum) (0.00)
- hidroksidi i kalciumit (0.50)

249. Gjatë terapisë së dhëmbëve hipersensitiv përdoret?

- fluori, laseri, CGI, adhezivi, kompomeri, formaldehidi, kompoziti (0.50)

- laseri, CGI, kompoziti (0.00)

- adhezivi, kompomeri, formaldehidi (0.00)

- laseri, fluori, CGI, adhezivi (0.00)

- fluori, laseri, CGI, kompomeri, formaldehidi, adhezivi (0.00)

250. Ndryshimi në ngjyrën e dhëmbit paraqitet tek :

- kaviteti shumë i vogël hyrës (0.50)

- kaviteti shumë i ekstenduar (0.00)

- perforimet e dhomës pulpare (0.00)

- thyerjet e instrumenteve (0.00)

- kanalet e stërmbushura (0.00)

251. Skajet e një matrice të vendosur në mënyrë korrekte duhet të përfundojnë:

- mbi shkallën gingivale (0.00)

- në nivelin e shkallës gingivale (0.00)

- 0,5 mm nën shkallën gingivale (0,00)

- 1 mm poshtë shkallës gingivale (0.50)

- asnjëra nga këto më sipër (0.00)

252. Smear shtresa eliminohet me:

- irrigues (0.00)

- EDTA (0.50)

- lubrifikantë (0.00)

- siler (0.00)

- tretje fiziologjike (0.00)

253. Sëmundje reverzibile është:

- Hiperemia (0.50)

- Pulpittis acuta serosa (0.00)

- Pulpitis chronica granulomatosa (0.00)

- Pulpitis chronica ulcerosa (0.00)

- Necrosis pulpae (0.00)

254. Me radiografi diagnostifikohen:

- Pulpitet akute (0.00)

- Parodontitet akute (0.00)

- Parodontitet ekzacerbuese (0.50)

- Hiperemia (0.00)

- Gangrena (0.00)

255. Retencioni i restaurimit varet nga:

- thellësia e kavitetit (0.00)

- gjerësia e kavitetit (0.00)

- adheziviteti i materialit restaurues (0.50)

- divergjenca e mureve (0.00)

- forma e kavitetit(0.00)

256. Dhimbja e fortë irraduese është e pranishme tek:

- fistula (0.00)

- periodontiti fibroz (0.00)

- granuloma interne (0.00)

- periodontit akut (0.50)

- hiperemia (0.00)

257. Dhimbja e fortë irraduese spontane që rritet me të ftohtin është një simptomë e:

- polipit të pulpës (0.00)

- pulpitit purulent (0.00)

- pulpitit seroz (0.50)

- nekrozës së pulpës (0.00)

- gangrenës (0.00)

258.Me instrumentin Hedstroem rekomandohet:

- teknika me rrotullim dhe tërheqje (0.00)

- teknika e forcës së ekuilibruar (0.00)

- teknika e rrotullimit (0.00)

- teknika e sharrimit (0.50)

- të gjitha teknikat e lartëpërmendura (0.00)

259. Vaterolnat dhe aspiratori sigurojnë:

- fushën e thatë të punës (0.50)

- dezinfektimin e kavitetit (0.00)

- kushte aseptike (0.00)

- fushën e thatë absolute të punës (0.00)

- mbulimin direkt të kavitetit (0.00)

260. Me diagnodent detektohet:

- kariesi okluzal (0.00)

- kariesi aproksimal (0.00)

- kariesi recidivues (0.00)

- kariesi rezidual (0.00)

- të gjitha llojet e kariesit (0.50)

261.Me çfarë lloj të frezës formohen muret e kavitetit të klasës së parë?

- me frezë fisurale (0.50)

- me frezë konike (0.00)

- me frezë të rrumbullakët (0.00)

- me frezë në formë të flakës (0.00)

- me frezë në formë ylli (0.00)

262. Me çfarë lloji të frezës largohet kariesi ?

- frezë diamanti (0.00)

- frezë karbidi (0.00)

- frezë çeliku në formë konike të kundërt (0.00)

- frezë çeliku në formë sferike (0.50)

- frezë çeliku në formë fisurale (0.00)

263. Me cilin acid bëhet kondicionimi te CGI?

- me acid fosforik (0.00)

- me acid nitrik (0.00)

- me acid fluorik (0.00)

- me acid hidrogjeni (0.00)

- me acid poliakrilik (0.50)

264. Me instrument plastik në gojën e pacientit kryhet:

- palpimi (0.00)

- modelim (0.50)

- aplikim (0.00)

- finirim (0.00)

- inspektimi (0.00)

265. Me sondë në gojën e pacientit kryhet:

- inspektimi (0.00)

- palpimi (0.50)

- kiretazhi (0.00)

- largimi i kariesit (0.00)

- modelimi (0.00)

266. Cila është mënyra më e sigurt për të diagnostfikuar kariesin aproksimal?

- transluminimi (0.00)

- separimi (0.00)

- sondat aproksimale (0.00)

- Rtg-eni (0,50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

267. Sipas parimeve të Black-ut, cilat kritere përdoren për diagnostikën e kariesit?

- lokalizimi (0.50)

- kohëzgjatja e dhimbjes (0.00)

- reagimi ndaj stimujve termik (0.00)

- fluoreshenca (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

268. Sipas eksudatit, inflamacioni akut i pulpës mund të jetë:

- seroz dhe purulent (0.50)

- hapur dhe mbyllur (0.00)

- i thatë dhe i lagur (0.00)

- parcial dhe total (0.00)

- asnjëra nga këto më sipër (0.00)

271. Sipas mënyrës së përhapjes, procesi kariotik klasifikohet në:

- i nënminuar dhe penetrues (0.50)

- akut dhe kronik (0.00)

- sipërfaqsor, i mesëm dhe i thellë (0.00)

- primar, rekurent dhe recidivues (0.00)

- primar, rekurent dhe rezidual (0.00)

272. Sipas rrjedhës, si mund të jetë procesi kariotik?

- karies akut dhe kronik (0.50)

- karies cirkular (0.00)

- karies recidivues (0.00)

- karies i nënminuar (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

273. Anestezioni blok është:

- anestezioni intrapulpar (0.00)

- anestezioni mandibular (0.50)

- anestezioni intraligamentar (0.00)

- infiltrativ (0.00)

- terminal (0.00)

274. Faza submukoze është shenjë diagnostike gjatë:

- abscesit akut apikal (0.50)

- xhepit periodontal (0.00)

- pulpitit akut purulent (0.00)

- hiperemisë (0.00)

- gangrenës (0.00)

275. Faza subperiosteale paraqitet gjatë:

- abscesit akut apikal (0.50)

- xhepit periodontal (0.00)

- pulpitit akut purulent (0.00)

- periodontitit fibroz (0.00)

- hiperemisë (0.00)

276. Terapia e Infractio dentis përfshin:

- mbrojtjen antitetanike dhe dhënie të antibiotikëve (0.00)

- repozicionimin dhe imobilizimin, antibiotikë (0.00)

- shmangien e ushqimeve të ngurta dhe kafshimit për 7-10 ditë (0.00)

- rimineralizimin, kontrollin e vitalitetit të pulpës (0.50)

- tërheqjen ortodontike të dhëmbëve (0.00)

277. Terapia e luxatio dentis përfaqëson:

- mbrojtjen antitetanike dhe dhënie të antibiotikëve (0.00)

- repozicionimin dhe imobilizimin, antibiotikët (0.50)

- shmangien e ushqimeve të ngurta dhe kafshimin për 7-10 ditë (0.00)

- rimineralizimin, kontrollin e vitalitetit të pulpës (0.00)

- tërheqjen ortodontike të dhëmbëve (0.00)

278. Termafill paraqet:

- teknikën e përhapjes (0.00)

- teknikën e gutaperkës së ftohtë(0.00)

- teknikën e gutaperkës së nxehtë (0,50)

- teknikën e preparimit të kanalit (0.00)

- teknikën e irrigimit të kanalit (0.00)

279. Dhëmbët tetraciklin paraqesin:

- sëmundje intrauterine (0.00)

- pas daljes së dhëmbëve (0.00)

- çrregullim në zhvillim (0.00)

- çrregullim gjatë formimit të dhëmbit, gjatë mineralizimit të dhëmbit (0.50)

- asnjëra nga këto më sipër (0.00)

280. Azoti i lëngët përdoret për:

- sterilizim (0.00)

- diagnozë (0.50)

- impregnim (0.00)

- kondicionim (0.00)

- toaletë (0.00)

281. Azoti i lëngët përdoret në:

- Testet termike (0.50)

- irrigim (0.00)

- ekstirpim (0.00)

- mbulim direkt të pulpës (0.00)

- Mbulim indirekt të pulpës (0.00)

283. Topografikisht nën tuberët ndodhen:

- kanalet anësore (0.00)

- delta apikale (0.00)

- brirët e pulpës (0.50)

- orificiumi (0.00)

- asnjëra nga këto më sipër (0.00)

284. Okluzioni traumatik paraqet shkakun etiologjik të:

- hipoplazioneve (0.00)

- erozioneve (0.50)

- abrazioneve (0.00)

- abfraksioneve (0.00)

- atricioneve (0.00)

285. Abscesi feniks paraqet:

- Pulpit akut (0.00)

- Pulpit simptomatik (0.00)

- Inflamacion ireverzibil (0.00)

- Absces simptomatik ekzacerbues (0.50)

- Granulomë interne (0.00)

286. Finirimi dhe lustrimi i restaurimeve me amalgam bëhet:

- menjëherë pas vendosjes së amalgamit (0.00)

- pas 2 orësh (0.00)

- pas 4 deri në 6 orë (0.00)

- pas 12 orësh (0.00)

- pas 24 orësh (0.50)

288. Anomalitë funksionale ndodhin:

- në jetën intrauterin (0.00)

- pas daljes së dhëmbëve (0.50)

- në çrregullimet e zhvillimit (0.00)

- gjatë formimit të dhëmbit (0.00)

- gjatë mineralizimit të dhëmbit (0.00)

289. Formë hipomineralizuese kemi te:

- amelogenesis imperfecta (0.50)

- dentinogenesis imperfecta (0.00)

- erozioni (0.00)

- displazioni i dentinës (0.00)

- atricioni (0.00)

291. Glukonat klorheksidina përdoret në përqendrim:

- 3% (0.00)
- 5% (0.00)
- 2% (0.50)
- 1% (0.00)
- 0,5% (0,00)

292. Cementet glasionomere hibride kombinohen me:

- kompozit (0.50)

- amalgam (0.00)

- acid (0.00)

- hidroksid të kalciumit (0.00)

- nano grimca (0.00)

293. Inflamacionet kronike mund të jenë:

- seroze dhe purulente (0.00)

- të hapura dhe të mbyllura (0.50)

- të thata dhe të lagura (0.00)

- reverzibile dhe ireverzibile (0.00)

- asnjëra nga këto më sipër (0.00)

294. Largimi i plotë i pulpës quhet:

- amputim (0.00)

- pulpotomi (0.00)

- pulpektomi (0.50)

- irrigim (0.00)

- trepanim (0.00)

295. Shiritet celuloide përdoren në preparimet e:

- klasës së dyte dhe MO (0.00)

- klasës së parë dhe të pestë (0.00)

- klasës së dytë dhe MOD (0.00)

- klasës së tretë dhe të katërt (0.50)

- klasës së dytë dhe të tretë (0.00)

296. Lokalizimi i kariesit të klasës së katërt sipas Black-ut vërrehet në:

- të tretën gingivale të sipërfaqes orale dhe vestibulare (0.00)

- në sipërfaqen aproksimale të dhëmbëve frontal (0.00)

- në sipërfaqen aproksimale të paramolarëve dhe molarëve (0.00)

- në sipërfaqja aproksimale të dhëmbëve frontal me përfshirjen e këndit incizal (0.50)

- në sipërfaqen okluzale të paramolarëve dhe molarëve (0.00)

297. Çfarë kërkojnë mbushjet e amalgamit pas aplikimit definitiv?

- impregnim (0.00)

- lustrim (0.00)

- shpërlarje (0.00)

- lustrim dhe finirim (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

298. Çfarë është eskavatori?

- instrument për largimin e mbushjeve të përkohshme (0.00)

- instrument për largimin e dentinës së zbutur (0.50)

- instrument për ekartim (0.00)

- instrument për ekstirpim të pulpës(0.00)

- instrument për lustrim (polirim)(0.00)

299. Cila është karakteristikë e ekzaminimit termodiagnostik të kariesit?

- ftohtë dhe nxehtë (0.50)

- dhimbje në perkusion (0.00)

- ëmbël (0.00)

- tharët (0,00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

300. Çfarë nuk paraqet test klinik?

- palpimi (0.00)

- inspektimi (0.00)

- Rtg-eni (0,50)

- termo testi (0.00)

- perkusioni (0.00)

301. Çfarë është spatium interdentale?

- hapësira nën gjuhë (0.00)

- hapësira gjuhësore (0.00)

- hapësira e dhëmbëve (0.00)

- hapësira në mes të dhëmbëve (0.50)

- hapësira në palatum (0.00)

302. Çfarë shihet me inspektim si simptomë e kariesit?

- ndryshimi i ngjyrës në smalt (0.50)

- humbja e kontinuitetit të substancës së dhëmbit (0.00)

- dhimbje të forta (0.00)

- gjakderdhje e pulpës (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

303. Çfarë shpërlahet me ujë?

- primeri (0.00)

- kondicioneri (0.50)

- adhezivi (0.00)

- lineri (0.00)

- bondi (0.00)

304. Çfarë arrihet me kondicionim?

- largimi i një pjese të smaltit (0.00)

- largimi i një pjese të dentinës (0.00)

- modifikimi i smear shtresës (0.50)

- forcimi i shtresës hibride (0.00)

- bondim i kompozitit (0.00)

305. Çfarë mund të vërtetohet në smalt dhe dentinë me anë të rtg inçizimit?

- gjakderdhja (0.00)

- ndërprerja e kontinuitetit të kurorës (0.50)

- intensiteti i dhimbjes (0.00)

- ndjeshmëria termike (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

306. Çfarë duhet të arrihet me vendosjen e matricave?

- të bëhet rekonstruimi i formës anatomike të humbur të dhëmbit (ti jepet formë mbushjes) (0.00)

- të mbrohet papilla interdentale gjatë vendosjes së restaurimit definitiv (0.00)

- të formohet pika e kontaktit (0.50)

- të formohet hapësira interdentale (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

Болести на забите и ендодонтот – Устен

4.1.2-Sëmundjet e dhëmbëve dhe të endodonciumit-Me gojë

1. ZnOOC përdoret për:

- mbylljen e përhershme të kaviteteve (0.00)

- shtresë nën mbushje (0.00)

- efekt analgjezik te pulpitet (0.00)

- fashë medikamentoze në terapinë e gangrenave (0.00)

- fashë për plagën dentinare (9.00)

2. Abfrakcioni ndodh në:

- të tretën gingivale të dhëmbëve (9.00)

- në sipërfaqen okluzale të dhëmbëve (0.00)

- në sipërfaqet aproksimale (0.00)

- në sipërfaqet palatinale (0.00)

- në skajin incizal (0.00)

3. Parodontiti apikal simptomatik (akut) karakterizohet nga simptomat e mëposhtme:

- dhimbje spontane (0.00)

- dhimbje gjatë palpimit në regjionin e apeksit (0.00)

- dhimbje pulsative (0.00)

- ndjenjë e dhëmbit të zgjatur (0.00)

- të gjitha simptomet e lartëpërmendura (9.00)

4. Parodontiti asimptomatik (kronik) diagnostfiikohet më shpesh sipas:

- inçizimit radiografik (9.00)

- perkusionit (0.00)

- ekzaminimit klinik (0.00)

- simptomatologjisë (0.00)

- anamnezës (0.00)

5. Biopulpektomia kundërindikohet te:

- kanale të drejta dhe të kalueshme (0.00)

- rritja jo e plotë e rrënjës (0.00)

- pacienti është alergjik në anestetik (0.00)

- kur pacientët janë me hemostazë të çregulluar (0.00)

- dhëmbët me pulpë nekrotike (9.00)

6. Në cilët nga rastet e mëposhtme indikohet terapia konservative endodontike?

- te fraktura vertikale e dhëmbit (0.00)

- te granuloma interne me komunikim periodontal (0.00)

- te dhëmbi me resorbim masiv ekstern (0.00)

- te procesi periapikal (9.00)

- te dhëmbi i luksuar (shkalla e tretë) (0.00)

7. Gutaperka në endodoncion përdoret për:

- mbushje të përhershme (9.00)

- mbushje të përkohshme (0.00)

- inlej (0.00)

- shtresë (0.00)

- mbulimin e pulpës (0.00)

8. A mund të bëhet brejtja (gërryerja) e dentinës pa rrezikuar irritim të pulpës?

- po, njëlloj si te smalti (0.00)

- po, por më shkurtë se si te smalti (9.00)

- jo, acidi depërton lehtësisht në pulpë dhe e irriton atë (0.00)

- po, acidi nuk depërton në pulpë (0.00)

- po, por më gjatë se si te smalti (0.00)

9. Hipersensitiviteti i dentinës paraqitet tek:

- recesioni gingival (0.00)

- erozioni (0.00)

- kariesi (0.00)

- pas zbardhjes së dhëmbëve (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (9.00)

10. Smaltin e formojnë qelizat:

- Ameloblaste (9.00)

- Odontoblaste (0.00)

- Osteoblaste (0.00)

- Fibroblaste (0.00)

- Cementoblaste (0.00)

11. Erozionet nuk ndodhin nga veprimi i:

- bruksizmit (0.00)

- veprimit mekanik të furçës së dhëmbëve (0.00)

- veprimit të acideve (0.00)

- abfrakcioni i prizmave të smaltit (0.00)

- bakterieve kariogjene (9.00)

12. Rritja e hapësirës pulpare në rtg haset tek:

- pulpiti total (0.00)

- pulpiti akut seroz (0.00)

- pulpiti kronik parenkimatoz (0.00)

- pulpiti kronik ulçeroz (0.00)

- granuloma interne (9.00)

13. Terapia medikamentoze interseansore (mbushja e butë) indikohet te diagnozat e mëposhtme:

- parodontiti (9.00)

- hiperemia e pulpës (0.00)

- pas ekstirpimit mortal (0.00)

- pulpitis chronica aperta (0.00)

- pulpitis acuta serosa partialis (0.00)

14. Ku bëhet hapja trepanuese tek incizivët?

- skajin incizal (0.00)

- sipërfaqen vestibulare (0.00)

- sipërfaqen aproksimale (0.00)

- foramen caecum (9.00)

- foramen apikale (0.00)

15. Intervenimi primar për lehtësimin e dhimbjes tek abscesi alveolar është:

.- trepanimi dhe drenimi transkanal (9.00)

- aplikimi lokal i medikamentit (0.00)

- ordinimi i antibiotikëve per os (0.00)

- vendosja ekstraorale e kompresave të ftohta (0.00)

- aplikimi i anestezionit (0.00)

17. Caries profunda është:

- derisa zgjat ngacmimi dhe shkurt pas saj (9.00)

- intermitente (0.00)

- e vazhdueshme (0.00)

- e ndjeshme në perkusion (0.00)

- gjatë sondimit (0.00)

18. Çfarë inçizimi radiografik duhet të përdoret në endodoncion?

- radiografi retroaproksimale (0.00)

- radiografi okluzale (0.00)

- radiografi retroalveolare (9.00)

- radiografi panoramix (0.00)

- radiografi Bitewing (0.00)

19. Çfarë lloje të inlejit ekzistojnë?

- inleje të amalgamit (0.00)

- inleje të bakrit (0.00)

- inleje të fosfatit (0.00)

- inleje të glas ionomer (0.00)

- inleje të porcelanit (9.00)

20. Si quhen retencionet shtesë te preparimet e klasës së katërt?

- Inlay (0.00)

- Pinley (0.00)

- Rindërtim (0.00)

- kunja interdentale (0.00)

- kunja parapulparë (9.00)

21. Kur ekziston dhimbje spontane, difuze, perkutore, me ënjtje intraorale në zonën e apeksit dhe ndriçim radiografik periapikal, diagnoza është:

- Periodontit kronik i egzacerbuar (9.00)

- Pulpit seroz akut total (0.00)

- Periodontit akut (0.00)

- Pulpit total akut purulent (0.00)

- Periodontit kronik granulomatoz cirkumskript (0.00)

22. Cila nga pohimet e mëposhtme është e vërtetë për teknikën ‘’sanduiç’’?

- smalt + dentinë + cement i glas ionomerit = teknika sanduiç (0.00)

- dentinë + cement i glas ionomerit + kompozit= teknika sanduiç (9.00)

- dentinë + cement i glas ionomerit + amalgam = teknika sanduiç (0.00)

- dentinë + zink fosfat cementi + kompozit = teknika sanduiç (0.00)

- smalt + adheziv+ kompozit = teknika sanduiç (0.00)

23. Cili preparat përdoret më së shpeshti për brejtjen e substancave të forta të dhëmbit?+

- tretësira e acidit fosforik 85% (0.00)
- tretësira e acidit fosforik 5% (0.00)
- tretësira e acidit fosforik 37% (9.00)

- peroksidi i hidrogjenit 25% (0.00)
- hipokloriti 5% (0.00)

24. Cilat struktura normale anatomike në radiografi mund të interpretohen si patologjike? (rretho përgjigjen JO të saktë)

- sela turcica (9.00)
- foramen incisivum (0.00)
- foramen mentale (0.00)
- recesus mandibulae (0.00)
- foramen nasale (0.00)

25. Cili nga materialet e mëposhtme përdoret si shtresë mbrojtëse?

- pasta e jodoformit (0.00)
- shtresa në bazë të glas-ionomerit (9.00)
- oksidi i zinkut (0.00)
- pasta sipas Gizi-t (0.00)
- acidi fosforik (0.00)

26. Cila nga diagnozat e mëposhtme është e dukshme në rtg?

- pulpitis chronica ulcerosa (0.00)
- pulpitis acuta serosa (0.00)
- pulpitis purulenta partialis (0.00)
- parodontitis acuta serosa (0.00)

- cysta radicularis (9.00)

27. Cili nga materialet e mëposhtëm bën pjesë në preparate për obturim të përkohshëm koronar?+

- gutaperka (9.00)

- inlay (0.00)

- onlay (0.00)

- kompoziti (0.00)

28. Kompomerët janë:

- cemente të glas ionomerëve të dobësuar (0.00)

- cemente të glas ionomerëve hibride (9.00)

- cemente të glas ionomerëve të holluara (0.00)

- Glas ionomer cemente të përforcuara me metal (0.00)

- Glas ionomer cemente të brejtur(gërryer) me acid (0.00)

29. Terapia konservative e dhëmbëve avital është e kundërindikuar në:

- dhëmbë me një rrënjë me kanale të kalueshme (0.00)

- dhëmbë me shumë rrënjë me kanale të kalueshme (0.00)

- dhëmbë me ndryshime periapikale në rtg (0.00)

- dhëmbë pa ndryshime periapikale (0.00)

- rezorbim të jashtëm tëi theksuar të rrënjës (9.00)

30. Trajtimi i dentinës hipersensitive është me (rretho përgjigjen JO të saktë):

- fluorid natriumi (0.00)

- hipoklorit natriumi (9.00)

- oksalat kaliumi (0.00)

- ekspozim me lazer (0.00)

- pastë dhëmbësh me fluor (0.00)

31. Në cilën sipërfaqe duhet të vendoset shtresa e kavitetit të klasës së parë?

- sipërfaqet apikale (0.00)

- shkallën gingivale (0.00)

- sipërfaqen aksiale (0.00)

- sipërfaqen aksiale distale dhe mesiale (0.00)

- në pjesën e poshtme të (fundin e) kavitetit (9.00)

32. Vetitë negative të cementeve të glas ionomerëve janë:

- adhezive (0.00)

- arrijnë lidhje kimike (0.00)

- nuk kanë rezistencë mekanike (9.00)

- lëshojnë fluoride (0.00)

- biokompatibile (0.00)

33. Nga çka përbëhet shtresa hibride e dentinës së forcuar pas aplikimit të adhezivit?

- kolagjen dhe hidroksiapat nga dentina me rrëshirë të infiltruar (9.00)

- kolagjen dhe hidroksiapatit nga dentina (0.00)

- dentinë, CGI dhe kompozit (0.00)

- të tre zonat e brejtjes(gërryerjes) (0.00)

- hidroksiapatit nga smalti me rrëshirë (0.00)

34. Dhimbja e mprehtë intermitente është karakteristikë e:

- Caries media (0.00)

- Pulpitit kronik (0.00)

- Caries profunda (0.00)

- Pulpitit seroz (9.00)

- Pulpitit parcial purulent (0.00)

35. Dhimbja e rritur në nxehtësi është karakteristikë te:

- pulpiti akut seroz (0.00)

- pulpiti akut purulent (9.00)

- pulpiti kronik ulçeroz (0.00)

- pulpiti reverzibil (0.00)

- hiperemia e pulpës (0.00)

36. Pragu i ngacmueshmërisë elektrike të pulpës rritet te:

- pulpitet akute (0.00)

- caries profunda (0.00)

- pulpitet seroze (0.00)

- pulpiti inicial(pulpiti reverzibil) (0.00)

- pulpiti kronik (9.00)

37. Gjatë trajtimit të kanaleve të infektuara të rrënjës (nekroza e pulpës) nuk përdoren:

- solucionet antiseptike (0.00)

- Solutio Chlumsky (0.00)

- pastat polivalente (0.00)

- preparatet e hidroksidit të kalciumit (0.00)

- pastat antibiotiko-vitaminoze (9.00)

38. Dhimbja provokuese është karakteristikë e:

- pulpitit akut (0.00)

- caries media (0.00)

- pulpitit kronik (0.00)

- caries profunda (9.00)

39. Ndryshimet radiografike te pulpitet mund të shihen:

- te substancat e forta të dhëmbëve (9.00)

- pulpë (0.00)

- periodoncium (0.00)

- nuk ka ndryshime në rtg (0.00)

- ndryshime në apeksin e rrënjës (0.00)

40. Simptomat e hipersensitivitetit të dentinës janë:

- dhimbje e shkurtë prerëse prej disa sekondave (9.00)

- dhimbje intermitente (0.00)

- dhimbje e zgjatur pas ngacmimit (0.00)

- dhimbje spontane (0.00)

- dhimbje gjatë ngrënies (0.00)

41. Me ndihmën e adhezivit arrihet një lidhje mes indeve të forta të dhëmbit dhe kompoziteve. Cila është ajo lidhje?

- kimike dhe mikromekanike (9.00)

- fibroze (0.00)

- sipërfaqësore (0.00)

- interdentale (0.00)

- acidike (0.00)

42. Në cilën mënyrë zgjidhet problemi i mikrorrjedhjes mes mbushjes dhe substancave të forta të dhëmbit te materialet kompozite?

- me arritjen e adhezionin mikromekanik dhe kimik (9.00)

- me preparimin e kaviteteve sipas principeve të Black-ut (0.00)

- me finirimin dhe lustrimin e duhur të mbushjeve (0.00)

- kompozitet kanë adhezion të shkëlqyer prandaj nuk ka nevojë për procedura shtesë (0.00)

- me shtresa mbrojtëse (0.00)

43. Me çfarë lustrohen kompozitet?

- disqe dhe goma (9.00)

- freza karbidi (0.00)

- freza diamanti (0.00)

- freza çeliku (0.00)

- polirues (0.00)

44. Lëngu i cementit të glasionomerit(CGI) është:

- acid i qelqtë (0.00)

- acid citric (0.00)

- acid kaliumi (0.00)

- acid fosforik (0.00)

- acid poliakrilik (9.00)

45. Fijet e Tomes-it në kanalet dentinare janë zgjatim i:

- cementoblasteve (0.00)

- ameloblasteve (0.00)

- osteoblasteve (0.00)

- fibroblasteve (0.00)

- odontoblasteve (9.00)

46. Anomalitë funksionale të dhëmbëve janë:

- fluoroza (0.00)

- hipoplazia (0.00)

- abrazioni (9.00)

- dentinogenesis imperfecta (0.00)

- amelogenesis imperfecta (0.00)

47. Cermetet janë:

- cemente të glasionomerit të përforcuar me kompozit (0.00)

- cemente të glasionomerit të dobësuar me acid (0.00)

- cemente të glasionomerit të përforcuar me metal (9.00)

- cemente të glasionomerit të përforcuar me mikro-grimca (0.00)

- cemente të glasionomerit prej qelqi të mbuluara me acid (0.00)

48. Zink oksid eugenoli përzihet me:

- ujë (0.00)

- 40-70% tretësirë të acidit ortofosforik (0.00)

- eugenol (0.00)

- acid poliakrilik (0.00)

- eugenol dhe oleium kariofilorum (9.00)

49. Çfarë paraqet fosee-routte te kanalet?

- mbushje të kanalit (0.00)

- mbushje periapikale (0.00)

- obturim (0.00)

- artefakt rentgenologjik (0.00)

- perforim (9.00)

50. Çfarë aplikohet në kavitet përpara se të vendoset glasionomeri?

- shtresë (0.00)

- bond (0.00)

- lubrikant (0.00)

- adheziv (0.00)

- kondicioner (9.00)

Болести на забите и ендодонтот - Писмен, Студија

4.2.1- Sëmundjet e dhëmbëve dhe të endodonciumit-Me shkrim, Studim

1. Vlera e pH-së e pastës së hidroksidit të kalciumit është?

- pH 12 (1.50)
- pH 8 (0.00)
- pH 3 (0.00)
- pH 20 (0.00)
- pH 21 (0.00)

2. Amputimi i pulpës dentare mund të jetë:

- amputim vital dhe mortal (1.50)
- mbulim direkt (0.00)
- amputim i radiks (0.00)
- palatinal (0.00)
- intrapulpar (0.00)

3. Apeksi i dhëmbit përbëhet nga:

- cementi celular (1.50)
-cementi i kanalit (0.00)
- cementi fibrinoz (0.00)
- cementi primar (0.00)
- cementi sekondar (0.00)

4. Dhimbja si simptomë klinike e gangrenës manifestohet si:

- nuk ka dhimbje (1.50)

- dhimbje spontane (0.00)

- dhimbje e vazhdueshme (0.00)

- dhimbje e provokuar në të ftohtë (0.00)

- dhimbje e mprehtë dhe prerëse(0.00)

5. Në terapinë endodontike preparatet që ngurtësohen pas aplikimit të tyre në kanal bëjnë pjesë në:

- mbushje definitive (1.50)

- pasta të buta (0.00)

- mbushje të përkohshme (0.00)

- aliazhe të argjendit (0.00)

- mbushje periapikale (0.00)

6. Në periodoncium gjenden:

- fijet e Sharpeut (1.50)

- osteoklastet (0.00)

- mbetjet e invagjinimit të Hertwigut (0.00)

- odontoblaste (0.00)

- linjat Fon-Ebner (0.00)

7. Tek pulpitet në rast të një dhimbjeje të fortë akute, preparati i parë për lehtësimin e dhimbjes është:

- peroksidi i hidrogjenit (0.00)

- pasta antibiotike (0.00)

- jodoformi (0.00)

- hidroksidi i kalciumit (0.00)

- solutio chlumsky (1.50)

8. Gutaperka mund të përdoret si:

- shtresë (0.00)

- mbyllje e përkohshme (1.50)

- nën mbushje të kompozitit (0.00)

- mbi mbushjen e amalgamit (0.00)

- mbrojtje e plagës dentinare (0.00)

9. Për nekrotizimin e pulpës përdoret:

- toxaviti (1.50)

- trioksid arseni (0.00)

- trio pasta (0.00)

- rockles (0.00)

- hidroksidi i kalciumit (0.00)

10. Instrumenti për largimin e masave karioze quhet:

- Butterlock (0.00)

- sondë (0.00)

- gjylpërë eMiller (0.00)

- lentulë (0.00)

- eskavator (1.50)

12. Në periodontitin akut, një masë e rëndësishme terapeutike është:

- aplikimi i toxavitit (0.00)

- hemisekcioni (0.00)

- aplikimi i solutio chlumsky-t (0.00)

- aplikimi i pastës së butë (0.00)

- drenazha (1.50)

13. Te ekstirpimi vital, për mbushje apikale përdorim:

- mbushje të butë (0.00)

- cementin e timolit (0.00)

- triopastën (0.00)

- ZnOOC (0.00)

- pastën e Calxyl-it (1.50)

16. Si është forma e kavitetit aproksimal në klasën e tretë?

- trekëndëshe (1.50)

- trapezoidale (0.00)

- ovale (0.00)

- katërkëndore (0.00)

- drejtkëndore (0.00)

17. Si diagnostifikohen dentiklat?

- klinikisht (0.00)

- me termo test (0.00)

- me elektro test (0.00)

- me perkusion (0.00)

- me radiografi (1.50)

19. Cilën veti duhet të përmbushë preparati për irrigim të kanalit të rrënjës?

- vetinë antivirusale (0.00)

- t'i koagulojë proteinat (0.00)

- të zgjerojë foramenin fiziologjik (0.00)

- të zgjerojë kanalin (0.00)

- vetinë antibakteriale (1.50)

20. Cili preparat përdoret për zbardhjen e dhëmbëve vital dhe avital?

- hipokloriti i natriumit (0.00)

- peroksidi i hidrogjenit 35% (1.50)

- peroksidi i ureas 35% (0.00)

- kloruri metilen 35% (0.00)

- fluor apatiti (0.00)

21. Cilat qeliza e formojnë dentinën?

- odontoblastet (1.50)

- osteoblastet (0.00)

- citoblastet (0.00)

- fibroblastet (0.00)

- ameloblastet (0.00)

22. Cilat metoda odontometrike ekzistojnë?

- magnetike (0.00)

- sistemike (0.00)

- laseret (0.00)

- periferike (0.00)

- elektrometrike (1.50)

23. Çfarë vetishë duhet të përmbush preparati për irrigim të kanalit të rrënjës?

- të largojë mekanikisht përbërjen nga kanali (1.50)

- të stimulojë odontogjenezën (0.00)

- të cikatrizojë regjionin periapikal (0.00)

- të ketë veti antivirusale (0.00)

- të zgjeroj foramenin fiziologjik (0.00)

24. Cili dhëmb zakonisht ka dy kanale në një rrënjë?

- incizivi i parë mandibular (0.00)

- paramolari i parë maksilar (0.00)

- paramolari i parë mandibular (0.00)

- kanini maksilar (0.00)

- paramolari i dytë maksilar (1.50)

25. Cili instrument është për zgjerimin manual të kanaleve të rrënjës?

- gjilpëra e Miller-it(zgjeruesi) (0.00)

- lentula (0.00)

- butterlock (0.00)

- nerv gjilpëra (0.00)

- kerr gjilpëra (1.50)

26. Cili irrigues është zgjedhja e parë në endodoncion?

- peroksidi i hidrogjenit 3% (0.00)

- hipokloriti i natriumit 5% (0.00)

- peroksidi i hidrogjenit 25% (0.00)

- glukonat klorheksidina 0.2% (0.00)

- hipokloriti i natriumit 2.5% (1.50)

27. Cilin preparat e aplikojmë për mbulimin direkt të pulpës?

- gutaperkën(0.00)

- zink oksid eugenolin (0.00)

- zink oksid oleumcariofilorum-in(ZnOOC) (0.00)

- zinksulfat cementin (0.00)

- pastën e hidroksidit të kalciumit (1.50)

28. Cili sistem për evidentim kompjuterik përdoret për shënimin e dhëmbëve?

- dyshifror (1.50)

- sistemi i Black-ut (0.00)

- koordinues (0.00)

- angular (0.00)

- skandinav (0.00)

29. Për cilën klasë bëhet fjalë kur kemi karies në të tretën gingivale?

- klasën e parë (0.00)

- klasën e dytë (0.00)

- klasën e tretë (0.00)

- klasën e katërt (0.00)

- klasën e pestë (1.50)

30. Kanali i rrënjës nuk duhet të mbushet në rastet kur:

- kanali i rrënjës është i thatë (0.00)

- kanali është i zgjeruar dhe i thatë (0.00)

- kanali është i përpunuar dhe i shpërlarë mjaftueshëm (0.00)

- pas odontometrisë (0.00)

- ka ndjeshmëri perkutore (1.50)

31. Kanali i rrënjës mbushet përkohësisht:

- pas ekstirpimit vital (0.00)

- pas ekstirpimit mortal (0.00)

- pas përpunimit biomekanik të kanalit te nekroza e pulpës (0.00)

- kur kanali i rrënjës nuk është i thatë (0.00)

-të gjitha gjendjet e lartëpërmendura (1.50)

32. Fasha medikamentoze aplikohet në kanal gjatë:

- ekstirpimit mortal dhe vital (1.50)

- mbulimit direkt (0.00)

- mbulimit indirekt (0.00)

- caries profunda (0.00)

- caries media (0.00)

33. Veti negative e kompoziteve është:

- tkurrja gjatë polimerizimit (1.50)

- makroretencioni (0.00)

- i papërshtatshëm për vendet me mastikacion të fortë (0.00)

- pamja joestetike (0.00)

- adheziviteti i dobët (0.00)

34. Odontometria është një metodë për:

- mbushjen e kanalit (0.00)

- përpunimin e kanalit me ultrazë (0.00)

- test të vitalitetit të pulpës (0.00)

- dezinfektimin e kanalit të rrënjës (0.00)

- përcaktimin e gjatësisë së kanalit të rrënjës (1.50)

35. Pacienti tregon dhimbje të forta spontane, dhëmbi është kariotik, i ndjeshëm ndaj perkusionit, ka edemë intraorale në projeksion të majës së rrënjës. Diagnoza është:

- pulpitis acuta purulenta totalis (0.00)

- pulpiti acuta serosa totalis (0.00)

- caries profunda (0.00)

- parodontitis acuta (1.50)

- parodontitis chronica progresiva (0.00)

37. Pas veprimit të acid fosforik 37% në smalt arrihet:

- mikroretensioni (1.50)

- makroretensioni (0.00)

- toaleta (0.00)

- bondimi (0.00)

- obturimi (0.00)

38. Vendosja e shtresave bëhet me qëllim të:

- mbrojtjes së pulpës nga ndikimet termike dhe kimike (1.50)

- restaurimit të pikës së kontaktit (0.00)

- fortësisë më të madhe të mbushjes (0.00)

- Adhezivitetit më të madh të mbushjes (0.00)

- Mbrojtjes së mbushjes nga frakturat (0.00)

39. Preparatet në bazë të fluorit përdoren si:

- mbushje të kanalit (0.00)

- preparate remineralizuese (1.50)

- preparate për vitalitet (0.00)

- preparate për rtg diagnostifikim (0.00)

- preparate për mbulim direkt (0.00)

40. Tek periodontiti gjatë ekstirpimit të kanalit fitohet ind i cili është:

- me karies (0.00)

- në shkatërrim (1.50)

- ind fibroz (0.00)

- i cikatrizuar (0.00)

- granulomatoz (0.00)

41. Arsyet për një përgjigje të rrejshme pozitive në elektro test janë si më poshtë:

- pacient i shqetësuar (0.00)

- izolim jo i duhur i dhëmbit(0.00)

- dhëmb i anestezuar (0.00)

- dhëmb pothuajse i eruptuar (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (1.50)

43. Pulpa tek gangrena është:

- avitale (1.50)

- pragu i ngacmimit është i rritur (0.00)

- pragu i ngacmimit është i zvogëluar (0.00)

- pa ndryshime (0.00)

- vitale (0.00)

44. Hijet e ndriçuara në rtg inçizim paraqesin:

- struktura periferike (0.00)

- struktura të holla (0.00)

- struktura të kanaleve (0.00)

- struktura dentare me densitet më të ulët (0.00)

- struktura dentare me densitet më të lartë (1.50)

45. Simptomat e dentinës hipersensitive janë:

- dhimbje e shkurtër prerëse (1.50)

- dhimbje spontane (0.00)

- dhimbje gjatë natës (0.00)

- dhimbje reflektuese (0.00)

- dhimbje e përditshme (0.00)

46. Me çfarë lloj freze bëjmë trepanimin?

- me frezë të nikel - titaniumit (0.00)

- me frezë të bakrit (0.00)

- me frezë të karbidit (0.00)

- me frezë të diamantit (0.00)

- me frezë të çelikut (1.50)

47. Procedura terapeutike te periodontiti akut është:

- urgjente (1.50)

- me kortikosteroide (0.00)

- me antibiotikë (0.00)

- kirurgjikale (0.00)

- e zgjatur (0.00)

48. Testi me të cilin ekzaminohet vitaliteti i pulpës është:

- termo testi (1.50)

- perkusioni (0.00)

- anestezioni selektiv (0.00)

- radiografia (0.00)

- palpimi (0.00)

49. Fijet e Tomesit janë zgjatime citoplazmatike të cilave qeliza?

- Protezat shallt, të kufizuara distalisht, të kombinuara; (0.50)

220. Hapësira e lirë interokluzale gjatë përcaktimit të qetësisë fiziologjike tek normookluzioni duhet të jetë:

- 0,5-2 mm (0,00)

- 1-2 mm (0.00)

- 3-5 mm (0.50)

- 4-5 mm (0.00)

- 5 mm (0.00)

221. Me masën anatomike fitohet pozita e mukozës dhe inserimi muscular në gjendje të:

- lëvizjes aktive (0.00)

- në qetësi (0.50)

- lëvizjes pasive (0.00)

- lëvizjes aktive dhe qetësisë (0.00)

- në funksion (0.00)

222. Me çfarë materiali merret masa funksionale?

- Gips (0.00)

- Gutta-perkë (0.00)

- Masë elastomere (0.50)

- Dyll (0.00)

- Lugë standarde (0.00)

223. Me çfarë përcaktohet drejtimi i vendosjes së protezës parciale?

- me gnatometër (0.00)

- me paralelometër (0.50)

- me hark facial kinematik (0.00)

- me hark facial transferues (0.00)

- Trekëndëshin Bonville (0.00)

224. Gjendja e qetësisë fiziologjike përcaktohet me:

- me metodën fonetike (0.50)

- matja e hapësirës më të vogël të të folurit (0.00)

- me vizoren sipas Fox (0.00)

- metodën elektrognatodinamometrike; (0.00)

- tomografinë e ATM-së (0.00)

226. Sipas çfarë është bërë klasifikimi sipas Kerber?

- sipas pozicionit të linjave të peshës (0.00)

- sipas pozicionit të linjave mbështetëse (0.50)

- sipas pozicionit të linjave retencionale (0.00)

- sipas vijës mediale (0.00)

- sipas vijës që kalon përmes mesit të papilla inciziva (0.00)

227. Sipas çfarë është bërë klasifikimi i Kummer?

- sipas pozicionit të linjave të peshës (0.00)

- sipas pozicionit të linjave mbështetëse (0.00)

- sipas pozicionit të linjave retencionale (0.50)

- sipas vijës mediale (0.00)

- sipas vijës që kalon përmes mesit të papilla inciziva (0.00)

228. Luga standarde për marrjen e masës anatomike nga nofulla me padhëmbësi të pjesëshme është me:

- me hapësirë të rrumbullakosur edhe me fund të rrafshtë të hapësirës së lugës(0.50)

- me fund të rrafshtë të hapësirës së lugës (0.00)

- nuk ka formë të përcaktuar të hapësirës së lugës (0.00)

- forma e hapësirës mvaret nga materiali për marrjen e masës (0.00)

- hapësirë të hapur të lugës (0.00)

229. Luga standarde për marrjen e masës anatomike nga nofulla me padhëmbësi totale është me:

- hapësirë të rrumbullakosur të lugës(0.50)

- fund të rrafshët të hapësirës së lugës (0.00)

- nuk ka formë të përcaktuar të hapësirës së lugës (0.00)

- forma e korit varet nga tabela e printimit (0.00)

- ka të kombinuar fund të drejtë dhe të rrumbullakosur të hapësirës së lugës (0.00)

230. Dyllërat stomatologjik të përbërë nga disa lloje të dyllit, kanë:

- pikë të shkrirjes (0.00)

- interval të shkrirjes (0.50)

- pikë konstante të shkrirjes (0.00)

- pikë të lartë të shkrirjes (0.00)

- pikë të ulët të shkrirjes (0.00)

231. Padhëmbësia e ndërmjetme anësore i takon:

- Klasës së parë sipas Kennedy (0.00)

- klasës së dytë sipas Kennedy (0.00)

- klasës së katërt sipas Kennedy (0.00)

- klasës së tretë sipas Kennedy (0.50)

- nuk klasifikohet nga Kennedy (0.00)

232. Protezat subtotale janë:

- proteza parciale minimale (0.00)

- proteza parciale maksimale (0.50)

- proteza totale (0.00)

- pjesa bazale- e poshtme e protezës (0.00)

- baza e protezës që nuk lustrohet (0.00)

233. Qiellzën e fortë e ndërtojnë:

- procesus palatinus i maksilës dhe lamina horizontale e kockës palatinale (0.50)

- procesus palatinus i maksilës dhe procesus alveolaris e maksilës (0.00)

- procesus palatinus i maksilës dhe lamina vertikale e kockës palatinale (0.00)

- sipërfaqja distale e kockës palatinale (0.00)

- pjesa meziale e kockës palatinale (0.00)

234. Vështirësitë në shqiptimin e shkronjës “S” shfaqen gjatë:

-.vendosjes joadekuate të dhëmbëve të përparëm (0.50)

- mbulimit të papërshtatshëm të dhëmbëve anësorë të sipërm (0.00)

- vendosjes joadekuate të dhëmbëve të poshtëm (0.00)

- mbulimit të papërshtatshëm të dhëmbëve anësorë të poshtëm (0.00)

- bazës së zgjatur të protezës (0.00)

235. Indi që nuk është pjesë e periodontit është:

- kocka alveolare (0.00)

- cementi i dhëmbit (0.00)

- periodonciumi (0.00)

- gingiva (0.00)

- gjuha (0.50)

236. Torus palatinus ndodhet në:

- në pjesën e prapme të palatumit (0.50)

- pjesën e mesme të palatumit (0.00)

- pjesën e përparme të palatumit (0.00)

- në zonën e kanalit incizal (0.00)

- lateral nga linja mediale e palatumit (0.00)

237. Skaji faringeal i lugës duhet të kryej kompresion në zonën e vibrimit (zona e mukozës relativisht të lëvizshme) që të arrihet:

- ngarkesë e mirë (0.00)

- shkarkim i duhur (0.00)

-shmangja e nauzesë (0.00)

- mbyllje e mirë ventiluese (0.50)

- shqiptimi i saktë i disa bashkëtingëlloreve (0.00)

238. Marrja e masës funksionale te padhëmbësia parciale merret me këto materiale:

- masa elastomere gumoze (0.50)

- alginat (0.00)

- agar agar (0.00)

- dyll roze (0.00)

- hidrokolloid reverzibil (0.00)

239. Masa funksionale për protezën totale më së shpeshti merret me:

- masë kompresive (0.00)

- masë akompresive (0.00)

- masë selektive (0.50)

- masë njëfazore (0.00)

- masë sipas Snoslovski (0.00)

240. Hipofunksioni dhe afunksioni çojnë në:

- atrofi (0.50)

- hipertrofi (0.00)

- gjakderdhje (0.00)

- dislokim të dhëmbëve (0.00)

- elongim të dhëmbëve (0.00)

241. Okluzioni qendror është:

- pozicioni më distal jo i detyruar i mandibulës gjatë relacionit vertikal të caktuar nga e cila mund të kryen lëvizje laterale të lira (0.50)

- pozicioni qendror jo i detyruar i mandibulës gjatë relacionit vertikal të caktuar nga e cila mundet kryen lëvizje laterale të lira (0.00)

- pozicioni mezial jo i detyruar i mandibulës gjatë relacionit vertikal të caktuar nga e cila mundet kryen lëvizje laterale të lira (0.00)

-. pozicion mezial i detyruar i mandibulës gjatë relacionit vertikal të caktuar nga e cila mund të kryen lëvizje laterale të lira (0.00)

- pozicioni më distal jo i detyruar i mandibulës gjatë relacionit vertikal të caktuar nga e cila nuk mundet të kryen lëvizje laterale të lira (0.00)

242. Pozicioni qendror i mandibulës mund të përcaktohet me

- ndihmën e metodës së shqiptimit të M (0.00)

- metodën e ndarjes së fytyrës në të treta (0.00)

- metodën e gërryerjes së dhëmbëve (0.00)

- metodën e regjistrimit intraoral (0.50)

- metodën e hapjes dhe mbylljes (0.00)

243. Gjerësia e lidhësit transversal duhet të jetë

- 10-12 mm (0,50)

- 6-8 mm (0.00)

- 4-6 mm (0.00)

- 2-4 mm (0.00)

- Më e vogël se 1 mm (0.00)

244. Çfarë mase marrin lugët Ivotray për nofullat pa dhëmbë?

- vetëm masën e nofullës së sipërme pa dhëmbë (0.00)

- vetëm masën e nofullës së poshtme pa dhëmbë (0.00)

- masën e secilës nofull veçmas edhe gjatë kafshimit të hapur (0.00)

- Marrja e njëkohshme e masës anatomike nga nofulla e sipërme dhe e poshtme pa dhëmbë (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

Мобилна стоматолошка протетика - Устен

7.1.2-Protetika stomatologjike mobile - Me gojë

1. Nëse relacioni okluzal vertikal i mandibulës është vendosur më lartë, ajo manifestohet me:

- uljen e hapësirës së lirë interokluzale (6.00)

- rritjen e hapësirës së lirë interokluzale (0.00)

- Fenomenin e Christensen-it (0.00)

-shfaqjen e cheilitit angular (0.00)

-shfaqjen e gëlltitjes infantile (0.00)

2. Marrja e masës akompresive ose mukostatike:

- regjistron vetëm pjesët e palëvizshme të fundamentit (6.00)

- ngarkon fiziologjikisht të gjitha indet (0.00)

- ngarkon vetëm indet reziliente (0.00)

- nuk ka ndikim në ngarkesën e indeve (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

3. Analiza e funksionit okluzal kryhet me ndihmën e:

- ekzaminimeve radiografike (0.00)

- regjistrimin e fenomenit të Christensen-it (0.00)

- ekzaminimeve artikuluese (6.00)

- ekzaminimeve fonetike (0.00)

- ekzaminimeve pantomografike (0.00)

4. Krahu vestibular i protezës totale të sipërme shtrihet:

- nga plikat bukale distalisht deri te plika pterigomandibulare (0.00)

- mes plikës pterigomandibulare të majtë dhe të djathtë (6.00)

- mes plikave bukale të sipërme të përparme dhe të pasme (0.00)

- mes plikave bukale të sipërme të përparme (0.00)

- mes kreshtës alveolare dhe ramusit të mandibulës (0.00)

5. Në bazën biologjike për ekstenzionin e bazës së protezës totale ka ndikim:

- struktura kockore te sistemit përtypës (0.00)

- drejtimi i kontrakcionit të fijeve muskulare në raport me skajet e protezës (6.00)

- mukoza palatinale (0.00)

- ligamenti stylomandibular (0.00)

- m platysma (0.00)

6. Në retencionin e protezës totale, nga faktorët fizik ndikim më të madh ka:

- presioni negativ në protezë (6.00)

- kapilariteti (0.00)

- pesha e protezës (0.00)

- forcat e tensionit sipërfaqësor (0.00)

- forcat e kohezionit dhe adhezionit (0.00)

7. Pjesa gingivale e protezës përbëhet nga:

- pllaka dhe shala e protezës (6.00)

- shalët dhe kroshetë e protezës (0.00)

- kroshetë me mbështetës okluzal (.00)

- mbështetësit okluzal (0.00)

- ataçmentet (0.00)

8. Madhësia e zhvendosjes distale të mandibulës nga pozicioni i okluzionit qendror në pozicionin e retruduar është:

- 0,5 - 1,5 mm (6,00)

- më pak se 0.5 mm (0.00)

- 2.5 - 3.5 mm (0.00)

- 2 - 5 mm (0.00)

- më shumë se 6 mm (0.00)

9. Njëra nga format e mëposhtme nuk i takon nofullës së poshtme?

- pllaka linguale (0.00)

- harku sublingual (0.00)

- harku sublingual në kombinim me harkun sekondar (0.00)

- baza e fenestruar (6.00)

- harku i vendosur vestibularisht (0.00)

10. Elementet me të cilët presioni i përtypjes transmetohet përmes parodontit të dhëmbit janë :

- Mbështetësi okluzal (0.00)

- kurora teleskopike (0.00)

- ataçmentet (0.00)

- mbështetësi lingual (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (6.00)

11. Për vendosjen e kroshesë Bonvill na nevojitet:

- një hapësirë interdentale (6.00)

- tre hapësira interdentale (0.00)

- dy hapësira interdentale (0.00)

- katër hapësira interdentale (0.00)

- më shumë hapësira interdentale (0.00)

12. Buza e pasme e protezës së sipërme totale është e vendosur:

- në zonën faringeale (6.00)

- në zonën bukale (0.00)

- zonën e laringut (0.00)

- hapësirën vestibulare (0.00)

- hapësirën paratubare (0.00)

13. Sa është vlera mesatare e këndit të Bennet-it:

- 15 (6.00)

- 10 (0.00)

- 33 (0.00)

- 25 (0.00)

- 11 (0.00)

14. Ku ndodhet foramen mentale?

- nën rrënjët e paramolarëve të poshtëm (6.00)

- nën rrënjën e incizivit anësorë të poshtëm (0.00)

- nën rrënjën e molarit të parë të poshtëm (0.00)

- në anën e brendshme të nofullës së poshtme (0.00)

- në anën e brendshme të ramus mandibulae (0.00)

15. Cilat inde në nofullën e sipërme kanë reziliencë minimale të mukozës orale?

- raphe palati (6.00)

- papilla incisiva (0.00)

- tuberculum labii superior (0.00)

- plica pterygomandibulare (0.00)

- frenulum labii superioris (0.00)

16. Më së shpeshti, çfarë forme ka skaji i pasëm i qiellzës kockore? +

- formë karakteristike bikonkave (6.00)

- formë karakteristike trekëndore (0.00)

- në formën e një vije të drejtë (0.00)

- formë poligonale (0.00)

- tangjenciale (0.00)

17. Cilat inde kanë reziliencë minimale të mukozës orale në nofullën e sipërme?

- torus palatinus (6.00)

- papilla incisiva (0.00)

- tuberculum labii superioris (0.00)

- plica pterygomandibularis (0.00)

- frenulum labii superioris (0.00)

18. Cili detaj anatomik ndodhet në pjesën e pasme të zgjatimit alveolar në të dy anët e nofullës së sipërme?

- tuberculum alveolare maxillae (6.00)

- tuber maxillae (0.00)

- arcus alveolaris (0.00)

- trigonum retromolare (0.00)

- alveoli dentales (0.00)

19. Cili është drejtimi i favorshëm i kontrakcionit të fijeve muskulore për ekstenzionin e bazës së protezës:

- paralele ose afërsisht paralele me skajin (6.00)

- vertikale me skajin e protezës (0.00)

- drejtimi i kontrakcionit të fijeve muskulore nuk ka efekt për ekstenzionin e bazës (0.00)

- drejtimi i kontrakcionit të fijeve muskulore është i rëndësishëm vetëm në anën palatinale të protezës së sipërme totale (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

20. Cila pjesë e kroshesë ekuatoriale është retencionale:

- bishti (0.00)

- krahu i kroshesë (0.00)

- trupi i kroshesë (0.00)

- mbështetësi okluzal (0.00)

- dora e kroshesë (6.00)

21. Cila nga kroshetë e mëposhtme nuk ka funksionin e transmetimit dentar të presionit përtypës?

- Ney (0.00)

- Bonville (0.00)

- Jackson (0.00)

- krosheja e kombinuar Ney(0.00)

- Bonihard (6.00)

22. Linja që lidh elementet retencionale quhet:

- linja mbështetëse (0.00)

- linja diagonale (0.00)

- linja retencionale (6.00)

- linja prerëse (0.00)

- linja e peshës (0.00)

23. Vendndodhja dhe forma e skajit faringeal ka këto karakteristika:

- është karakteristikë individuale (6.00)

- në të gjithë pacientët përputhet me tuber tangjentën (0.00)

- mvaret nga forma e papillae incisive (0.00)

- mvaret nga skaji i pasëm i processus palatinus maxillae (0.00)

- mvaret nga ngjitja e sipërme e muskulit masseter (0.00)

24. Në linea obliqua externa gjendet ngjitja e:

- m. buccinator (6.00)

- m. orbicularis oris (0.00)

- m. mentalis (0.00)

- m. masseter (0.00)

- m. genioglossus (0.00)

25. Mungesa më e madhe e hidrokoloideve ireverzibile është se janë:

- heteroskope (0.00)

- multiskope (0.00)

- indiferente ndaj ujit (0.00)

- janë elastike (0.00)

- hidroskope (6.00)

26. Gjeni përgjigjen e pasaktë. Cila nga përgjigjet e mëposhtme nuk i përket rregullave të përgjithshme për vendosjen e dhëmbëve:

- rregulli i gjuhës dhe hapësira neutrale (0.00)

- rregullat statike (0.00)

- rregullat për interkuspidim (0.00)

- rregullat për ekuilibrin artikulues (0.00)

- Të gjitha përgjigjet janë të pasakta (6.00)

27. Gjeni përgjigjen e pasaktë. Sipas madhësisë dhe formës së bazës, protezat parciale ndahen në:

- proteza parciale pllakore (0.00)

- proteza parciale të reduktuara (0.00)

- proteza parciale të skeletuara (0.00)

- proteza parciale imediate (6.00)

- proteza parciale të racionuara (0.00)

28.Pika më e shprehur në ballë në mes të vetullave mbi rrënjën e hundës shtrihet në linjën mediale dhe shënohet si:

- (gl) glabella (6.00)

- (n) nazion (0.00)

- (gn) gonion (0.00)

- (tr) trichion (0.00)

- (ft) frontotemporale (0.00)

29. Nga metodat klinike të përcaktimit të skajit të pasëm, rezultate më të mira jep metoda e:

- linjës a-ha, përkatësisht zona e vibrimit (6.00)

- linjës së fryrjes me hundë (0.00)

- linjës së foveolae palatinae deri te pterygomandibularis (0.00)

- tuber tangjenta (0.00)

- gjerësisë së qiellzës së fortë (0.00)

30. Mbështetësi okluzal duhet të jetë i thellë:

- 1,5-2 mm (6,00)

- 2-4 mm (0.00)

- 0,5-1 mm (0,00)

- 1-1,5 mm (0.00)

- 3-4 mm (0.00)

31. Ngarkesa e mukozës orale gjatë mastikacionit është:

- rreth 4.5 kg / cm2 në pjesën frontale (6.00)

- e njëjtë në pjesën frontale dhe anësore (0.00)

- rreth 15.5 kg / cm2 në pjesën frontale(0.00)

- ngarkesa varet nga struktura kockore (0.00)

- më e madhe në pjesën frontale, më e vogël në pjesët anësore (0.00)

32. Paralelometri është instrument matës i cili përdoret në protetikën fikse për:

- matjen e thellësisë së nënminuar (6.00)

- matjen e distancës interokluzale (0.00)

- përcaktimin e rrugës së vendosjes së protezës (0.00)

- kontrollin e okluzionit (0.00)

- matjen e forcës së presionit përtypës (0.00)

33. Relacioni okluzal vertikal i përcaktuar më lartë manifestohet me:

- kontaktin e parakohshëm okluzal dhe trokitjen e protezave (6.00)

- dukshmërinë e zvogëluar të dhëmbëve (0.00)

- shfaqjen e heilitit angular (0.00)

- rritjen e hapësirës së lirë interokluzale (0.00)

- shfaqjen e gëlltitjes infantile (0.00)

34. Harku nëngjuhësor tek proteza parciale e skeletuar duhet të jetë i larguar nga mukoza e lëvizshme në dyshemenë e zgavrës së gojës:

- 2-4 mm (0.00)

- 3-5 mm (0.00)

- 1-2 mm (6.00)

- 0-2 mm (0.00)

- 5-6 mm (0.00)

35. Harku nëngjuhësor duhet të jetë larguar nga gingiva margjinale:

- më së paku 4-5 mm (0.00)

- të shtrihet në gingivën margjinale (0.00)

- më së paku 1-2 mm (6.00)

- më së paku 6-8 mm (0.00)

- më së paku 8-10 mm (0.00)

36. Relacioni vertikal i përcaktuar më ulët manifestohet me:

- trokitjen e protezave (0.00)

- me zvogëlim të hapësirës së lirë interokluzale (0.00)

- shfaqjen e fisurave dhe ragadave në këndet e buzëve (6.00)

- rritja të dukshmërisë së dhëmbëve (0.00)

- pozitë retropulsive të mandibulës (0.00)

37. Nënklasa në klasifikimin Kennedy përcakton:

- numrin e dhëmbëve të ekstraktuar (0.00)

- numrin e hapësirave pa dhëmbë (6.00)

- numrin e hapësirave pa dhëmbë pranë klasës bazë (0.00)

- numrin e shalave terminale (0.00)

- gjatësinë e shalës pa dhëmbë (0.00)

38. Shkarkimi i duhur i indeve nën protezën totale është më i përshtatshëm të bëhet:

- gjatë përgatitjes së protezës totale në laborator (0.00)

- në protezë të përfunduar me gërryerje (0.00)

- gjatë marrjes së masës (6.00)

- të bëhet kurdo qoftë (0.00)

- në protezë të përfunduar, me marrje të masës dhe mbushje (0.00)

39. Gjatë përdorimit të krosheve njëkrahëshe ata vendosen:

- në të dy anët (6.00)

- vetëm në njërën anë (0.00)

- në dhëmbët prerës (0.00)

- mund të vendosen njëanshëm dhe dyanshëm (0.00)

- në mënyrë diagonale (0.00)

40. Gjatë përdorimit të ataçmentëve rezilient lëvizjet e shalës sigurohen me:

- modulin e elasticitetit të materialit (0.00)

- unazën e translacionit (6.00)

- me një hark palatinal më të hollë (0.00)

- me fleksibilitet të bashkuesit të vogël (0.00)

- me forcën e fërkimit në mes pjesëve të ataçmentëve (0.00)

41. Gjatë përpunimit të protezave parciale, gjatë provës së dhëmbëve në dyll:

- kroshetë e telit duhet të jenë të vendosura (6.00)

- kroshetë nuk duhet të vendosen (0.00)

- nuk nevojiten kroshetë (0.00)

- kroshetë vendosen pas provës së dhëmbëve (0.00)

- kroshetë vendosen gjatë procedurave përfundimtare (0.00)

42. Ataçmentët rezilient indikohen:

- tek dhëmbët e depulpuar (0.00)

- tek protezat me dy shala të ndërmjetme (0.00)

- tek protezat me një shalë të ndërtmjetme (0.00)

- tek protezat me shalë të lirë (6.00)

- tek protezat parciale pllakore (0.00)

43. Çdo kontakt i dhëmbëve të poshtëm me ato të sipërm kur mandibula nuk është në lëvizje shënohet si:

- okluzion dinamik (0.00)

- ekuilibër i artikulimit (0.00)

- okluzion habituel (0.00)

- okluzion qendror (0.00)

- okluzion (6.00)

44. Shala e lirë gjatë mastikacionit mund të kryejë:

- tre lëvizje rrotulluese dhe tre translatore (6.00)

- dy lëvizje rrotulluese dhe dy translatore (0.00)

- katër lëvizje rrotulluese dhe dy translatore (0.00)

- një lëvizje rrotulluese dhe një translatore (0.00)

- dy lëvizje rrotulluese dhe një translatore (0.00)

45. Sipas lëvizshmërisë së indeve, stabiliteti i protezës mund të ndikohet drejtpërdrejtë nga:

- mukoza orale (0.00)

- indi gjëndëror dhe lidhor (0.00)

- vetëm muskujt (6.00)

- kanalet dalëse të gjëndrave pështymore (0.00)

- mukoza palatinale (0.00)

46. Në varësi të funksionit, ataçmentët fabrikues mund të jenë:

- paramolar dhe molar (0.00)

- interdental dhe ekstradental (0.00)

- për nofullën e poshtme dhe për nofullën e sipërme (0.00)

- rezilient dhe rigid (6.00)

- supraradikular dhe intrakoronar (0.00)

47. Harku transversal palatinal si formë nuk përdoret tek:

- Kennedy III (0.00)

- Kennedy (0.00)

- Kennedy I (0.00)

- Kennedy IV (6.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

48. Boshti transversal që bashkon mbështetësit dhe kalon përmes bazës së protezës parciale quhet:

- prerës (6.00)

- tangjent (0.00)

- normal (0.00)

- sagjital (0.00)

- vertikal (0.00)

49. Klasifikimi funksional i padhëmbësisë parciale i referohet:

- metodës së ngarkimit të indit (6.00)

- raporteve ndërnofullore (0.00)

- rradhitjes topografike të dhëmbëve (0.00)

- raportit të antagonistëve (0.00)

- rradhitjes multilaterale (0.00)

50. Fortësia e harkut nëngjuhësor sigurohet me gjërësinë e tij e cila:

- duhet të jetë më pak se 3 mm (0.00)

- nuk duhet të jetë më pak se 4 mm (6.00)

- duhet të jetë nga 5-10 mm (0.00)

- të jetë më i madh se 6 mm (0.00)

- duhet të jetë 2-3 mm (0.00)

Мобилна стоматолошка протетика - Писмен, Студија

7.2.1- Protetika stomatologjike mobile-Me shkrim, Studim

1. Baza e protezës totale të nofullës së poshtme sipas konceptit bashkëkohor është:

- ekstenzive por edhe mukodinamike(1.50)

- ekstenzive dhe statike (0.00)

- e reduktuar dhe statike (0.00)

- e formuar në bazë të masës anatomike (0.00)

- kompresive (0.00)

2. Krahu bukal i protezës totale të poshtme shtrihet:

- nga plikat gingivobukale distalisht deri në plikat pterygomandibulare (1.50)

- në mes plikës pterigomandibulare të djathtë dhe të majtë (0.00)

- në mes plikave bukale të sipërme, të përparme dhe të pasme (0.00)

- në mes plikave bukale të poshtme të përparme (0.00)

- në mes kreshtës alveolare dhe ramusit të mandibulës (0.00)

3. Ndikimi i indit muskulor në protezë do të jetë:

- më i madh nëse midis indit muskulor dhe sipërfaqes orale ka një shtresë më të madhe të indit të butë gjëndror (0.00)

- më i madh nëse indet muskulore janë më afër sipërfaqes (1.50)

- ndikimi i muskujve në protezë nuk varet nga pozita e indit muskulor (0.00)

- më i mëdh nëse ngjitjet muskulore janë më larg nga skajet e protezës (0.00)

- më i vogël nëse indi muskulor është më afër sipërfaqes (0.00)

4. Në bazë të tëcilit model përpunohet luga individuale?

- modelit të fituar nga derdhja e masës anatomike (1.50)

- modelit të fituar nga derdhja e masës funksionale (0.00)

- përpunohet drejtpërdrejtë në gojën e pacientit (0.00)

- modelit të fituar nga derdhja e ribazimit të protezave totale (0.00)

- modelit prej masës kompresive selektive (0.00)

5. Pjesën gingivale të protezës parciale e përbëjnë:

- pllaka dhe shalat e protezës (1.50)

- dhëmbët retencional (0.00)

- kroshetë (0.00)

- mbështetësit okluzal (0.00)

- ataçmentët (0.00)

6. A përfundojnë në të njëjtin vend skajet e lugës së sipërme individuale me skajet e protezës totale të sipërme?

- vetëm skajet faringeale përfundojnë në të njëjtin vend (1.50)

- po, përfundojnë në të njëjtin vend (0.00)

- vetëm skajet bukale përfundojnë në të njëjtin vend (0.00)

- vetëm skajet labiale përfundojnë në të njëjtin vend (0.00)

- të gjitha skajet e lugës individuale dhe protezës totale përfundojnë tek papilla inciziva (0.00)

7.Deri ku shtrihet krahu labial i protezës së sipërme totale:

- nga frenulumi i buzës së sipërme deri tek plika e përparme gingivo-bukale(1.50)

- nga frenulum labii superioris deri tek papila incisiva (0.00)

- nga frenulum labii superioris deri tek plika pterygomandibulare (0.00)

- nga frenulum labii superioris deri tek buza e përparme e m. masseter (0.00)

- nga frenulum labii superioris deri tek frenulum lingue(0.00)

8. Krosheja njëkrahëshe përdoret:

- në mënyrë diagonale (0.00)

- për shalët e lira (1.50)

- vetëm në njërën anë (0.00)

- mund të përdoret në njërën anë dhe në të dy anët (0.00)

- në dhëmbët prerës (0.00)

9. Metoda elektromiografike për përcaktimin e qetësisë fiziologjike të mandibulës bazohet në:

- shqiptimin e MI-MI (0.00)

- metodën e lodhjes së muskujve (0.00)

- matjen e potencialit të veprimit të muskujve (1.50)

- matjen e distancës intraalveolare (0.00)

- matjen e forcës maksimale përtypëse (0.00)

10. Elementi me të cilin presioni përtypës transmetohet përmes periodontit është:

- mbështetësi okluzal (1.50)

- harku nëngjuhësor (0.00)

- shala e protezës (0.00)

- harku palatinal (0.00)

- lidhësi i madh (0.00)

11. Për vendosjen e kroshesë Xhekson duhet të kemi të paktën:

- dy hapësira interdentale (1.50)

- një hapësirë interdentale (0.00)

- tre hapësira interdentale (0.00)

- më shumë hapësira interdentale (0.00)

- asnjë hapësirë interdentale (0.00)

12. Çfarë luge përdoret për marjen e masës funksionale me aplikimin e kompresionit selektiv?

- lugë e kombinuar individuale (me dhe pa ndërhapësirë) (1.50)

- lugë individuale pa ndërhapësirë (0.00)

- mund të përdoret lugë standarde (0.00)

- lugë metalike standarde me retencion (0.00)

- lugë metalike standarde pa retencion (0.00)

13. Hidrokolloidet ireverzibile - alginatet përzihen me:

- ujë (1.50)

- përzierje të ujit dhe alkoolit (0.00)

- katalizatorë të veçantë (0.00)

- eugenol (0.00)

- 3% peroksid hidrogjeni (0.00)

14. Tek pacientët me diabet, baza e protezës parciale duhet të jetë:

- hark transversal palatinal (0.00)

- formë skeletore me hark të përparëm dhe të pasëm (0.00)

- pllakë e plotë me ose pa mbështjellës qafe (1.50)

- formë patkoi (0.00)

- vetëm hark i pasëm ose në formë… (0.00)

15. Sa duhet të jetë gjerësia e dhëmbëve artificial lateral?

- gjerësia e dhëmbëve anësorë artificial nuk ka rëndësi (0.00)

- më pak se gjerësia e kreshtës alveolare (1.50)

- sa gjerësia e kreshtës alveolare (0.00)

- më e madhe se gjerësia e kreshtës alveolare (0.00)

- sa gjerësia e dhëmbëve natyralë lateral (0.00)

16. Cilat materiale përdoren për marrjen e masës funksionale kompresive?

- materialet viskoze (1.50)

- pastat e buta (0.00)

- çfarë materiali do të përdoret nuk ka rëndësi të veçantë (0.00)

- të gjitha llojet e materialeve për marrje të masës (0.00)

- dyll (0.00)

17. Si mund të jenë lugët sipas llojit të marrjes së masës?

- me ose pa retencione (1.50)

- lugë të bëra prej plastike (0.00)

- lugë të bëra prej metali (0.00)

- lugë për marrjen e masës (kopjes) nga nofullat me padhëmbësi të pjesëshme (0.00)

- lugë për marrjen e masës (kopjes) nga nofullat pa dhëmbë (0.00)

18. Si duhet të jenë lugët standarde në sipërfaqen e tyre kur masa anatomike meret me alginat?

- duhet të kenë retencione (1.50)

- nuk duhet të kenë retencione (0.00)

- duhet të jetë plastike (0.00)

- retencionet nuk kanë ndikim në masën (0.00)

- të jenë prej metali (0.00)

19. Si duhet të jenë lugët standarde në sipërfaqen e tyre kur masa anatomike meret me gips?

- të lëmuara në të gjithë sipërfaqen pa retencione (1.50)

- duhet të kenë retencione (0.00)

- retencionet nuk kanë ndikim në masën (0.00)

- duhet të jenë plastike (0.00)

- të jenë prej metali (0.00)

20. Klasa C në klasifikimin sipas Eihner do të thotë se:

- Klasifikimi Eihner nuk i trajton zonat mbështetëse (0.00)

- ka kontakt antagonist në të gjitha zonat mbështetëse (0.00)

- nuk ka kontakt antagonist mes dhëmbëve në zonat mbështetëse (1.50)

- ka kontakt antagonist në dy zona mbështetëse (0.00)

- ekziston padhëmbësi e ndërmjetme (0.00)

21. Klasa A në klasifikimin sipas Eihner do të thotë se:

- ka kontakt antagonist në të gjitha zonat mbështetëse (1.50)

- nuk ka kontakt antagonist në të gjitha zonat mbështetëse (0.00)

- nuk ka kontakt antagonist në asnjë zonë mbështetëse (0.00)

- kontakti antagonist është jashtë zonave mbështetëse (0.00)

- Klasifikimi Eichner nuk trajton zonat mbështetëse (0.00)

22. Kur është e kundërindikuar marrja e masës anatomike me masë termoplastike apo gips?

- kur ka kreshta alveolare të nënminuara (1.50)

- kur ekzistojnë ekzostoza të theksuara kockore (0.00)

- zonë e pakompresueshme (0.00)

- kur ka kreshta të mprehta (0.00)

- kur ka kreshta të lëvizshme (0.00)

23. Kur dhëmbët e mbetur janë në zonën e dukshme, forma dhe ngjyra e dhëmbëve artificial për protezat parciale përcaktohet:

- Sipas ngjyrës së dhëmbëve të mbetur (1.50)

- Sipas ngjyrës së syve të pacientit (0.00)

- Sipas garniturës së dhëmbëve që ka tekniku (0.00)

- Sipas formës së fytyrës (0.00)

- sipas karakterit të personit (0.00)

24. Cilat zona duhet të shkarkohen?

- vende të forta joreziliente dhe zona shumë reziliente(0.00)

- kreshta alveolare e lëvizshme pa dhëmbë (0.00)

- zona të vaskularizuara (0.00)

- kreshta alveolare e hollë dhe e mprehtë pa dhëmbë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (1.50)

25. Cilat inde të nofullës së sipërme pa dhëmbë duhet ti mbulojë hapësira e lugës standarde?

- kreshtën alveolare reziduale dhe qiellzën e fortë (1.50)

- ngritjen retromolare (0.00)

- kreshtën alveolare reziduale dhe 2/3 e përparme të qiellzës së fortë (0.00)

- hapësirën sublinguale (0.00)

- kreshtën alveolare reziduale, qiellzën e fortë dhe të butë (0.00)

26. Cilat inde të nofullës së poshtme pa dhëmbë duhet t'i mbulojë hapësira e lugës standarde?

- kreshtën alveolare reziduale dhe ngritjen retromolare (1.50)

- qiellzën e fortë (0.00)

- tuberin e zgjatimit alveolar (0.00)

- fossa dıgastryca (0.00)

- radix lingue (0.00)

27. Cilat funksione i kryen krosheja Zhilet:

- vetëm retencion (0.00)

- retencion, stabilitet dhe transmetim dentar të presionit përtypës (1.50)

- vetëm stabilizim (0.00)

- vetëm stabilizim dhe retencion (0.00)

- vetëm transmetim dentar të presionit përtypës (0.00)

28. Kush nuk merr pjesë në bazën biologjike për ekstenzionin e bazës së protezës totale?

- raportet topografike të muskujve dhe mukozës orale (0.00)

- drejtimi i kontrakcionit të fijeve muskulare (0.00)

- tonusi i muskulaturës (0.00)

- inserimi i muskujve dhe plikave (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (1.50)

29. Sa duhet të jetë e larguar luga standarde nga kreshta?

- 3-5 mm (1.50)

- 1-2 mm (0.00)

- 6-8 mm (0.00)

- 8-10 (0.00)

- 1 mm (0.00)

30. Masa funksionale kompresive merret me?

- presionin okluzal ose digjital (1.50)

- shtypet vetëm në pjesën e përparme (pjesën frontale) (0.00)

- masa kompresive nuk merret nën presion (0.00)

- shtypet vetëm në pjesën e prapme (pjesë faringeale) (0.00)

- presionin selektiv (0.00)

31. Me çfarë materiali duhet të përpunohet luga individuale?

- material të fortë dhe termostabil (1.50)

- material termoplastik (0.00)

- material elastik (0.00)

- termolabil (0.00)

- materiali nuk ka ndikim në cilësinë e lugës (0.00)

32. Me çfarë materiali duhet të përpunohet luga individuale?

- material të ngurtë dhe termostabil (1.50)

- material termoplastik (0.00)

- material elastik (0.00)

- termolabil (0.00)

- nga materiali që përmban gips (0.00)

33. Marrja e masës është një fazë e rëndësishme në përpunimin e protezës totale sepse:

- ka ndikim në stabilitetin e protezës totale (0.00)

- ka ndikim stabilizimi protezës (0.00)

- ka ndikim në sigurimin e retencionit të protezës (0.00)

- proteza ka efekt profilaktik në indet orale (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (1.50)

34. Nën çfarë presioni merret masa kompresive funksionale?

- presion okluzal nga muskujt mastikator ose presion digjital nga terapeuti (1.50)

- presion manual vertikal digjital nga pacienti (0.00)

- gjatë marrjes së masës kompresive nuk ka nevojë për presion (0.00)

- shtypet vetëm në pjesën e prapme (pjesën faringeale) (0.00)

- selektive (0.00)

35. Harku nëngjuhësor duhet të jetë larg parodontit të dhëmbëve të mbetur:

- 4-6 mm (1.50)

- 1-2 mm (0.00)

- 2-3 mm (0.00)

- 10 mm (0.00)

- Mbi 10 mm (0.00)

36. Për shkak të humbjes së dhëmbëve dhe zvogëlimit të lartësisë së kafshimit capitulum mandibulae lëviz:

- distalisht në thellësi të fossa articularis (1.50)

- mezialisht kah tuberculum articulare (0.00)

- meziolateralisht (0.00)

- bukalisht (0.00)

- lingualisht (0.00)

37. Gjatë marrjes së masës funksionale në gojë të mbyllur, relacioni okluzal vertikal duhet të përcaktohet:

- për 1-2 mm më ulët (1.50)

- për 1-2 mm më lartë (0.00)

- për 2-4 mm më ulët (0.00)

- nuk duhet të përcaktohet (0.00)

- nuk ka rëndësi se si do të përcaktohet (0.00)

38. Hapësira e cila gjendet pas crista infrazygomatica e kufizuar me pjesën e jashtme të tuber maxillae, lateralisht me mukozën që mbulon m.buccinator dhe mukozën që mbulon margo anterior ramus mandibulae, nga sipër me fornix vestibule quhet:

- hapësira paratubare (1.50)

- hapësira retromolare (0.00)

- hapësira infrazigomatike (0.00)

- hapësira retrobukale (0.00)

- hapësira parabukale (0.00)

39. Vlera mesatare protetikore e reziliencës gingivale mastikatore është:

- nga 3.0 deri 6.5 mm (0.00)

- nga 4 deri 4.5 mm (0.00)

- nga 0.3 deri 0.5 mm (1.50)

- nga 1- 5 mm (0.00)

- nga 2-4 mm (0.00)

40. Dora e kroshesë vendoset në:

- kuadrantin e III dhe IV të dhëmbit (1.50)

- kuadrantin e II të dhëmbit (0.00)

- kuadrantin e I të dhëmbit (0.00)

- në të gjitha kuadrantet (0.00)

- në kuadrantet okluzale (0.00)

41. Linja retencionuese do të kalojë përmes qendrës së peshës së protezës nëse shuma e dhëmbëve, sipas vendit në harkun e dhëmbëve, është:

- 10 (1.50)
- 9 (0.00)
- 8 (0.00)
- 7 (0.00)
- 12 (0.00)

42. Klasa e II Swenson është identike me:

- klasën e IV Kennedy (0.00)
- klasën e III Wilde (0.00)
- klasën e I Kennedy (1.50)
- klasën e II Kennedy (0.00)
- klasën III Kennedy (0.00)

43. Sipas klasifikimit Kennedy, padhëmbësia e ndërmjetme në regjionin frontal i takon:

- klasës së 4-të sipas Kennedy (1.50)
- klasës së 3-të sipas Kennedy (0.00)
- klasës së 2-të sipas Kennedy (0.00)
- nuk klasifikohet nga Kennedy (0.00)
- klasës së 1-rë sipas Kennedy (0.00)

44. Qëtësia fiziologjike e mandibulës përcaktohet me:

- vijën bipupilare (0.00)
- metodën e lodhjes së muskujve (1.50)
- matjen e rrugës së simfizës (0.00)

- metodën intraalveolare sipas Suvin-it (0.00)

- metodën ekstraorale (0.00)

45. Funksioni i mbështetësit okluzal është:

- Transmeton presionin përtypës dhe parandalon fundosjen e protezës dhe rrënien e krosheve kah gingiva (1.50)

- ruajtjen e raporteve ndërnofullore dhe rënien e krosheve kah gingiva (0.00)

- lidhjen e dhëmbëve të mbetur (0.00)

- retencionin e protezave parciale skeletore (0.00)

- estetikën dhe lidhjen e shalëve të protezës (0.00)

46. Gjerësia e zonës së vibrimit (sipërfaqja a-ha) është afërsisht 3-4 mm:

- nëse pozicioni i qiellzës së butë është horizontal (0.00)

- nëse pozicioni i qiellzës së butë është i pjerrët (1.50)

- nëse pozicioni i qiellzës së butë është vertikal (0.00)

- gjerësia e zonës së vibrimit është gjithmonë 3-4 mm (0.00)

- gjerësia e zonës së vibrimit nuk varet nga pozicioni i qiellzës së butë (0.00)

47. Gjerësia e zonës së vibrimit (zona a-ha) është afërsisht 6-8 mm:

- nëse pozicioni i qiellzës së butë është vendosur horizontalisht (1.50)

- nëse pozicioni i qiellzës së butë është i pjerrët (0.00)

- nëse pozicioni i qiellzës së butë është vertikal (0.00)

- gjerësia e zonës së vibrimit është gjithmonë 6-8 mm (0.00)

- gjerësia e zonës së vibrimit nuk varet nga pozicioni i qiellzës së butë (0.00)

48. Çfarë është linja mbështetëse?

- linja që lidh dhëmbët në të dy anët e harkut dentar dhe shuma e së cilës është 10 (0.00)

- linja që lidh elementet gingivale të protezës parciale (0.00)

- linja që lidh elementet për transmetimin dentar të presionit përtypës (1.50)

- linja që lidh elementët retencional të protezës parciale (0.00)

- linja që kalon në mes të papilla incisiva (0.00)

49. Çka është linja retencionuese?

- linja që lidh dhëmbët në të dy anët e harkut dentar dhe shuma e së cilës është 10 (0.00)

- linja që lidh dhëmbët në të cilët vendosen mbështetësit (0.00)

- linja që lidh elementet retencionale të protezës parciale (1.50)

- linja që lidh kaninin e majtë dhe të djathtë(0.00)

- linja që kalon në mes të papilla inciziva (0.00)

50. Çka është linja e peshës?

- linja që lidh dhëmbët në të dy anët e harkut dentar dhe shuma e së cilës është 10 (1.50)

- linja që lidh dhëmbët në të cilët vendosen mbështetësit (0.00)

- linja që lidh dhëmbët në të cilët ndodhet krahu i kroshesë (0.00)

- linja që lidh kaninin e majtë dhe të djathtë (0.00)

- linja që kalon në mes të papilla incisiva (0.00)

Детска и превентивна стоматологија - Писмен, Прашања

8.1.1-Stomatologjia e fëmijëve dhe preventive- Me shkrim, Pyetjet

1. Mineralizimi i kurorave të dhëmbëve të përhershëm fillon së pari te:

- incizivët lateral të përhershëm (0.00)

- incizivët qendror (0.00)

- kaninët e qumështit (0.00)

- molarët e parë të përhershëm (0.50)

- paramolarët (0.00)

2. Çrregullimet në madhësinë e dhëmbëve mund të jenë:

- mikrodoncioni dhe makrodoncioni (0.50)

- mikrodoncioni dhe hipodoncioni (0.00)

- makrodoncioni dhe hiperdoncioni (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

3 . Nivel të ulët të kariesit ka kur pështyma është:

- e rrallë dhe seroze (0.50)

- e dendur dhe mucine (0.00)

- nuk ka rëndësi (0.00)

- ngjitëse (0.00)

- shkumoze (0.00)

4. Aglossia paraqet anomali të rrallë që do të thotë:

- mungesë e lindur e gjuhës (0.50)

- gjuhë e zvogëluar (0.00)

- gjuhë normale (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

5. Amelogenesis imperfecta në mvarësi nga faza e zhvillimit në të cilën ndodhet, mund të paraqitet në disa lloje:

- 5 lloje (0.00)

- 2 lloje (0.00)

- 3 lloje (0.50)

- 4 lloje (0.00)

- 6 lloje (0.00)

6. Glossiti Hunter është një shenjë patognomonike e mungesës së:

- vitaminës D (0.00)

- vitaminës B2 (0.00)

- vitaminës B12 (0.50)

- vitaminës C (0.00)

- vitaminës E (0.00)

7. Vijat e Hunter-Schreger-it paraqesin një fenomen optik që vërehen në prerje gjatësore të smaltit në formën e:

- vijave të ndritshme dhe të errëta (0.50)

- vijave të ndritshme dhe gri (0.00)

- vijave gri dhe të errëta (0.00)

- vijave të ndritshme dhe të verdha (0.00)

- vijave të bardha dhe gri (0.00)

8. Macroglossia paraqet anomali zhvillimore, e cila manifestohet me:

- gjuhë të zmadhuar (0.50)

- gjuhë të zvogëluar (0.00)

- gjuhë normale (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

9. Meziodens paraqet:

- dhëmb të mbinumërt (0.50)

- dhëmb të poshtëm (0.00)

- dhëmbi të sipërm (0.00)

- paramolar (0.00)

- inciziv (0.00)

10. Schizodontia ndodh si rezultat i:

- ndarjes së plotë të folikulit të dhëmbit në kohën e zhvillimit të dhëmbit (0.50)

- pasojë e ndarjes jo të plotë të folikulit të dhëmbit (0.00)

- bashkimit të të dy ose më shumë dhëmbëve me cementin e rrënjëve (0.00)

- bashkimi i dy ose më shumë dhëmbëve me smaltin e kurorave (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

11. Dhëmbi i Turner-it shfaqet si rezultat i:

- infeksionit (0.50)

- traumës (0.00)

- rrezatimit (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

12. Avulsioni paraqet:

- frakturë të rrënjës (0.00)

- frakturë koronare (0.00)

- luksim patologjik të dhëmbëve (0.00)

- dalje të plotë të dhëmbit nga alveola (0.50)

- frakturë të kombinuar (0.00)

13. Avulsioni është dëmtim traumatik gjatë të cilit:

- kurora dhe rrënja e dhëmbit janë të frakturuara (0.00)

- preket smalti dhe dentina me pulpë të ekspozuar (0.00)

- dhëmbi ka dalur plotësisht nga alveola (0.50)

- dhëmbi nuk ka dalur plotësisht nga alveola (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

14. Të dhënat anamnestike gjatë frakturës së pakomplikuar të kurorës janë:

- dhimbje e butë spontane (0.00)

- dhimbje e provokuar (0.50)

- nuk ka dhimbje (0.00)

- dhimbje spontane pulsative (0.00)

- për çdo pacient është individuale (0.00)

15. Cheiliti angular dhe stomatiti ndodhin si rezultat i deficitit të :

- vitaminës A (0.00)

- vitaminës B6 (0.50)

- vitaminës D (0.00)

- vitaminës C (0.00)

- vitaminës E (0.00)

16. Ankiloza paraqet:

- çregullim lokal në daljen e dhëmbëve për shkak të ngjitjes së rrënjëve të dhëmbëve të qumështit me indin kockor të nofullës (0.50)

- çrregullim lokal në daljen e dhëmbëve për shkak të ngjitjes të qafës së kurorave të dhëmbëve të qumështit me indin kockor të nofullës (0.00)

- çrregullim lokal në daljen e dhëmbëve për shkak të ngjitjes të kurorave të dhëmbëve të qumështit me indin kockor të nofullës (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

17. Ankiloza e dhëmbit njihet gjithashtu edhe si:

- dhëmb i zhytur (0.50)

- dhëmb i resorbuar (0.00)

- dhëmb i impaktuar (0.00)

- dhëmb i reimplantuar (0.00)

- dhëmb me transpozicion (0.00)

18. Ankiloza ndodh më shpesh te:

- molarët e qumështit (0.50)

- kaninët (0.00)

- paramolarët (0.00)

- incizivët (0.00)

- incizivët lateral (0.00)

19. Ushtrimi me shpatull rekomandohet:

- për më shumë dhëmbë në kafshim të kryqëzuar (0.00)

- për dy inciziv të poshtëm në kafshim të kryqëzuar (0.00)

- kur një inciziv i sipërm erupton në kafshim të kryqëzuar (0.50)

- kur një inciziv i poshtëm erupton në kafshim të kryqëzuar (0.00)

- nuk rekomandohet (0.00)

20. Ekstirpimi vital me frakturë të komplikuar të kurorës mund të kryhet nëse kanë kaluar më së shumti:

- 6 orë nga lëndimi (0.00)

- 8 orë nga lëndimi (0.00)

- 12 orë nga lëndimi (0.00)

- 48 orë nga lëndimi (0.50)

- nuk praktikohet ekstirpim vital (0.00)

21. Vitamina D ka rol në:

- metabolizmin e kaliumit dhe natriumit (0.00)

- metabolizmin e natriumit dhe fosforit (0.00)

- metabolizmin e kalciumit dhe fosforit (0.00)

- metabolizmin e kalciumit dhe natriumit (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

22. Në vitin e 6-të, mund të zbulohet resorbimi i rrënjëve të dhëmbëve të qumështit te:

- incizivët lateral (0.50)

- incizivët qendror (0.00)

- kaninët e qumështit (0.00)

- molarët e qumështit (0.00)

- paramolarët (0.00)

23. Në çfarë mediumi duhet të transportohet dhëmbi gjatë avulsionit të tij?

- në gazë sterile (0.00)

- në tretësirë hidrogjeni (0.00)

- nën gjuhë (0.00)

- në ujë (0.00)

- në qumësht (0.50)

24. Në cilat raste gjidhënia mund të jetë një faktor predispozues për kariesin?

- nëse gjidhënia është e gjatë dhe e shpeshtë (0.50)

- nuk mund të jetë faktor (0.00)

- nëse gjidhënia është më e gjatë se një vit (0.00)

- nëse gjidhënia është më e shkurtër se një vit (0.00)

- nëse gjidhënia është e shpeshtë dhe e shkurtër (0.00)

25. Në cilën moshë rekomandohet përdorimi i tabletave të F tek fëmijët?

- nga ndërprerja e laktacionit (gjidhënies) deri në moshën 12 vjeçare (0.50)

- nga 6 deri në 12 vjeç (0.00)

- nuk rekomandohet dhënia e tabletave (0.00)

- nga 3 deri në 6 vjeç (0.00)

- nga 4 deri në 6 vjeç (0.00)

26. Në cilën periudhë të jetës së fëmijës rekomandohet ekzaminimi i parë te pedodonti?

- nga 0 deri në moshën 12 muajshe (0.50)

- nga 1 deri në 3 vjeç (0.00)

- nga 3 deri në 5 vjeç (0.00)

- nga viti i 6-të (0.00)

- nga 2 deri në 4 vjeç (0.00)

27. Në cilën periudhë të jetës intrauterine fillon odontogjeneza?

- në javën e 5-të intrauterine (0.50)

- në muajin e dytë (0.00)

- me formimin e fetusit (0.00)

- në muajin e 6-të intrauterin (0.00)

- në muajin e 3-të intrauterin (0.00)

28. Në cilën moshë zëvendësohen incizivët qendror maksilarë?

- në vitin e 7-të (0.50)

- në vitin e 6-të (0.00)

- në vitin e 8-të (0.00)

- në vitin e 5-të (0.00)

- në vitin e 4^{-t} (0.00)

29. Në cilën kategori të sëmundjes bëjnë pjesë kariesi dhe parodontopatia?

- inflamatore (0.00)

- ndikimit nga pllaku dental (0.50)

- nekrozës (0.00)

- sëmundjeve infektive (0.00)

- sëmundjeve të trashëguara (0.00)

30. Cila nga ndërhyrjet e mëposhtme kirurgjikale orale te fëmijët është specifike?

- frenulektomia (0.50)

- sutura (0.00)

- ekstrakcioni i hershëm (0.00)

- ekstrakcioni i dhëmbit me më shumë rrënjë (0.00)

- ekstrakcioni për shkaqe ortodontike (0,00)

31. Në dëmtimet e indeve periodontale përfshihen:

- kontuzioni i dhëmbit (0.00)

- avulsioni (0.00)

- luksacioni intruziv (0.00)

- subluksacioni (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.50)

32. Në stomatologjinë preventive primare, zbatohen pesë procedura me të cilat në mënyrë efektive mund të parandalohet shfaqja e kariesit dentar dhe sëmundjeve të parodontit, duke përfshirë:

- kontrollin e pllakut dentar (0.00)

- disiplinën në konsumimin e sheqernave (0.00)

- përdorimin e fluorideve (0.00)

- edukimin (0.00)

- të gjitha përgjigjet e lartëpërmendura janë të sakta (0.50)

33. Lidhja e cementëve glasjonomere me dhëmbët është:

- kimike (0.50)

- mikromekanike (0.00)

- fizike (0.00)

- makromekanike (0.00)

- e kombinuar (0.00)

34. Geminacioni paraqet:

- ngjitjen e dy ose më shumë dhëmbëve fqinjë me cementin e rrënjëve (0.00)

- ngjitjen e dy ose më shumë dhëmbëve fqinjë me smaltin e kurorave (0.00)

- pasojën e ndarjes jo të plotë të folikulit të dhëmbit (0.50)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

35. Faktorët kryesor etiologjik për shfaqjen e gingivitit kataral janë:

- mikroorganizmat në pllakun dentar (0.50)

- bakteriet spirale (0.00)

- bakteriet anaerobe (0.00)

- bakteriet aerobe (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

36. Lloji kryesor patogjen bakterial, i përfshirë drejtpërdrejtë në procesin kariogjen është:

- streptococcus mutans (0.50)

- laktobacilet (0.00)

- bakteriet spirale (0.00)

- bakteriet anaerobe (0.00)

- bakteriet aerobe (0.00)

37. Glasionomerët për vulosjen e fisurave lirojnë në mënyrë të vazhdueshme:

- fosfate (0.00)

- fluor (0.50)

- kalium (0.00)

- bikarbonate (0.00)

- të gjitha të lartëpërmendurat (0.00)

39. Pllaku dentar mund të jetë:

- pllak dentar supragingival dhe subgingival (0.50)

- pllak dentar subgingival dhe gingival (0.00)

- pllak dentar supragingival dhe gingival (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

40. Pllaku dentar më së shpeshti haset te:

- gropëzat e thella dhe fisurat e sipërfaqeve okluzale të dhëmbëve (0.50)

- sipërfaqet e lëmuara të dhëmbëve (0.00)

- sulkusi gingival (0.00)

- rrënjë të dhëmbit (0.00)

- sipërfaqet aproksimale (0.00)

41. Pllaku dentar më së shpeshti haset:

- përgjatë gingivës margjinale (0.00)

- në hapësirat interdentale (0.00)

- në gropëza të thella dhe fisura (0.00)

- në rrënjë të zhveshura (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.50)

42. Pas larjes së dhëmbëve pllaku dentar fillon të formohet:

- menjëherë (0.00)

- pas 2 orëve (0.50)

- pas 2 ditëve (0.00)

- pas 4 ditëve (0.00)

- pas 7 ditëve (0.00)

43. Fëmijët sipas sjelljes së tyre në ordinancën stomatologjike ndahen në disa grupe:

- 3 grupe (0.00)

- 6 grupe (0.00)

- 2 grupe (0.00)

- 5 grupe (0.50)

- 8 grupe (0.00)

44. Mbulimi direkt në frakturë të ndërlikuar të kurorës praktikohet për:

- hapje të vogël deri në 1 mm dhe ekspozim deri në 2 orë (0.50)

- hapje të vogël deri në 3 mm dhe ekspozim deri në 2 orë (0.00)

- hapje të vogël deri në 1 mm dhe ekspozim deri në 4 orë (0.00)

- hapje të vogël deri në 3 mm dhe ekspozim deri në 4 orë (0.00)

- nuk praktikohet mbulimi direkt te fraktura e klasës së III-të (0.00)

45.Mungesa e vitaminës A në fazat e hershme të zhvillimit të dhëmbit sjell deri në?

- degjenerimin dhe atrofinë e odontoblasteve (0.00)

- kalcifikate në dhomën pulpare (0.00)

- degjenerimin dhe atrofinë e ameloblasteve (0.50)

- ndryshime degjenerative të enëve të gjakut të pulpës (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

46. Çka shkakton mungesa e vitaminës D?

- tetanus (0.00)

- rahitis (0.50)

- skorbut (0.00)

- herpes simplex (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

47. Ekstrakcioni i molarëve të parë të përhershëm jep rezultate më të mira në rastet e mëposhtme:

- fëmija duhet të jetë në moshën 8 vjeçare dhe të ketë dëshmi për ekzistencën e dendësisë (0.00)

- raporti bazë i harqeve duhet të jetë normal (klasa I sipas Angle) (0.00)

- over bite (mbulimi i dhëmbëve duhet të jetë normal ose i zvogëluar (0.00)

- të gjithë dhëmbët e përhershëm duhet të jenë të pranishëm (0.00)

- të gjitha përgjigjet e lartëpërmendura janë të sakta (0.50)

49. Trajtimi endodontik i dhëmbëve të rinj të përhershëm kryhet vetëm me:

- pulpotomi vitale (0.50)

- pulpektomi vitale (0.00)

- pulpektomi mortale (0.00)

- pulpotomi mortale (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

50. Për cilat ushqime mendohet sot se janë kariogjene?

- kushtimisht çdo ushqim (0.50)

- vetëm saharoza (0.00)

- saharoza në ëmbëlsira (0.00)

- aciditeti i ushqimit (0.00)

- laktoza (0.00)

51. Për reduktimin e kariesit, karbohidratet e rafinuara duhet të konsumohen:

- para vaktit kryesor (0.00)

- pas vaktit kryesor (0.50)

- në çdo kohë (0.00)

- në mëngjes (0.00)

- në mbrëmje (0.00)

52. Për reimplantimin e dhëmbit të avulzuar, rëndësi të madhe kanë faktorët e mëposhtëm:

- mosha (0.00)

- destrukcionet e mëdha karioze në dhëmb (0.00)

- gingiviti (0.00)

- humbja e gjërë e periodonciumit kortikal (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.50)

53. Për kontroll të suksesshëm të kariesit dentar është e nevojshme që kujdesi të jetë i fokusuar në pesë zona kryesore mes të cilave edhe:

- kontrolli mekanik dhe kimik i pllakut dentar (0.00)

- përdorimi i fluorideve (0.00)

- disiplina në regjimin e marrjes së sheqernave (0.00)

- përdorimi i vulosësve te fisurat dhe gropëzat (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.50)

54. Kariesi dentar është një proces dinamik, i shoqëruar me periudha të pandryshuara të:

- demineralizimit dhe fluorizimit (0.00)

- demineralizimit dhe remineralizimit (0.50)

- remineralizimit dhe fluorizimit (0.00)

- asnjëra nga përgjigjet më sipër nuk janë të sakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

55. Kariesi dentar është një nga sëmundjet më të zakonshme tek njeriu bashkëkohor, ndërsa parakushti themelor për shfaqjen e tij është prania e:

- pllakut dentar (0.50)

- pelikulës së fituar (0.00)

- bakterieve anaerobe (0.00)

- bakterieve aerobe (0.00)

- sheqernave (0.00)

56. Sëmundjet e indeve periapikale ndodhin më shpesh si një komplikim i sëmundjeve të pulpës, të cilat sipas rrjedhës dhe pasqyrës patohistologjike mund të ndahen në:

- akute dhe kronike (0.50)

- kronike dhe seroze (0.00)

- akute dhe purulente (0.00)

- akute dhe seroze (0.00)

- purulente dhe granulomatoze (0.00)

57. Detyra e stomatologjisë fëmijërore në radhë të parë është:

- parandalimi dhe trajtimi i manifestimeve klinike të proceseve të ndryshme patologjike në gojën e fëmijëve (0.50)

- parandalimi dhe trajtimi i manifestimeve klinike të proceseve të ndryshme patologjike në gojën e të rriturve (0.00)

- parandalimi dhe trajtimi i manifestimeve klinike të proceseve të ndryshme patologjike në gojën e prindërve (0.00)

- parandalimi dhe trajtimi i manifestimeve klinike të proceseve të ndryshme patologjike në gojën e fëmijëve të gjinisë mashkullore (0.00)

- parandalimi dhe trajtimi i manifestimeve klinike të proceseve të ndryshme patologjike në gojën e fëmijëve të gjinisë femërore (0.00)

58. Dalja e vonuar e dhëmbëve referohet si:

- dentitio tarda (0.50)

- dentitio praecox (0.00)

- dhëmbë paraqumështor (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

59. Edukimi shëndetësor mund të zbatohet përmes disa metodave themelore, edhe atë:

- komunikimit individual (0.00)

- informimit grupor (0.00)

- sistemit arsimor shoqëror (0.00)

- transmetimit të informacionit përmes mjeteve të informimit publik (0.00)

- të gjitha përgjigjet e lartëpërmendura janë të sakta (0.50)

60. Invaginimi i dhëmbëve shfaqet në të dy denticionet, por më së shpeshti shfaqet te:

- incizivët e sipërm lateral të përhershëm me lokalizim në foramen cecum (0.50)

- incizivët e poshtëm lateral të përhershëm me lokalizim në foramen cekum (0.00)

- incizivët e sipërm qendror të përhershëm me lokalizim në foramen cekum (0.00)

- kaninin e sipërm të përhershëm (0.00)

- molarët e sipërm të përhershëm (0.00)

61. Lezioni inicial tek kariesi shfaqet si:

- njollë e bardhë (0.50)

- njollë e verdhë (0.00)

- njollë e zezë (0.00)

- asnjëra nga përgjigjet më sipër nuk janë të sakta (0.00)

- të gjitha janë të sakta (0.00)

62. Parodontopatia juvenile shfaqet në moshën:

- 11 deri në 15 vjeç (0.50)

- 8 deri në 10 vjeç (0.00)

- 18 deri në 20 vjeç (0.00)

- 20 deri në 30 vjeç (0.00)

- 30 deri në 40 vjeç (0.00)

63. Ku akumulohet më së shpeshti pllaku dentar?

- në sipërfaqet e lëmuara të dhëmbëve (0.00)

- në tuberët e dhëmbëve anësorë (0.00)

- në fisura dhe gropëza (0.50)

- në mbushjet e lustruara të amalgamit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

64. Ku deponohen 90% e fluorideve të resorbuar në trup?

- indet e kalcifikuara në trup (skeleti dhe dhëmbët) (0.50)

- aortë (0.00)

- tendinat dhe muskulaturën e skeletit (0.00)

- lëkurë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

66. Ku janë të vendosur folikulet e dhëmbëve në rajonin frontal në raport me paraardhësit e qumështit?

- paralelisht prapa paraardhësve të qumështit (0.50)

- apikalisht mbi paraardhësit e qumështit (0.00)

- anash nga paraardhësit e qumështit (0.00)

- mes paraardhësve të qumështit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

67. Te pulpitis acuta serosa partialis dhimbja është:

- dhimbje e mprehtë, intermitente dhe dhëmbi mund të lokalizohet (0.50)

- dhimbje e butë irraduese dhe dhëmbi nuk mund të lokalizohet (0.00)

- dhimbje provokuese që qetësohet menjëherë pas ndërprerjes së iritimit (0.00)

- është i ndjeshëm në perkusion (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

68. Te cilët lloje psikologjike të fëmijëve është e vështirë të kryesh intervenime dentare?

- te fëmijët normal (0.00)

- te fëmijët e përmbajtur (0.00)

- te fëmijët pretencioz (0.00)

- te fëmijët e lazdëruar (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

69. Te cilat sëmundje të pulpës së dhëmbëve të përhershëm do ta zbatojmë metodën e ekstirpimit mortal?

- caries profunda complicata (0.00)

- pulpitis acuta purulenta totalis (0.00)

- pulpitis acuta serosa totalis (0.50)

- necrosis pulpae (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

70. Si është lidhja e glasionomer cementeve me indet e dhëmbit?

- mikromekanike (0.00)

- kimike (0.50)

- e kombinuar (0.00)

- makromekanike (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

71. Si është lidhja e materialeve restauruese nga kompoziti me substancat e dhëmbëve?

- mikromekanike (0.00)

- kimike (0.00)

- mikromekanike dhe kimike (0.50)

- e kombinuar (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

72. Si është sipërfaqja e smaltit të dhëmbëve në erupcion?

- poroze, sepse maturimi nuk ka përfunduar (0.50)

- kompakte, sepse nuk ka pasur veprim të acideve (0.00)

- njëlloj si tek dhëmbët që kanë eruptuar më herët (0.00)

- e mineralizuar më mirë në krahasim me dhëmbët tjerë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

73. Cila pastë përdoret për mbushjen e kanalit gjatë trajtimit endodontik në dhëmbë të rinj të përhershëm?

- pasta antibiotike (0.00)

- pasta jodoform-clumsky (0.00)

- pasta në bazë të hidroksid kalciumit (0.50)

- pasta në bazë të kortikosteroideve (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

74. Cila procedurë terapeutike ndërmerret kur dëshmohet prania e fokusit oral në dhëmbët e qumështit?

- trajtimi endodontik i dhëmbit shkaktar (0.00)

- ekstrakcioni i dhëmbit shkaktar (0.50)

- zbatimi i masave primare preventive (0.00)

- monitorimi i dhëmbit shkaktar (0.00)

- vlerësimi RTG i gjendjes së dhëmbit shkaktar (0.00)

75. Çfarë dëmtimi traumatik paraqet Infractio substantio adamantinae?

- frakturë të kurorës dhe rrënjës (0.00)

- frakturë të smaltit dhe dentinës (0.00)

- plasaritje të smaltit (0.50)

- frakturë të dentinës dhe cementit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

76. Cilat pasta përdoren pas trajtimit endodontik të dhëmbëve të qumështit?

- mbushje të buta të kanaleve me aplikimin e kunjave të gutaperkës (0.00)

- mbushje të forta të kanaleve me aplikimin e kunjave të gutaperkës (0.00)

- pasta të buta resorbuese pa kunja të gutaperkës (0.50)

- pasta të buta resorbuese me kunja të gutaperkës (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

77. Çfarë preparate fluoride përdoren në profilaksën ekzogjene?

- tableta me fluoride (0.00)

- fluorizim të ujit të pijshëm (0.00)

- tretje, llaqe dhe zhele të fluorizuara (0.50)

- fluorizim të qumështit për pije (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

78. Çfarë preparate fluoride përdoren në profilaksën endogjene?

- tableta me fluoride (0.50)

- solucione të fluorizuara për shpërlarjen e gojës (0.00)

- impregnime të dhëmbëve me tretësira të fluorizuara (0.00)

- zhele për larjen e dhëmbëve (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

79.Dhëmbi i Turner-it ndodh si pasojë e?

- rahitit (0.00)

- fuzionit (0.00)

- infeksionit të hapësirës periapikale të rrënjëve të përhershëm(0.50)

- mungesës së vitaminës C (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

80. Çka e shkakton fluorozën e dhëmbëve?

- marrja e zvogëluar e fluorideve në organizëm gjatë formimit të dhëmbëve (0.00)

- marrja e rritur e fluorideve në organizëm gjatë formimit të dhëmbëve (0.50)

- sëmundjet trashëguese (0.00)

- dëmtimi traumatik i dhëmbëve (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

81. Si quhet abcesi subgingival karakteristik për moshën fëmijërore?

- flegmona (0.00)

- abscesi (0.00)

- parulis (0.50)

- fistula (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

82. Si quhen qelizat formuese përgjegjëse për krijimin e smaltit?

- ameloblaste (0.50)

- fibroblaste (0.00)

- osteoblaste (0.00)

- cementoblaste (0.00)

- odontoblaste (0.00)

83. Si manifestohet kariesi inicial i smaltit?

- caries media (0.00)

- caries profunda (0.00)

- kariesi sekondar (0.00)

- njollë e bardhë (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

84. Si quhet procesi i formimit të smaltit?

- amelogjeneza (0.50)

- dentinogjeneza (0.00)

- cementogjeneza (0.00)

- osteogjeneza (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

85. Si quhet lloji specifik i kariesit të dhëmbëve të qumështit?

- kariesi cirkular (0,50)

- kariesi recidivues (0.00)

- kariesi sekondar (0.00)

- kariesi kronik (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

86. Si quhen agjentët patologjik në fokuset orale?

- substanca fokale (0.50)

- mikroorganizma orale (0.00)

- toksinat bakteriale (0.00)

- procese periapikale dentogjene (0.00)

- flora bakteriale virulente (0.00)

87. Si ruhet paprekshmëria e sipërfaqes së smaltit?

- me ekuilibër të de dhe remineralizimit (0.50)

- me mbrojtje aktive të smaltit (0.00)

- me aktivitet enzimatik të pështymës (0.00)

- me zbatimin e higjienës orale (0.00)

- me vendosjen e mineraleve nga pështyma (0.00)

88. Si ndahen sëmundjet e pulpës sipas lokalizimit?

- akute (0.00)

- parciale (0.50)

- recidivuese (0.00)

- kronike (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

89. Si bëhet plani i terapisë për një fëmijë 5-vjeçar?

- përparësia bëhet sipas kohës së ndryshimit fiziologjik të dhëmbëve të qumështit (0.50)

- trajtohet me radhë (0.00)

- fillohet me incizivët qendror (0.00)

- trajtohet dhëmbi më urgjent (0.00)

- nuk ka nevojë për një plan terapie (0.00)

90. Si të njohim efektin negativ të një faktori lokal në folikulin e dhëmbit në formim?

- dhëmbi i Turner-it (0,50)

- ngjyra e dhëmbëve është e ndryshuar

(0.00)

- struktura e një grup dhëmbësh është e çregulluar (0.00)

- forma dhe madhësia e dhëmbit është e çregulluar (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

91. Si pasqyrohet ndikimi i faktorit trashëgues në strukturën e dhëmbit?

- ka ndryshime në një dhëmb (0.00)

- ndryshimet vërehen në të gjithë grupin e dhëmbëve (0.00)

- nuk ka ndryshime në denticion (0.00)

- ndryshimet gjeneralizohen në të gjithë dhëmbët (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

92. Si kryhet terapia e njollës së bardhë?

- me preparim të kavitetit (0.00)

- me impregnim me preparate të fluorit (0.50)

- me mbushje preventive (0.00)

- me trajtim endodontik (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

93. Si kryhet trajtimi endodontik në dhëmbë me rritje jo të plotë të rrënjës?

- me amputim mortal (0.00)

- me amputim vital (0.00)

- me ekstirpim mortal (0.00)

- me amputim të lartë (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

94. Si trajtohet caries profunda tek dhëmbët e qumështit te të cilët ende nuk ka filluar procesi i resorbimit fiziologjik?

- devitalizohet (0.00)

- bëhet amputimi mortal (0.00)

- dhëmbi nxirret (0.00)

- bëhet pulpektomia vitale (0.00)

- bëhet mbulimi indirekt i pulpës me preparate të hidroksid kalciumit dhe cementeve glasionomere (0.50)

95. Çfarë lloji i metabolizmit zhvillohet në fazën e parë të maturimit të pllakut dentar?

- aerob (0.50)

- anaerob (0.00)

- nuk ndodhin procese metabolike (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

96. Si bëhet trajtimi i dhëmbëve të qumështit te lëndimi traumatik-avulsioni?

- dhëmbi reimplantohet dhe imobilizohet (0.00)

- dhëmbi nuk reimplantohet dhe imobilizohet (0.50)

- dhëmbi reimplantohet në infraokluzion (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

97. Si bëhet trajtimi i dhëmbëve të qumështit te lëndimi traumatik-intruzioni?

- dhëmbi tërhiqet deri në rrafshin okluzal (0.00)

- dhëmbi lihet të eruptojë në mënyrë spontane (0.50)

- dhembi imobilizohet dhe tërhiqet gradualisht (0.00)

- dhëmbi nxirret (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

98. Çfarë procesi është njolla e bardhë?

- proces ireverzibil (0.00)

- proces reverzibil (0.50)

- anomali strukturore e dhëmbit (0.00)

- hipermineralizimi i smaltit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

99. Kur është më mire të bëhet vulosja e fisurave te dhëmbët e përhershëm?

- menjëherë pas eruptimit (0.50)

- dy vjet pas eruptimit (0.00)

- gjatë shfaqjes së procesit karioz (0.00)

- gjatë kariesit aproksimal (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

100. Kur mbaron rritja e rrënjëve te dhëmbët e rinj të përhershëm?

- një vit pas eruptimit (0.00)

- 6 muaj pas eruptimit (0.00)

- dy vjet pas eruptimit (0.00)

- 3 vjet pas eruptimit (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

101. Kur fillon procesi i resorbimit fiziologjik i rrënjëve të incizivëve të qumështit?

- në moshën dyvjeçare (0.00)

- në moshën trevjeçare (0.00)

- në moshën katërvjeçare (0.50)

- në moshën pesëvjeçare (0.00)

- në moshën shtatëvjeçare (0.00)

102. Kur përdoret profilaksia endogjene fluoride?

- pas eruptimit të dhëmbëve (0.00)

- në periudhën e zhvillimit të dhëmbëve (0.50)

- gjatë diagnostifikimit të kariesit dentar (0.00)

- te pacientët e rritur, me predispozicion për karies (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

103. Cili është preparati më efektiv për kontrollë kimike të pllakut?

- klorheksidina (0.50)

- triklosani (0.00)

- hipoklorid natriumi (0.00)

- dinatrium fosfati (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

104. Cilat lloje të inflamacionit të pulpës janë karakteristikë e dhëmbëve të qumështit që janë në proces të resorbimit?

- akute (0.00)

- proliferative (0.00)

- kronike (0.50)

- ulçeroze (0.00)

- difuze (0.00)

105. Cilët dhëmbë të denticionit të qumështit janë të rëndësishëm për okluzionin normal dhe ruajtjen e hapësirës për zëvendësuesit e përhershëm?

- incizivët qendror dhe lateral të sipërm (0.00)

- paramolarët e sipërm dhe të poshtëm të majtë (0.00)

- kaninët dhe molarët e dytë të qumështit (0.50)

- incizivët e poshtëm të qumështit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

106. Cilët dhëmbë preken më shpesh nga kariesi cirkular?

- dhëmbët e sipërm frontal të qumështit (0.50)

- dhëmbët e sipërm frontal të përhershëm (0.00)

- dhëmbët e poshtëm frontal të qumështit (0.00)

- dhëmbët e poshtëm frontal të rinj të përheshëm (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

107. Cilat sëmundje përfshihen në kategorinë e infeksioneve akute dentogjene?

- abscesi dhe flegmona (0.50)

- parodontiti apikal kronik (0.00)

- paradontopatia juvenile (0.00)

- pulpiti akut purulent total (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

108. Cilat materiale përdoren për vulosjen e fisurave dhe gropëzave?

- cementet e fosfatit (0.00)

- vulosësit prej kompoziti (0.50)

- kompozitet e lëngshme (0.00)

- amalgami (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

109. Cilët mikroorganizma janë përgjegjëse për inicimin e kariesit dentar?+

- streptokoket mutante (0.50)

- flora e përzier orale (0.00)

- streptokoket hemolitike (0.00)

- laktobacilet (0.00)

- stafilokoket (0.00)

110. Cila nga bakteret e mëposhtme ka rëndësi më të madhe kariogjene?

- streptococcus sanguis (0.00)

- neisseria (0.00)

- streptococcus mutans (0.50)

- escherichia coli (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

111. Cilat janë indikacionet për mbulimin direkt të pulpës së dhëmbëve të qumështit?

- caries profunda complicata (0.50)

- pulpitis acuta serosa partialis (0.00)

- pulpa vitale asimptomatike pa fetor (0.00)

- pulpitis acuta purulenta totalis (0.00)

- dhëmbi me patologji periapikale (0.00)

112. Cilat janë indikacionet për mbulimin indirekt të pulpës së dhëmbëve të qumështit?

- dhëmbi me karies të gjërë me dhimbje provokuese, por jo spontane (0.50)

- dhëmbi me karies të gjërë me dhimbje spontane (0.00)

- dhëmbi me dhimbje irraduese dhe dhimbje nga të nxehtit (0.00)

- dhëmbi në periudhën e ndërrimit fiziologjik (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

113. Cilat janë karakteristikat e dhëmbëve të rinj të përhershëm?

- resorbimi i rrënjëve (0.00)

- kurora e madhe (0.00)

- rritja e papërfunduar e rrënjës / ve (0.50)

- abrazioni fiziologjik (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

114. Cilat janë vetitë negative të materialeve kompozite restauruese?

- estetikisht jo të kënaqshme (0.00)

- mekanikisht nuk janë rezistente (0.00)

- ekspanzion termik (0.00)

- kontrakcion të restaurimit (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

115. Cilat janë çregullimet në numrin e dhëmbëve?

- makrodoncioni (0.00)

- hiperdoncioni (0.50)

- geminacioni (0.00)

- hipoplazioni (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

116. Cilat janë çregullimet në madhësinë e dhëmbëve?

- hipodoncioni dhe hiperdoncioni (0.00)

- rotacioni dhe transpozicioni (0.00)

- makrodoncioni dhe mikrodoncioni (0.50)

- invaginimi dhe anodoncioni (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

117. Cilat janë çregullimet në pozitën e dhëmbëve?

- mikrodoncioni (0.00)

- makrodoncioni (0.00)

- invaginimi (0.00)

- anodoncioni (0.00)

- inklinimi (0.50)

118. Cilat janë çregullimet në formën e dhëmbëve?

- mikrodoncioni (0.00)

- transpozicioni (0.00)

- invaginimi (0.50)

- anodoncioni (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

119. Cilat janë përparësitë e restaurimeve të amalgamit?

- kursimi i substancave të forta të dhëmbëve (0.00)

- lidhja kimike me dhëmbin (0.00)

- vetitë e mira estetike (0.00)

- qëndrimi më i gjatë në kavitetin e dhëmbit (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

120. Cilat janë masat profilaktike në parandalimin e kariesit dentar?

- vulosja preventive e fisurave të dhëmbëve (0.50)

- pllombimi i dhëmbëve me ruajtjen e substancës së dhëmbit (0.00)

- shpërlarja e xhepave me vrushkull uji (0.00)

- mbushja preventive e dhëmbëve (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

121. Cilat janë shtresat e fituara në dhëmbë?

- kutikula primare e smaltit (0.00)

- njolla e bardhë (0.00)

- pllaku dentar (0.50)

- kutikula sekondare dentare (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

122. Cilat preparate përdoren për vulosjen e fisurave?

- zink oksid eugenoli (0.00)

- amalgami (0.00)

- vulosësit prej kompoziti (0.50)

- cementet e zink fosfatit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

123. Cilët faktorë marrin pjesë në rritjen e rrezikut nga sëmundjet orale?

- ushqimi joadekuat (0.00)

- higjiena e pamjaftueshme orale (0.00)

- mosinformimi i popullatës (0.00)

- mënyra moderne e jetesës (0.00)

- të gjitha përgjigjet e lartëpërmendura janë të sakta (0.50)

124. Cili lloj i mikroorganizmave ka prevalencë në fazën e parë të maturimit të pllakut dentar?

- streptococcus mutans (0.50)

- actynomyces (0.00)

- streptoccocus salivarius (0.00)

- lactobacillus casei (0.00)

- staphyloccocus aureus (0.00)

125. Deri te arritja në ordinancën stomatologjike, cila është mënyra më e mirë për të rruajtur dhëmbin e dalur nga alveola?

- në ujë (0.00)

- në qumësht (0.50)

- në pecetë (0.00)

- nën gjuhë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

126. Cili indeks është më i përshtatshëm për vlerësimin e gjendjes së shëndetit oral?

- KEP (0.50)

- KIP (0.00)

- KEZ (0.00)

- KIZ (0.00)

- KIO (0.00)

127. Cilat nga këto materie mund të hyjnë në pllakun dentar të maturuar?

- oksigjeni (0.00)

- saharoza (0.50)

- metabolitet acidike (0.00)

- bikarbonatet (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

128. Cila është procedura terapeutike gjatë frakturës së smaltit dhe dentinës me pulpë të ekspozuar, te dhëmbët me rritje jo të plotë të rrënjës kur kanë kaluar më shumë orë nga trauma?

- mbulimi direkt i pulpës (0.00)

- rindërtimi (0.00)

- amputim i lartë vital (0.00)

- ekstirpim mortal (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.50)

129. Cili është infeksioni kronik dentogjen më i shpeshtë tek mosha fëmijërore?

- flegmona e faqes (0.00)

- flegmona e dyshemesë së zgavrës së gojës (0.00)

- celuliti (0.00)

- abscesi i regjionit submental (0.00)

- parulisi (0.50)

130. Cila është procedura për intervenimet kirurgjikale stomatologjike te pacientët me hemofili?

- kërkohet pëlqimi me shkrim nga hematologu (0.50)

- intervenohet pa pëlqim (0.00)

- intervenohet me kujdes (0.00)

- intervenohet me aplikim të anestezionit lokal (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

131. Cila është procedura për infractio substantia adamantinae?

- imobilizimi me shinë kompozite me tel (0.00)

- përpunimi i kësulës kompozite (0.00)

- impregnimi me preparate të fluorit (0.50)

- restaurimi preventiv (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

132. Cila është procedura e trajtimit gjatë frakturës së pakomplikuar të kurorës së dhëmbit?

- pulpotomia vitale dhe rindërtim me kompozit (0.00)

- rindërtimi me kompozit (0.50)

- pulpotomia mortale dhe rindërtimi me kompozit (0.00)

- pulpektomia vitale dhe rindërtimi me cement të glasionomerit (0.00)

- mbulimi direkt i pulpës dhe rindërtimi me kompozit (0.00)

133. Cila është procedura terapeutike gjatë frakturës së smaltit dhe dentinës me pulpë të ekspozuar të dhëmbit me rritje të përfunduar të rrënjës kur kanë kaluar më shumë orë nga trauma?

- mbulimi direkt i pulpës (0.00)

- amputimi i lartë vital (0.00)

- ekstirpimi vital (0.50)

- amputimi i lartë mortal (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

134. Cili është qëllimi i terapisë së kariesit tek dhëmbët e qumështit?

- fëmija të mos ketë dhimbje (0.00)

- të realizohet efekti mastikator i dhëmbëve (0.00)

- të kompenzohen pjesët e humbura të dhëmbëve (0.00)

- të rruhet shëndeti i plotë i dhëmbëve të qumështit deri në ndërrimin fiziologjik të tij (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

135. Cila nga gjendjet e mëposhtme është më urgjente?

- sinkopa (0.00)

- sulmi histerik (0.00)

- kolapsi (0.00)

- reaksioni alergjik lokal (0.00)

- shoku anafilaktik (0.50)

136. Cila karakteristikë paraqet proces fiziologjik te dhëmbët e qumështit?

- apeksogjeneza dhe apeksifikimi i rrënjës (ve) (0.00)

- resorbimi i rrënjës(ve) (0.50)

- atrofia e rrënjës(ve) (0.00)

- ankiloza e rrënjës(ve) (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

137. Cili përcaktim strategjik për vulosjen e fisurave ka justifikim më të madh?

- vulosja e të gjithë dhëmbëve të përhershëm me sistemin fisural (0.50)

- vulosja e fisurave të molarëve të përhershëm (0.00)

- vulosja e fisurave të molarëve të qumështit (0.00)

- vulosja e fisurave të paramolarëve (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

138. Sasia e ujit në pllakun dentar varion nga:

- 70-80% (0.50)

- 80-85% (0.00)

- 85-90% (0.00)

- 65-70% (0.00)

- 60-65% (0.00)

139. Sa sasi nga fluoridet e marra ekskretohet nëpërmjet urinës?

- 60-70% (0.50)
- 80-90% (0.00)
- 50-60% (0.00)
- 20-50% (0.00)
- 30-50% (0.00)

140. Pas higjienës orale, sa kohë është e nevojshme që të formohet pelikula në sipërfaqen e dhëmbëve?

- 2 orë (0.50)
- 24 orë (0.00)
- 2 ditë (0.00)
- 30 minuta (0.00)
- 5 minuta (0.00)

141. Sa kohë para ndërrimit fiziologjik fillon procesi i resorbimit të rrënjëve të dhëmbëve të qumështit?

- 3 vjet para ndërrimit fiziologjik (0.50)
- 1 vit para ndërrimit fiziologjik (0.00)
- 6 muaj para ndërrimit fiziologjik (0.00)
- 2 vjet para ndërrimit fiziologjik (0.00)
- 1.5 vjet para ndërrimit fiziologjik (0.00)

142. Sa është koncentrimi optimal i fluorit në ujin e pijshëm me qëllim të profilaksës së kariesit?

- 1 mg F/L (ppm) ujë (0.50)
- 0,5 mg F/L (ppm) ujë (0,00)

- 2 mg (ppm) ujë (0.00)
- 2.5 mg (ppm) ujë (0.00)
- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

143. Sa zgjat faza e parë e kolonizimit të mikroorganizmave në pllakun dentar?

- 12 orë (0.00)
- disa orë (0.00)
- 1 ditë (0.00)
- 3 ditë (0.00)
- 2 ditë (0.50)

144. Sa zgjat procesi i rritjes së rrënjës së dhëmbit të përhershëm pas eruptimit të tij?

- 2-3 vjet pas eruptimit (0.50)
- rritja e rrënjëve ka mbaruar (0.00)
- 6 muaj pas eruptimit (0.00)
- 1 vit pas eruptimit (0.00)
- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

145. Konkrescenca paraqet:

- bashkimin e dy ose më shumë dhëmbëve fqinj me cementin e rrënjëve (0.50)
- bashkimin e dy ose më shumë dhëmbëve fqinj me smaltin e kurorave (0.00)
- pasojë të ndarjes jo të plotë të folikulit të dhëmbit (0.00)
- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)
- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

146. Kontraindikacionet për ekstrakcionin e dhëmbëve të qumështit janë:

- resorbimi patologjik i rrënjëve (0.00)

- sëmundjet e përgjithshme të pacientit psh. hemofilia (0.00)

- frika nga dentisti (0.00)

- fëmijët me probleme në zhvillim (0.00)

- prania e neoplazmës në regjionin gjegjës (0.50)

147. Yndyrnat në ushqim në raport me incidencën e kariesit janë:

- karies - protektiv (0.00)

- jo indiferent (0.00)

- kariogjen (0.00)

- indiferent (0.50)

- asnjëra përgjigje nuk është e vërtetë (0.00)

148. Rezistenca mekanike e cementeve të glasionomerëve në raport me kompozitet është:

- më e dobët (0.50)

- e njëjtë (0.00)

- më e fortë (0.00)

- nuk kanë rezistencë mekanike (0.00)

- asnjëra nuk është e vërtetë (0.00)

149. Mioterapia paraqet:

- terapi e miokardit (0.00)

- terapi me masazhë (0.00)

- terapi me ushtrime të muskulaturës (0.50)

- asnjëra nga përgjigjet më sipër nuk janë të sakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet e lartëpërmendura janë të sakta (0.00)

150. Dhëmbët e rinj të përhershëm janë:

- dhëmbët me rritje të përfunduar të rrënjës (0.00)

- dhëmbët në fazën e eruptimit me rritje të papërfunduar të rrënjës (0.50)

- dhëmbët me proces të përfunduar të apeksogjenezës dhe apeksifikimit (0.00)

- dhëmbi që ka arritur rrafshin okluzal (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

151. Cili faktor etiologjik ka rëndësi më të madhe në shfaqjen e kariesit dentar?

- frekuenca e marrjes së ushqimit (0.50)

- karakteristikat fizike të ushqimit (0.00)

- përbërja kimike e ushqimit (0.00)

- marrja e karbohidrateve (0.00)

- sasia e ushqimit (0.00)

152. Në cilën moshë eruptojnë dhëmbët e parë të qumështit?

- nga mosha 6 deri në 8 muajshe (0.50)

- nga mosha 2 deri në 6 muajshe (0.00)

- nga mosha 12 deri në 16 muajshe (0.00)

- nga mosha 20 deri në 30 muajshe (0.00)

- nga mosha 10 deri në 12 muajshe (0.00)

154. Emërtimi i erupcionit të vonuar është:

- dentitio tarda (0.50)

- dentitio praecox (0.00)

- dentitio dificillis (0.00)

- dentes supernumeraria (0.00)

- dens in dens (0.00)

155. Parakushti më i rëndësishëm për terapi të duhur endodontike është:

- prania e dhimbjes (0.00)

- RTG inçizimi (0.00)

- anamneza (0.00)

- analiza – instrumentimi cilësor (0.00)

- diagnostifikimi i saktë (0.50)

156. Tipi më i papërshtatshëm i fëmijës për punë në ordinancën stomatologjike është:

- fëmijë normal (0.00)

- fëmijë pretencioz (0.00)

- fëmijë i lazdëruar (0.50)

- fëmijë i përmbajtur (0.00)

- fëmijë i frikësuar (0.00)

158. Dhëmbët më të shpeshtë të mbinumërt në denticionin e përhershëm janë:

- incizivët e sipërm lateral (0.50)

- incizivët e poshtëm lateral (0.00)

- kaninët e sipërm (0.00)

- kaninët e poshtëm (0.00)

- molarët e poshtëm (0.00)

159. Më së shpeshti perzistojnë këta dhëmbë të qumështit:

- incizivët e poshtëm qendror të qumështit (0.50)

- incizivët e sipërm qendror të qumështit (0.00)

- incizivët e poshtëm qendror të qumështit (0.00)

- kaninët e qumështit (0.00)

- molarët e qumështit (0.00)

160. Vendosja e mikroorganizmave në pllakun dentar zhvillohet në disa faza:

- tre faza (0.50)

- pesë faza (0.00)

- dy faza (0.00)

- tetë faza (0.00)

- dhjetë faza (0.00)

161. Mungesa e vitaminës D manifestohet me:

- Skorbut (0.00)

- rahitis (0.50)

- tetanus (0.00)

- herpes zoster (0.00)

- herpes simplex (0.00)

162. Çregullimi në numrin e dhëmbëve mund të jetë në kuptim të:

- hiperdoncionit dhe hipodoncionit (0.50)

- mikrodoncionit dhe hipodoncionit (0.00)

- makrodoncionit dhe hiperdoncionit (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

163. Prej ku e kanë prejardhjen polisaharidet ekstra dhe intracelulare në pllakun dentar?

- nga pështyma (0.00)

- nga lëngu i sulkusit (0.00)

- nga bakteriet e pllakut (0.50)

- nga smalti i demineralizuar (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

164. Nga cili muaj i shtatzanisë fillohet me ordinimin e tabletave me fluoride?

- nuk merren gjatë shtatzanisë (0.00)

- nga muaji i katërt i shtatzanisë (0.50)

- nga muaji i gjashtë i shtatzanisë (0.00)

- para lindjes (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

165. Nga aspekti kimik nga çka është i përbërë smalti i dhëmbit?

- hidroksiapatiti (0.50)

- fluoridi kalciumi (0.00)

- karbonat kalciumi (0.00)

- hidroksid kalciumi (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

166. Nga çka mvaret aciditeti i pllakut të maturuar?

- përbërja e ushqimit (0.50)

- përbërja e pështymës (0.00)

- lloji i mikroorganizmave në pllak (0.00)

- pH e pështymës (0.00)

- pH e ushqimit (0.00)

167. Nga çka mvaret procedura terapeutike te caries profunda te dhëmbët e qumështit?

- nga thellësia e kavitetit (0.00)

- nga mosha e fëmijës (0.50)

- nga simptomat subjektive 0.00)

- nga gjetja objektive (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

168. Nga çka mvaret forma e kavitetit të preparuar dhe mënyra e preparimit?

- nga lloji i materialit restaurues (0.50)

- nga rrjedha e procesit karioz (0.00)

- nga trashësia e shtresës (0.00)

- nga pjerrësia e prizmave të smaltit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

169. Nga çka mvaret më shumë potenciali kariogjen i sheqernave?

- nga frekuenca e marrjes së sheqerit (0.50)

- nga natyra kimike e sheqerit (0.00)

- nga përqendrimi i sheqerit (0.00)

- nga konzistenca fizike e sheqerit (0.00)

- nga sasia e sheqerit (0.00)

170. Oligodoncioni paraqet:

- dhëmbë të mbinumërt (0.00)

- dhëmbë me pozitë të çregulluar në nofull (0.00)

- disfunksion endokrin (0.00)

- numër të shtuar të dhëmbëve (0.00)

- numër të zvogëluar të dhëmbëve (0.50)

171. Përqendrimi optimal i fluorit gjatë fluorizimit të ujit të pijshëm është:

- 0,5 ppm F / L (0,00)

- 1 ppm F / L (0,50)

- 2 ppm F / L (0.00)

- 5 ppm F / L (0.00)

- 15 ppm F / L (0.00)

172. Përqendrimi optimal i fluorit gjatë fluorizimit të kripës së kuzhinës është:

- 2.5 ppm F / L (0.00)

- 25 ppm F / L (0.00)

- 250 ppm F / L (0,50)

- 0,25 ppm F / L (0,00)

- 5 ppm F / L (0.00)

173. Bakteriet e shprehin veprimin e tyre patologjik në pllakun dentar me krijimin e:

- acideve (0.50)

- bazave (0.00)

- yndyrnave (0.00)

- proteinave (0.00)

- karbohidrateve (0.00)

174. Pesë procesuse kufizojnë zgavrën me hapje në anën frontale e cila quhet:

- zgavra primare e gojës (primitive) (0.50)

- zgavra sekondare (0.00)

- zgavra terciare (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

175. Pas formimit të pelikulës, në te lidhen:

- vetëm mikroorganizmat (0.00)

- imunoglobulinet (0.00)

- enzimet (0.00)

- konglomerati i të gjithë faktorëve të lartëpërmendur (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

176. Dëmtimet e gingivës dhe mukozës orale mund të jenë:

- kontuzioni i gingivës, laceracioni dhe abrazioni i gingivës dhe mukozës orale (0.50)

- kontuzioni i gingivës, laceracioni i gingivës dhe mukozës orale (0.00)

- kontuzioni i gingivës dhe abrazioni i gingivës dhe mukozës orale (0.00)

- kontuzioni i gingivës, luksacioni dhe abrazioni i gingivës dhe mukozës orale (0.00)

- kontuzioni i gingivës, avulzioni dhe abrazioni i gingivës dhe mukozës orale (0.00)

177. Dëmtimet e indeve periodontale mund të jenë:

- kontusioni, subluksacioni, luksacioni ekstruziv, luksacioni lateral, luksacioni intruziv dhe avulzioni (0.50)

- kontusioni, subluksacioni, luksacioni lateral, luksacioni intruziv dhe avulzioni (0.00)

- kontusioni, subluksacioni, luksacioni ekstruziv, luksacioni intruziv dhe avulzioni (0.00)

- subluksacioni, luksacioni ekstruziv, luksacioni lateral, luksacioni intruziv dhe avulzioni (0.00)

- kontusioni, subluksacioni, luksacioni ekstruziv, luksacioni lateral, luksacioni intruziv (0.00)

178. Anestezioni lokal sipërfaqësor përdoret për ekstrakcionin e:

- dhëmbëve të përhershëm (0.00)

- dhëmbëve të resorbuar të qumështit (0.50)

- dhëmbëve jo të resorbuar të qumështit (0.00)

- dhëmbëve të resorbuar dhe jo të resorbuar të qumështit (0.00)

- nuk përdoret në stomatologji (0.00)

179. Me termin dentitio tarda nënkuptojmë:

- dalje të vonuar të dhëmbëve, 6 muaj pas kohës normale të eruptimit në zgavrën e gojës (0.50)

- dalja të vonuar të dhëmbëve, 8 muaj pas kohës normale të eruptimit në zgavrën e gojës (0.00)

- dalje të vonuar të dhëmbëve, 9 muaj pas kohës normale të eruptimit në zgavrën e gojës (0.00)

- dalja të vonuar të dhëmbëve, 10 muaj pas kohës normale të eruptimit në zgavrën e gojës (0.00)

- dalje të vonuar të dhëmbëve, 12 muaj pas kohës normale të eruptimit në zgavrën e gojës (0.00)

180. Me hipodoncion nënkuptojmë:

- numër të zvogëluar të dhëmbëve (0.50)

- numër të shtuar të dhëmbëve (0.00)

- dhëmbë të mbinumërt (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

181. Periudha postnatale ndahet në disa periudha, edhe atë në:

- 5 periudha (0.00)

- 6 periudha (0.50)

- 4 periudha (0.00)

- 2 periudha (0.00)

- 3 periudha (0.00)

182. Periudha postnatale ndahet në disa periudha, edhe atë:

- i porsalindur, foshnjë, fëmij i vogël, fëmijë parashkollor, fëmijë shkollor dhe adoleshentë (0.50)

- foshnjë dhe fëmijë i vogël (0.00)

- fëmijë parashkollor, fëmijë shkollor dhe adoleshentë (0.00)

- i porsalindur, foshnjë, fëmijë i vogël (0.00)

- i porsalindur, foshnjë, fëmijë i vogël, fëmijë parashkollor, fëmijë shkollor (0.00)

183. Vizita e parë tek stomatologu i fëmijëve duhet të jetë në:

- 12 muajt e parë (0.50)

- moshën 1 vjeçe (0.00)

- moshën 2 vjeçe (0.00)

- moshën 3 vjeçe (0.00)

- muajin e gjashtë (0.00)

184. Mikroorganizmat e parë që kolonizojnë pllakun dentar janë:

- këpurdhat (0.00)

- bakteriet gram pozitive (0.50)

- bakteriet gram negative (0.00)

- vibrionet (0.00)

- bacilet (0.00)

185. Zhvillimi prenatal i cili mesatarisht zgjat rreth 280 ditë (dhjetë muaj lunar) ndahet në disa periudha:

- paraembrionale dhe embrionale (0.00)

- paraembrionale, embrionale dhe fetale (0.50)

- embrionale dhe fetale (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

186. Dalja e parakohshme e dhëmbëve njihet si:

- dentitio tarda (0.00)

- dentitio praecox (0.50)

- dhëmbë paraqumështor (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

187. Në cilën vlerë të pH te pllaku dentar ndodh demineralizimi i smaltit ?

- 7.5 - 7.8 (0.00)

- 6,2 - 6,5 (0,00)

- 5.2 - 5.4 (0.50)

- 5.9 - 6.2 (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

188. Gjatë dëmtimit traumatik - frakturë e smaltit, kryhet trajtimi i mëposhtëm:

- trajtimi konservativ (0.50)

- nuk kryhet asnjë terapi (0.00)

- kryhet trajtimi endodontik (0.00)

- zbatohet preventiva primare (0.00)

- bëhet vlerësimi i vitalitetit (0.00)

189. Në rast të dëmtimeve traumatike të dhëmbëve ekziston:

- dhimbje gjatë përtypjes (0.00)

- luksacion (0.00)

- hapësirë e zgjeruar periodontale (0.00)

- të gjitha përgjigjet e lartëpërmendura janë të sakta (0.50)

- asnjëra nga më sipër (0.00)

190. Gjatë infeksionit fokal ndodhin ndryshime në pasqyrën e gjakut dhe ato janë:

- neutrofilia (0.50)

- leukopenia (0.00)

- trombocitopenia (0.00)

- anemia (0.00)

- leukocitoza (0.00)

191. Preventiva primare është përgjegjëse për:

- trajtimin e sëmundjeve (0.00)

- restaurimin e substancave të humbura të indit (0.00)

- parandalimin e sëmundjeve (0.50)

- rehabilitimin e pacientëve (0.00)

- kontrollin e sëmundjes (0.00)

192. Prania e polipit në kavitet haset tek:

- pulpiti kronik hipertrofik (0.50)

- pulpiti kronik ulçeroz (0.00)

- pulpiti akut purulent (0.00)

- pulpiti akut seroz (0.00)

- parodontiti kronik (0.00)

193. Shkaqet e impetigo contaginosa janë:

- streptokoket (0.00)

- stafilokoket (0.50)

- viruset (0.00)

- këpurdhat (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

194. Shkaqet e paraqitjes së ulçerës dekubitale janë:

- trashëgimia (0.00)

- pllaku dentar (0.00)

- kariesi dentar (0.00)

- infeksioni bakterial (0.00)

- trauma e vazhdueshme (0.50)

195. Gjakderdhjet e vazhdueshme pas ekstrakcionit, si dhe gjakderdhjet spontane nga gingiva mund të jenë manifestim i:

- hipovitaminozës A (0.00)

- hipovitaminozës K (0.50)

- hipovitaminozës C (0.00)

- hipovitaminozës D (0.00)

- hipervitaminozës K (0.00)

196. Procesi i mineralizimit të matriksit të smaltit zhvillohet në:

- 4 faza (0.00)

- 2 faza (0.50)

- 5 faza (0.00)

- 1 fazë (0.00)

- 3 faza (0.00)

197. Procesi i histo- dhe morfodiferencimit të qelizave është përgjegjës për:

- diferencimin e qelizave nga aspekti morfologjik dhe histologjik (0.50)

- formimin e bazës qelizore (0.00)

- fillimin e krijimit të sythave të dhëmbëve (0.00)

- rritjen e numrit të qelizave (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

198. Sëmundjet e pulpës sipas lokalizimit ndahen në:

- parciale dhe totale (0.50)

- recidivuese (0.00)

- kronike (0.00)

- akute (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

199. Zhvillimi i dentinës quhet:

- amelogjeneza (0.00)

- dentinogjeneza (0.50)

- cementogjeneza (0.00)

- mineralizimi (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

200. Zhvillimi i rrënjëve te molarët e parë të përhershëm dhe incizivët qendrorë përfundon ndërmjet:

- moshes 9-10 vjeçare (0.50)

- moshes 10-11 vjeçare (0.00)

- moshes 11-12 vjeçare (0.00)

- moshes 12-13 vjeçare (0.00)

- moshes 13-14 vjeçare (0.00)

201. Çrregullimet e smaltit të dhëmbëve nga rahitisi janë pasojë e:

- hipovitaminozës së vitaminës A (0.00)

- hipovitaminozës së vitaminës C (0.00)

- hipovitaminozës së vitaminës D (0.50)

- hipovitaminozës së vitaminës E (0.00)

- hipovitaminozës së vitaminës B (0.00)

202. Reimplantimi është:

- kthimi i sërishëm i dhëmbit në alveolë (0.50)

- fiksimi i dhëmbit (0.00)

- kthimi i dhëmbit në pozicion normal (0.00)

- mbulimi i vijës së frakturës (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

203. Resorbimi i rrënjëve të incizivëve qendror të qumështit fillon në:

- moshën e 6-vjeçare (0.00)

- moshën e 7-vjeçare (0.00)

- moshën e 8-vjeçare (0.00)

- moshën e 9-vjeçare (0.00)

- moshën e 4-vjeçare (0.50)

204. Retencioni i dhëmbëve nënkupton:

- mbajtjen e dhëmbëve të përhershëm në indin kockor të nofullave, edhe pse koha normale e eruptimit të tyre ka kaluar (0.50)

- mbajtjen e dhëmbëve të qumështit në indin kockor të nofullave, edhe pse koha normale e eruptimit të tyre ka kaluar (0.00)

- mbajtjen e dhëmbëve të qumështit dhe të përhershëm në indin kockor të nofullave, edhe pse koha normale e eruptimit të tyre ka kaluar (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

205. Çdo pastë për dhëmbë mund të ketë përbërësit e mëposhtëm:

- abraziv 20-40% (0.00)

- ujë 20-40% (0.00)

- humectans 20-40% (0.00)

- sapun dhe detergjentë 1-2% (0.00)

- të gjitha përgjigjet e përmendura janë të sakta (0.50)

206. Dentina sekondare ndryshe quhet:

- dentina fiziologjike (0.50)

- dentina reparuese (0.00)

- dentina protektive (0.00)

- dentina mbrojtëse (0.00)

- asnjë përgjigje nuk është e saktë (0.00)

207. Prevencioni sekondar është:

- Diagnostifikimi dhe trajtimi i hershëm i sëmundjeve orale (0.50)

- Diagnostifikimi i hershëm i sëmundjeve orale (0.00)

- parandalimi i shfaqjes së sëmundjeve orale (0.00)

- rehabilitimi i hershëm funksional (0.00)

- kontrolli i sëmundjes (0.00)

208. Simptomat e ankilozës së dhëmbit janë:

- tingulli i topitur(butë) gjatë perkusionit (0.50)

- tingulli metalik gjatë perkusionit (0.00)

- tingulli sonor gjatë perkusionit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të sakta (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

209. Me çfarë lloj anestezioni nxirren dhëmbët e qumështit në periudhën fiziologjike të ndërrimit?

- me anestezion të përgjithshëm (0.00)

- me anestezion infiltrues pleksus (0.00)

- me anestezion mandibular (0.00)

- me anestezion sipërfaqësor (0.50)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

210. Me çfarë preparate bëhet mbulimi direkt i pulpës së ekspozuar?

- preparatet e zink-oksid eugenolit (0.00)

- preparatet në bazë të hidroksid kalciumit (0.50)

- preparatet e fokalminës (0.00)

- preparatet e dontisolonit (0.00)

- të gjitha përgjigjet janë të pasakta (0.00)

211. Me cilin proces fillon formimi i pllakut dentar?

- me formimin e kutikulave primare (0.00)

- me adhezion të drejtpërdrejtë të mikroorganizmave (0.00)

- me depozitim të mikroorganizmave gram negative (-) (0.00)

- me depozitim të mikroorganizmave gram pozitive (+) (0.00)

- me formimin e pelikulës së fituar sekondare (0.50)

212. Me çka kryhet obturimi i kanalit të rrënjës gjatë trajtimit endodontik te dhëmbët e qumështit?

- me mbushje definitive të fortë (0.00)

- me kunja të gutaperkës (0.00)

